

MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT
NDËRMJET KOSOVËS*, NË NJËRËN ANË, DHE BASHKIMIT EVROPIAN DHE
KOMUNITETI EVROPIAN TË ENERGJISË ATOMIKE,
NË ANËN TJETËR

* Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

BASHKIMI EVROPIAN, referuar më poshtë si “Bashkimi” ose “BE”, dhe KOMUNITETI EVROPIAN I ENERGJISË ATOMIKE,

në njërën anë, dhe

KOSOVA*,

në anën tjetër,

këtu e tutje të referuar bashkërisht si “Palët”,

DUKE MARRË PARASYSH lidhjet e forta ndërmjet Palëve dhe vlerat që i bashkojnë, dëshirën e tyre për të forcuar këto lidhje dhe për të vendosur marrëdhënie të ngushta e të qëndrueshme, bazuar në reciprocitet dhe interesat e ndërsjellë, të cilat duhet t’i japin mundësinë Kosovës të forcojë dhe zgjerojë më tej marrëdhëniet me BE-në;

DUKE MARRË PARASYSH rëndësinë e kësaj Marrëveshje në kuadër të Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA) me Ballkanin Perëndimor, për vendosjen dhe konsolidimin e një rendi të qëndrueshëm Evropian të bazuar në bashkëpunim, për të cilin BE-ja është një shtyllë kryesore;

DUKE MARRË PARASYSH gatishmërinë e BE-së që të ndërmarrë hapa konkretë për të realizuar perspektivën evropiane të Kosovës dhe afrimin me BE-në, në përputhje me perspektivën e rajonit duke integruar Kosovën në rrjedhat politike dhe ekonomike të Evropës përmes pjesëmarrjes së vazhdueshme të Kosovës në PSA me qëllim të përmbushjes së kritereve relevante dhe kushtëzimeve të PSA-së, që janë subjekt i zbatimit të suksesshëm të kësaj Marrëveshje, veçanërisht sa i përket bashkëpunimit rajonal; ky proces do të shpie në përmirësimin e perspektivës evropiane të Kosovës dhe afrimin me BE-në, nëse këtë e lejojnë rrethanat objektive dhe nëse Kosova përmbushë kriteret e përcaktuara nga Këshilli Evropian në Kopenhagë më 21-22 qershor të vitit 1993 si dhe kushtëzimet e lartpërmendura;

* Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të kontribuar përmes mjeteve të duhura në stabilizimin politik, ekonomik dhe institucional të Kosovës dhe rajonit, nëpërmjet zhvillimit të shoqërisë civile dhe demokratizimit, ndërtimit të institucioneve dhe reformës së administratës publike, integritit në tregtinë rajonale dhe rritjes së bashkëpunimit ekonomik, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit në një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë drejtësinë dhe çështjet e brendshme si dhe forcimin e sigurisë;

DUKE MARRË PARASYSH zotimin e Palëve për rritjen e lirive politike dhe ekonomike që janë bazat themelore të kësaj Marrëveshje, si dhe angazhimin e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara,

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve në institucione të bazuara në sundimin e ligjit, në qeverisje të mirë dhe parime demokratike nëpërmjet një sistemi shumë partiak me zgjedhje të lira dhe të ndershme;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të respektuar parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), veçanërisht ato të Aktit Final të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (këtu e tutje të referuar si Akti Final i Helsinkit), dhe Kartën e Parisit për një Evropë të Re të vitit 1990;

DUKE KONFIRMUAR zotimin e Palëve në zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare, në veçanti por jo vetëm atyre që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe me mbrojtjen e personave që u përkasin minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara, duke vënë kështu në pah edhe angazhimin e Kosovës për të vepruar në përputhje me instrumentet relevante ndërkombëtare;

DUKE KONFIRMUAR të drejtën për kthimin e të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit dhe mbrojtjen e pronës së tyre si dhe të drejtave të tjera të njeriut;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve ndaj parimeve të ekonomisë së tregut të lirë dhe zhvillimit të qëndrueshëm si dhe gatishmërisë së BE-së për të kontribuar në reformat ekonomike në Kosovë;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve ndaj tregtisë së lirë, në përputhje me parimet relevante të Organizatës Botërore të Tregtisë (këtu e tutje të referuar si “OBT”) të cilat duhet të

zbatohen në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese;

DUKE MARRË PARASYSH zotimin e Palëve për të zhvilluar më tej një dialog politik të rregullt për çështje të interesit të ndërsjellë, përfshirë aspektet rajonale;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe për të forcuar bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit në përputhje me *acquis* të BE-së, dhe për të ndaluar migrimin e parregullt dhe përkrahur mobilitetin në një mjedis ligjor dhe të sigurt;

ME BINDJEN që kjo Marrëveshje do të krijojë një klimë të re për marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Palëve dhe mbi të gjitha për zhvillimin e tregtisë dhe investimeve, që janë faktorë kryesorë për modernizimin dhe ristrukturimin ekonomik;

DUKE RIKUJTUAR angazhimin e Kosovës për të përafruar legjislacionin në sektorët përkatës me atë të BE-së dhe për ta zbatuar atë me efektivitet;

DUKE MARRË PARASYSH gatishmërinë e BE-së për të dhënë një mbështetje vendimtare për zbatimin e reformave dhe për të përdorur të gjithë instrumentet e disponueshme të bashkëpunimit dhe asistencës teknike, financiare dhe ekonomike mbi një bazë gjithëpërfshirëse shumëvjeçare për këtë përpjekje, nëse rrethanat objektive e lejojnë këtë;

DUKE THEKSUAR se kjo Marrëveshje nuk paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KSKB dhe opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës;

DUKE MARRË PARASYSH se angazhimet dhe bashkëpunimi që Bashkimi Evropian i pranon në pajtim me këtë Marrëveshje u referohen vetëm fushave të mbuluara nga *acquis* ose politikat e Bashkimit Evropian;

DUKE THEKSUAR se procedurat e brendshme të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (këtu e tutje të referuara si "Shtete Anëtare") mund të jenë të zbatueshme në pranimin e dokumenteve të lëshuara nga autoritetet e Kosovës në bazë të kësaj Marrëveshje;

DUKE THEKSUAR se negociatat janë në vazhdim e sipër për themelimin e Komunitetit të

Transportit me Ballkanin Perëndimor;

DUKE RIKUJTUAR Samitin e Zagrebit të vitit 2000, që bëri thirrje për konsolidim të mëtejshëm të marrëdhënieve përmes PSA-së si dhe për rritjen e bashkëpunimit rajonal;

DUKE RIKUJTUAR që Këshilli Evropian në Selanik më 19 dhe 20 qershor të vitit 2003 e përforcoi PSA-në si një kornizë politike për marrëdhëniet e BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe nënvizoi perspektivën e integritit të tyre në BE në bazë të progresit të tyre të reformave dhe meritave individuale;

DUKE RIKUJTUAR angazhimet e Kosovës në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore të nënshkruar në Bukuresht më 19.12.2006, të arritur me qëllim të përmirësimit të aftësisë së rajonit për të tërhequr investime dhe për perspektivat e integritit të saj në ekonominë globale, nëse rrethanat objektive e lejojnë këtë;

ME DËSHIRË të krijimit të bashkëpunimit më të afërt kulturor dhe zhvillimit të shkëmbimit të informacionit,

DUKE THEKSUAR që nëse Palët vendosin, në kuadër të kësaj Marrëveshje, të hyjnë në marrëveshje specifike në Fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë të cilat do të lidheshin nga BE-ja sipas Titullit V të Pjesës së Tretë të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian, dispozitat e këtyre marrëveshjeve specifike në të ardhmen nuk do të jenë obligative për Mbretërinë e Bashkuar dhe/ose Irlandën përveç nëse BE-ja njëkohësisht me Mbretërinë e Bashkuar dhe/ose Irlandën, sipas marrëdhënieve bilaterale përkatëse në të kaluarën, njoftojnë Kosovën se Mbretëria e Bashkuar dhe/ose Irlanda është/janë pjesë e obligimeve sipas marrëveshjeve të tilla në të ardhmen si pjesë e BE-së në përputhje me Protokolin nr. 21 mbi pozitën e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës në lidhje me fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë të aneksuar tek Traktati i Bashkimit Evropian dhe Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, çfarëdo masa pasuese të brendshme të BE-së të cila do të miratoheshin në bazë të Titullit V të lartpërmendur për zbatimin e kësaj Marrëveshje nuk do të obligonin Mbretërinë e Bashkuar dhe/ose Irlandën, përveç nëse ata kanë shprehur dëshirën për të marrë pjesë ose për të pranuar masa të tilla në përputhje me Protokollin Nr. 21. Gjithashtu duke theksuar se marrëveshjet e tilla specifike të ardhshme ose masat e tilla pasuese të brendshme të BE-së do të bien në kuadër të Protokollit Nr. 22 mbi pozicionin e Danimarkës, të aneksuar në ato Traktate.

BIEN DAKORD SI VIJON:

NENI 1

1. Në këtë mënyrë është vendosur një Asociim ndërmjet BE-së, në njërën anë, dhe Kosovës, në anën tjetër.
2. Synimet e këtij Asociimi janë:
 - (a) të mbështesë përpjekjet e Kosovës për forcimin e demokracisë dhe shtetin e së drejtës;
 - (b) të kontribuoj në stabilitetin politik, ekonomik dhe institucional në Kosovë si për stabilizimin e rajonit;
 - (c) të sigurojë një strukturë të përshtatshme për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve;
 - (d) të mbështesë përpjekjet e Kosovës për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, nëse lejojnë rrethanat objektive, gjithashtu edhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të BE-së;
 - (e) të mbështesë përpjekjet e Kosovës për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi funksionale të tregut;
 - (f) të promovojë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet BE-së dhe Kosovës;
 - (g) të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat e trajtuara me këtë Marrëveshje.

NENI 2

Asnjë nga termat, formulimet apo përkufizimet e përdorura në këtë Marrëveshje, duke përfshirë Anekset dhe Protokollet e saj, nuk përbëjnë njohje të Kosovës nga BE-ja si një shtet i pavarur apo nuk paraqesin njohje individuale nga Shtetet Anëtare për Kosovën nëse ato nuk e kanë ndërmarr një hap të tillë.

TITULLI I

PARIMET E PËRGJITHSHME

NENI 3

Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948 dhe siç janë përkufizuar në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të vitit 1950, në aktin final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin e plotë me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) dhe mekanizmit të saj të mbetur, Tribunali Penal Ndërkombëtar, dhe respekti i shtetit të së drejtës dhe parimet e ekonomisë së tregut siç pasqyrohen në Dokumentin e Konferencës së Bonit për Bashkëpunim Ekonomik të Konferencës për Bashkëpunim për Siguri në Evropë formojnë bazën e politikave të BE-së dhe të Kosovës dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj Marrëveshje.

NENI 4

Kosova angazhohet të respektojë të drejtën dhe instrumentet ndërkombëtare, por jo vetëm ato që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore, e deri tek mbrojtja e personave që u përkasin minoriteteve dhe pa diskriminim mbi çfarëdo baze.

NENI 5

Kosova zotohet të vazhdojë angazhimin për përmirësimin e dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve me Serbinë dhe bashkëpunimin efektiv me misionin e Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes derisa janë në fuqi, siç përcaktohet më tej në nenin 13. Këto angazhime përbëjnë parimet thelbësorë të kësaj Marrëveshje, të cilat do mbështesin zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin ndërmjet Palëve. Në rast të mos-përmbushjes së këtyre zotimeve nga ana e Kosovës, BE-ja mund të marrë masa të cilat ajo i konsideron të përshtatshme, duke përfshirë edhe pezullimin e gjithë ose një pjese të kësaj Marrëveshje.

NENI 6

Palët riafirmojnë se krimet më serioze të cilat shqetësojnë komunitetin ndërkombëtar në tërësi nuk duhet të mbeten pa u ndëshkuar dhe se ndjekja penale e këtyre krimeve duhet të sigurohet duke marrë masa në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Në këtë aspekt, Kosova angazhohet që në veçanti të bashkëpunoj plotësisht me TPNJ-në dhe me mekanizmin e tij të mbetur, dhe të gjitha hetimet dhe ndjekjet tjera penale t'i kryej nën mbikëqyrje ndërkombëtare.

Kosova gjithashtu merr përsipër të veprojnë në përputhje me Statutin e Romës së Gjykatës Ndërkombëtare Penale dhe në këtë aspekt të marrë hapat e nevojshëm për zbatimin e tij në nivel të brendshëm.

NENI 7

Zhvillimi i bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore, si dhe respektimi i të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve, janë të rëndësishme për PSA-në. Arritja dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje bëhet në kuadër të PSA-së dhe bazohet në vet meritat e Kosovës.

NENI 8

Kosova zotohet të vazhdojë nxitjen e bashkëpunimit dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në rajon, duke përfshirë një nivel të përshtatshëm të koncesioneve të ndërsjella lidhur me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët në një game të gjerë të fushave, përfshirë sundimin e ligjit. Ky zotim përbën një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet Palëve, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal.

NENI 9

Asociimi në mënyre progresive dhe të plotë do të realizohet gjatë një periudhe prej dhjetë vitesh.

Këshilli i Stabilizim-Asociimit (këtu e tutje i referuar si "KSA") i themeluar sipas nenit 126, do të rishikoj, në baza vjetore zbatimin e kësaj Marrëveshje si dhe miratimin dhe zbatimin e reformave ligjore, administrative, institucionale dhe ekonomike nga ana e Kosovës. Ky rishikim do të kryhet në vazhden e preambulës dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të kësaj Marrëveshje. Kjo do të jetë në përputhje me mekanizmat e krijuar sipas PSA-së, sidomos raportit të progresit të PSA-së.

Në bazë të këtij rishikimi, KSA-ja do të nxjerrë rekomandime dhe mund të marrë vendime.

Aty ku rishikimi identifikon vështirësi të veçanta, ato mund t'i referohen mekanizmave për zgjidhje të mosmarrëveshjeve të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshje.

KSA-ja do të bëjë një rishikim tërësor të zbatimit të kësaj marrëveshje, jo më vonë se gjate vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje. Sipas këtij rishikimi, KSA-ja do të vlerësojë progresin e bërë nga Kosova dhe mund të marrë vendime që rregullojnë procesin e ardhshëm të Asociimit. Hapa të ngjashëm do të merren nga KSA-ja para fundit të vitit të dhjetë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje. Nëse garantohet nga rezultatet e rishikimit, KSA-ja mund të marrë vendim për të shtyrë periudhën e përcaktuar në paragrafin 1 për jo më shumë se pesë vite. Në mungesë të vendimeve të tilla nga ana e KSA-së, kjo Marrëveshje do të vazhdojë të zbatohet siç është dakorduar këtu.

Rishikimi i lartpërmendur nuk vlen për lëvizjen e lirë të mallrave, për të cilat është dhënë një orar specifik në Titullin IV.

NENI 10

Kjo marrëveshje duhet të përputhet plotësisht dhe të zbatohet në përputhje me dispozitat përkatëse të përfshira në Marrëveshjet e OBT-së, në veçanti me Nenin XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifa dhe Tregti 1994 (GATT 1994) dhe Nenit V të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë për Shërbime (GATS).

TITULLI II

DIALOGU POLITIK

NENI 11

Dialogu politik ndërmjet Palëve do zhvillohet më tej brenda kontekstit të kësaj Marrëveshje. Duhet të shoqërojë dhe konsolidojë përafrimin ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës dhe do të kontribuojë në vendosjen e lidhjeve të ngushta të solidaritetit dhe formave të reja të bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

2. Dialogu politik ka për qëllim që në veçanti të promovoj:
 - (a) Pjesëmarrjen e Kosovës në komunitetin ndërkombëtar demokratik, nëse e lejojnë rrethanat objektive;
 - (b) avancimin e perspektivës evropiane të Kosovës dhe përafrimin me BE-në në përputhje me perspektivën evropiane të rajonit, bazuar në meritat individuale dhe në përputhje me zotimet e Kosovës në bazë të nenit 5 të kësaj Marrëveshje;
 - (c) rritjen e konvergjencës me disa masa të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, masave të caktuara kufizuese të ndërmarra nga BE-ja kundrejt vendeve të treta, personave fizik ose juridik apo subjekteve jo-shtetërore si dhe nëpërmjet shkëmbimit të duhur të informacionit, në veçanti çështjet që priten të kenë efekte të ndjeshme tek Palët;
 - (d) bashkëpunimin rajonal efektiv, gjithëpërfshirës dhe përfaqësues dhe zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore në Ballkanin Perëndimor.

NENI 12

Palët duhet të zhvillojnë dialog të politikave mbi çështjet tjera që mbulohen nga kjo Marrëveshje.

NENI 13

1. Dialogu politik dhe dialogu për politika, sipas nevojës, kontribuojnë në procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.
2. Siç parashihet në nenin 5, Kosova zotohet për angazhimtë vazhdueshëm drejt përmirësimit të dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve me Serbinë. Ky proces do të sigurojë që të dyja vendet të mund të vazhdojnë rrugën e tyre përkatëse evropiane, duke shmangur bllokimin e njëjës apo tjetrës palë në këto përpjekje dhe gradualisht të shpien në normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, në formën e një marrëveshje ligjërish të detyrueshme, ku të dy vendet do të jenë në gjendje të ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre dhe të përmbushin përgjegjësitë e tyre.
3. Sipas kornizës së mësipërme, Kosova vazhdimisht duhet të:
 - (a) zbatojë në mirëbesim të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog me Serbinë;
 - (b) respektoj plotësisht parimet e bashkëpunimit gjithëpërfshirës rajonal;
 - (c) zgjidh përmes dialogut dhe frymës së kompromisit çështjet e tjera të pazgjidhura, në bazë të zgjidhjeve praktike dhe të qëndrueshme dhe do të bashkëpunoj për çështjet e nevojshme teknike dhe ligjore me Serbinë;
 - (d) bashkëpunojë në mënyrë efektive me misionin e Politikës së Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrotjtjes përgjatë mandatit të tij dhe do të kontribuon në mënyrë aktive në përmbushjen e plotë dhe të papenguar të mandatit të tij në tërë Kosovën.
4. KSA-ja do të rishikojë rregullisht progresin në këtë proces dhe mund të marrë vendime dhe të lëshojë rekomandime në këtë drejtim. Komisioni i Stabilizim-Asociimit mund të ndihmoj këtë proces në përputhje me nenin 129.

NENI 14

1. Dialogjet politike dhe dialogjet për politika në radhë të parë do të bëhen brenda KSA-së, i cili do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për çdo çështje që Palët mund të dëshirojnë t'i adresojnë.
2. Me kërkesë të njërës Palë, këto dialogje mund të zhvillohen edhe në formatet e mëposhtme:
 - (a) kur është e nevojshme, në formë të takimeve të zyrtarëve të lartë që përfaqësojnë Kosovën, në një të anë, dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri dhe/ose një përfaqësues i Komisionit, nga ana tjetër;
 - (b) duke shfrytëzuar plotësisht të gjitha kanalet e duhura mes Palëve, përfshirë kontaktet e duhura me shtetet që nuk janë anëtare të BE-së dhe në kuadër të organizatave ndërkombëtare dhe forumeve tjera ndërkombëtare, nëse këtë e lejojnë rrethanat objektive;
 - (c) çdo masë tjetër që do të kontribuonte në konsolidimin, zhvillimin dhe thellimin e këtij dialogu, përfshirë ato të identifikuar në agjendën e Selanikut, miratuar në Konkluzionet e Këshillit Evropian në Selanik me 19 dhe 20 qershor të vitit 2003.

NENI 15

Dialogu politik në nivel parlamentar zhvillohet brenda kornizës së Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit të themeluar në bazë të nenit 132.

TITULLI III

BASHKËPUNIMI RAJONAL

NENI 16

Në përputhje me zotimet e saja sipas nenit 5 dhe 13 si dhe zotimet për paqe dhe stabilitet ndërkombëtar e rajonal dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, Kosova duhet në mënyrë aktive të promovojë bashkëpunimin rajonal. BE-ja përmes instrumenteve të asistencës, përfshirë asistencën për projekte që përmbajnë dimension rajonal ose ndërkufitar, mund të përkrah këto përpjekje.

Kurdo që Kosova planifikon të përforcojë bashkëpunimin e saj me njërin nga vendet e përmendura në nenet 17, 18 dhe 19, ajo do të informojë dhe do të konsultohet me BE-në në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Titullin X.

Kosova do të vazhdon të zbatoj Marrëveshjen e Tregtisë së Lire të Evropës Qendrore.

NENI 17

Bashkëpunimi me vendet tjera që kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit

Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, nëse e lejojnë rrethanat objektive, Kosova do të nisë negociatat me vendet që tashmë kanë nënshkruar një Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit me BE-në me qëllim të nënshkrimit të konventave dypalëshe për bashkëpunim rajonal, synimi i të cilave do të jete shtimi i fushave të bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Elementet kryesorë të këtyre konventave do të jenë:

- (a) dialogu politik;
- (b) vendosja e zonave të tregtisë së lirë, në përputhje me dispozitat përkatëse të OBT-së;
- (c) koncesione të ndërsjella lidhur me lëvizjen e punonjësve, themelimin, ofrimin e shërbimeve, pagesat rrjedhëse dhe lëvizjen e kapitalit, si dhe politika të tjera që kanë të bëjnë me lëvizjen e personave në një nivel të barabartë me atë të Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit, që ai shtet përkatës ka lidhur me BE-në;
- (d) dispozitat për bashkëpunimin në fusha tjera të cilat mbulohen apo nuk mbulohen nga kjo marrëveshje, kryesisht në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë

Këto konventa do të përmbajnë dispozita për krijimin e mekanizmave të nevojshëm institucional, sipas nevojës.

Konventat do të nënshkruhen brenda dy viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.

NENI 18

Bashkëpunimi me vendet e ndërlidhura me PSA

Kosova do të ndjek bashkëpunimin rajonal me vendet tjera që ndërlidhen me PSA-në, në disa apo në të gjitha fushat e bashkëpunimit të cilat i mbulon kjo Marrëveshje si dhe fushat tjera të ndërlidhura me PSA-në, veçanërisht në fushat me interes të përbashkët. Një bashkëpunim i tillë duhet të jetë gjithmonë në përputhje me parimet dhe objektivat e kësaj Marrëveshje.

NENI 19

Bashkëpunimi me vendet candidate për anëtarësim në BE që nuk ndërlidhen me PSA

Nëse e lejojnë rrethanat objektive, Kosova do të nxisë bashkëpunimin e saj dhe do të lidh konventa për bashkëpunim me cilindo vend kandidat për anëtarësim në BE që nuk ndërlidhet me PSA-në në fushat e bashkëpunimit të mbuluara me këtë Marrëveshje dhe fushat tjera me interes të përbashkët për Kosovën dhe këto vende. Konventat e tilla duhet të synojnë gradualisht të harmonizojnë marrëdhëniet dypalëshe mes Kosovës dhe atyre vendeve me pjesën përkatëse të marrëdhënieve mes BE-së dhe Kosovës.

TITULLI IV

LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

NENI 20

1. BE-ja dhe Kosova gradualisht do të themelojnë një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe maksimale prej 10 vitesh duke filluar nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe në përputhje me GATT 1994 si dhe me dispozitat e përfshira në marrëveshjet relevante me OBT-në. Duke bërë këtë, ata marrin parasysh kërkesat specifike të parashtruara në paragrafët 2 deri 6 të këtij neni.

2. Nomenklatura e Kombinuar do të zbatohet për klasifikimin e mallrave në tregtinë ndërmjet Palëve.

3. Për qëllim të kësaj Marrëveshje, tarifat dhe detyrimet doganore që kanë efekt të njëjtë me detyrimet doganore përfshijnë çfarëdo detyrimi apo tarife të shqiptuar në lidhje me importimin ose eksportimin e një malli, përfshirë çfarëdo forme të mbi-tatimit apo tarifës shtesë në lidhje me importin ose eksportin e tillë, por nuk përfshin ndonjë:

- (a) tarifë ekuivalente me një taksë të brendshme të shqiptuar vazhdimisht sipas paragrafit 2 të nenit III të GATT 1994;
- (b) masë anti-damping ose kundër-balancuese;
- (c) tarifë apo ngarkesë konform kostove të shërbimeve të ofruara.

4. Për çdo produkt, detyrimet bazë mbi të cilin do të zbatohen uljet tarifore pasuese të përcaktuara në këtë Marrëveshje, do të jenë:

- (a) Për BE-në, Tarifa e Përbashkët Doganore e BE-së, e themeluar në pajtim me Rregulloren e

Këshillit (EEC) Nr. 2658/87 ¹ që faktikisht aplikohet *erga omnes* në ditën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje;

(b) Për Kosovën, tarifa është aplikuar që nga data 31 dhjetor 2013.

5. Nëse, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, zbatohet ndonjë ulje tarifore mbi bazën *erga omnes*, tarifat e tilla të ulura zëvendësojnë tarifën bazë të përmendur në paragrafin 4, që nga data kur zbatohen uljet e tilla.

6. BE-ja dhe Kosova do t'i komunikojnë njëra-tjetrës taksat bazë përkatëse të tyre dhe për çdo ndryshim tjetër.

¹ Rregullorja e Këshillit (EEC) Nr. 2658/87 (OJ EU L 256, 7.9.1987, f. 1).

KAPITULLI I

PRODUKTET INDUSTRIALE

NENI 21

Përkufizimi

1. Ky Kapitull do të aplikohet për produktet që e kanë origjinën në BE ose në Kosovë të cilat janë të renditura në Kapitujt 25 deri 97 të Nomenklaturës së Kombinuar, me përjashtim të produkteve të renditura në Shtojcën I, paragrafin I, pikën (ii) të Marrëveshjes për Bujqësi të OBT-së.
2. Tregtia mes Palëve për produktet të cilat mbulohen nga Traktati i cili themelon Komunitetin Evropian për Energji Atomike, do të zhvillohet në përputhje me atë Traktat.

NENI 22

Koncesionet e BE-së për produktet industriale

1. Detyrimet doganore për importet drejt BE-së dhe ngarkesat që kanë ndikim të njëjtë do të shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje për produktet që kanë origjinë në Kosovë.

Kufizimet sasiore për importet drejt BE-së dhe masat të cilat kanë efekt të njëjtë, për produktet që e kanë origjinën në Kosovë, do të shfuqizohen në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.

NENI 23

Koncesionet e Kosovës për produktet industriale

1. Tarifat doganore për importet në Kosovë të produkteve industriale që e kanë origjinën në BE përveç atyre të listuara në Shtojcën I do të shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje.
2. Ngarkesat që kanë efekt të njëjtë me tarifat doganore për importe në Kosovë do të shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje mbi produktet industriale me origjinë nga BE-ja.
3. Tarifat doganore mbi importet në Kosovë të produkteve industriale me origjinë nga BE-ja të cilat janë të listuara në Shtojcën I, do të ulën në mënyrë progresive dhe do të shfuqizohen në përputhje me afatin kohor të përcaktuar në atë Shtojcë.
4. Kufizimet sasiore për importet në Kosovë të produkteve industriale që e kanë origjinën në BE dhe masat me efekt ekuivalent, do të shfuqizohen në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.

NENI 24

Detyrimet dhe kufizimet në eksport

1. BE-ja dhe Kosova, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje do të shfuqizojnë çdo tarife dhe ngarkese doganore mbi eksportet që kanë efekt ekuivalent në tregtinë ndërmjet tyre.
2. BE-ja dhe Kosova, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje do të shfuqizojnë çfarëdo kufizimi sasiore për eksportet dhe masat ekuivalente.

NENI 25

Zvogëlimet më të shpejta në detyrimet doganore

Kosova deklaron gatishmërinë e saj për të zvogëluar tarifat doganore në tregtinë me BE-në më shpejt se sa parashihet në nenin 23, në rast se situata ekonomike e përgjithshme e saj dhe situata e sektorit ekonomik në fjalë e lejojnë këtë.

KSA-ja do të analizojë situatën në këtë aspekt dhe do të jap rekomandime relevante.

KAPITULLI II

BUJQËSIA DHE PESHKATARIA

NENI 26

Përkufizimi

1. Ky Kapitull do të zbatohet për tregtinë e produkteve bujqësore dhe të peshkut që e kanë origjinën në BE ose në Kosovë.
2. Termi “produkte bujqësore dhe të peshkut” u referohet produkteve të listuara në Kapitullin 1 deri 24 të Nomenklaturës së Kombinuar¹, si dhe produkteve të renditura në Shtojcën I, paragrafin I, pikën (ii) të Marrëveshjes për Bujqësi të OBT-së.
3. Ky përkufizim përfshin peshqit dhe produktet e peshkut të mbuluara në Kapitullin 3, krerët 1604 (Peshk i përgatitur ose i konservuar, havjar dhe zëvendësues të havjarit të përgatitur nga vezët e peshkut) dhe 1605 (Krustacet, molusqet dhe pa-kurrizorë të tjerë ujorë, të përgatitur apo të konservuar (me përjashtim të tymosur)), dhe nën-krerët 0511 91 (mbetje peshku), 2301 20 (Miellrat, ushqimet dhe sferat prej peshku ose krustaceve, molusqeve apo pa-kurrizorëve tjerë ujorë, të papërshtatshëm për konsum njerëzor) përveç 1902 10 ("pasta të mbushura që përmbajnë peshk, krustace, molusqe apo pa-kurrizorë tjerë ujorë më shumë se 20% të peshës").

Kjo gjithashtu përfshin nën-krerët 1212 21 00 (alga deti dhe alga tjera), me përjashtim të nën-TITULLIT 1603 00 (Ekstraktet dhe lëngjet e peshkut apo krustaceve, molusqeve apo pa-kurrizorëve tjerë ujorë) dhe me përjashtim të nën-TITULLIT 2309 9010 (Përgatitjet e llojit për përdorim në ushqimin e kafshëve: tretjet e peshkut), si dhe 1504 10 dhe 1504 20 (yndyrat, vajrat dhe fraksionet e tyre, të peshkut, të rafinuara ose jo, por jo të modifikuara kimikisht):

- Vajrat e mëlçisë së peshkut dhe fraksionet e tyre;

¹Referencat për kodet e mallrave dhe përshkrimet janë në përputhje me Nomenklaturën e Kombinuar të aplikuar në vitin 2014, në përputhje me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) Nr.1001/2013 të datës 4 tetor 2013 për ndryshimin e Shtojcës I të Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 2658/87 mbi tarifën dhe nomenklaturën statistikore dhe mbi Tarifën e Përbashkët Doganore (OJ EU L 290, 31.10.2013, f. 1).

- Yndyrat, vajrat dhe fraskionet e tyre, të peshkut, përveç vajrave të mëlçisë).

NENI 27

Produktet e përpunuara bujqësore

Protokolli I përcakton masatregtare për produktet bujqësore të përpunuara, të listuara në të.

NENI 28

Koncesionet e BE-së mbi importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Kosovë

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, BE-ja do të shfuqizojë të gjitha kufizimet sasiore, dhe masat me efekt të njëjtë mbi importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Kosovë.
2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, BE-ja do të shfuqizojë detyrimet doganore dhe pagesat me efekt të njëjtë për importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Kosovë, përveç atyre të krerëve 0102 (gjedhe të gjalla), 0201, (mish gjedhi, i freskët ose i ftohur) 0202 (mish gjedhi, i ngrirë), 1701 (Sheqer nga kallami ose nga panxhari dhe sakarozë kimikisht e pastër, në formë të ngurtë), 1702 (Sheqerna tjera, duke përfshirë laktozën, maltozën, glukozën dhe fruktozën kimikisht të pastra në formë të ngurtë; shurupet e sheqerit që nuk përmbajnë aromatizues ose ngjyrosës; mjaltë artificiale, qoftë e përzier ose jo me mjaltë natyrale; karamel) dhe 2204 (Verërat nga rrushi i freskët, përfshirë verërat e fortifikuara; mushti i rrushit përveç atij të cekur në kreun 2009) i Nomenklaturës së Kombinuar.

Për produktet e mbuluara me Kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinuar, për të cilat Tarifa e Përbashkët Doganore parasheh zbatimin e detyrimeve doganore *ad valorem* dhe një detyrim specifik doganor, eliminimi do të zbatohet vetëm ndaj pjesës *ad valorem* të detyrimit.

3. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, BE-ja do të rregullojë detyrimet doganore

të aplikueshme për importet në BE të produkteve të "mishit të viçit të ri" të përcaktuara në Shtojcën II dhe me origjinë në Kosovë në 20% të detyrimit *ad valorem* dhe 20% të detyrimit specifik siç është përcaktuar në Tarifën e Përbashkët Doganore, brenda kufirit të një kuote tarifore vjetore prej 475 tonësh e shprehur në peshën e mbetjeve të kafshëve.

NENI 29

Koncesionet e Kosovës për produktet bujqësore

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Kosova do të shfuqizojë të gjitha kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë mbi importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në BE.
2. Që nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Kosova do të:
 - (a) shfuqizojë tarifatat doganore të aplikueshme për importet e produkteve të caktuara bujqësore që e kanë origjinën në BE, përveç atyre të listuara në Shtojcën III;
 - (b) shfuqizojë në mënyrë progresive tarifatat doganore të aplikueshme për importet e produkteve të caktuara bujqësore që e kanë origjinën në BE, të listuara në Shtojcën IIIa, IIIb dhe IIIc dhe në përputhje me afatin kohor të cekur në atë Shtojcë.
3. Tarifa e aplikueshme për produkte të caktuara të listuara në Shtojcën III d do të jetë tarifa bazë e aplikuar në Kosovë që nga data 31 dhjetor 2013.

NENI 30

Protokolli i verërave dhe pijeve alkoolike

Masat e zbatueshme për produktet e verës dhe pijeve alkoolike të referuara në Protokollin II janë përcaktuar në atë Protokoll.

NENI 31

Koncesionet e BE-së për produktet e peshkut dhe peshkatarisë

1. Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, BE-ja do të heq të gjitha kufizimet sasiore dhe masat që kanë të njëjtin efekt në importet e produkteve të peshkut dhe peshkatarisë me origjinë nga Kosova.
2. Që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, BE-ja do të heq të gjitha detyrimet doganore dhe masat që kanë të njëjtin efekt për produktet e peshkut dhe peshkatarisë me origjinë në Kosovë, përveç atyre të listuara në Shtojcën IV. Produktet e listuara në Shtojcën IV do t'u nënshtrohen dispozitave të përcaktuara aty.

NENI 32

Koncesionet e Kosovës për peshqit dhe produktet e peshkut

1. Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Kosova do të heq të gjitha kufizimet sasiore dhe masat që kanë të njëjtin efekt në importet e peshqve dhe produkteve të peshkut me origjinë në BE.
2. Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Kosova do të heq të gjitha tarifatat doganore dhe masat që kanë të njëjtin efekt për peshq dhe produktet e peshkut me origjinë nga BE, përveç atyre të listuara në Shtojcën V. Produktet e listuara në Shtojcën V do t'u nënshtrohen dispozitave të përcaktuara aty.

NENI 33

Klauzola e shqyrtimit

Duke marrë parasysh vëllimin e tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkut ndërmjet Palëve, ndjeshmëritë e tyre të veçanta, rregullat e politikave të përbashkëta të BE-së, politikat e Kosovës për bujqësi dhe peshkatari, rolin e bujqësisë dhe të peshkatarisë në ekonominë e Kosovës, si dhe zhvillimet në kuadër të OBT-së, KSA-ja do të ekzaminojë, jo më vonë se tri vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, produktet një nga një dhe mbi një bazë të ndërsjellë të rregullt dhe të përshtatshme mundësitë për t'i ofruar koncesione të mëtejshme njëri-tjetrit me synim zbatimin e një

liberalizimi më të madh të tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkut.

NENI 34

Klauzola e masave mbrojtëse në lidhje me bujqësinë dhe peshkatarinë

Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti të nenit 43, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e veçantë të tregjeve të bujqësisë dhe të peshkatarisë, në rast se importet e produkteve që kanë origjinën nga njëra Palë, të cilat u nënshtrohen koncesioneve të dhëna sipas neneve 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32, shkaktojnë çrregullime serioze në tregjet ose mekanizmat rregullues të brendshëm tek cilado Palë, të dyja Palët do të fillojnë menjëherë konsultimet në kuadër të Komitetit për Stabilizim-Asociim për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme. Përderisa në pritje të kësaj zgjidhjeje, Pala në fjalë mund të marrë masat që ajo i konsideron të nevojshme.

NENI 35

Mbrojtja e treguesve gjeografikë për produktet bujqësore dhe të peshkatarisë dhe ushqimeve tjera përveç verërave dhe pijeve alkoolike

1. Kosova do të ofrojë mbrojtje për treguesit gjeografikë të BE-së të regjistruar në BE sipas Rregullores (BE) Nr. 1151/2012 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 21 nëntor 2012 mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ato ushqimore¹, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Nen. Treguesit gjeografikë të Kosovës do të kenë të drejtën të regjistrohen në BE sipas kushteve të përcaktuara në këtë Rregullore.

2. Treguesit gjeografikë të referuar në paragrafin 1 do të mbrohen nga:

(a) çdo përdorim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë komercial i një emri të mbrojtur:

(i) për produkte të krahasueshme që nuk janë në përputhje me specifikimet e produktit të

¹ OJ EU L 343 të 14.12.2012, f. 1.

emrit të mbrojtur, ose

- (ii) në atë masë që një përdorim i tillë shfrytëzon reputacionin e një treguesi gjeografik;
- (b) çdo keqpërdorim, imitim apo evokim, edhe në qoftë se origjina e vërtetë e produktit apo shërbimit është cekur apo nëse emri i mbrojtur është përkthyer apo shoqëruar me shprehje të tilla si "stili", "lloji", "metoda", "siç prodhohet në", "imitim", "aromë", "sikurse" ose shprehje të ngjashme;
- (c) çdo tregues tjetër i rremë ose çorientues lidhur me prejardhjen, origjinën, natyrën ose cilësitë thelbësore të produktit, në paketimin e brendshëm apo të jashtëm, në materialin reklamues ose dokumentet që ndërlidhen me atë produkt dhe paketimin e produktit në një kuti që mund të jep një përshtypje të rreme në lidhje me origjinën e tij;
- (d) çdo praktikë tjetër që mund të çorientojë konsumatorin për origjinën e vërtetë të produkteve të ngjashme.

3. Një emër i propozuar për regjistrim që është tërësisht ose pjesërisht i njëjtte me një emër tashmë të mbrojtur, nuk do të mbrohet përderisa nuk ekziston dallim i mjaftueshëm në praktikë ndërmjet kushteve të përdorimit lokal dhe tradicional dhe prezantimit të homonimit të mbrojtur më pas dhe emrit tashmë të mbrojtur, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar trajtim të barabartë të prodhuesve në fjalë dhe që konsumatorët të mos çorientohen. Një homonim që e bënë konsumatorin të besojë se produktet vijnë nga një territor tjetër nuk do të regjistrohen edhe në qoftë se emri është i saktë për sa i përket territorit aktual, rajonit ose vendit të origjinës së produkteve në fjalë.

4. Kosova do të refuzojë regjistrimin e një marke tregtare, përdorimi i së cilës korrespondon me situatat e referuara në paragrafin 2.

5. Markat tregtare, përdorimi i të cilave korrespondon me situatat e referuara në paragrafin 2, të cilat janë të regjistruara në Kosovë apo janë krijuar përmes përdorimit, nuk do të përdoren pas pesë viteve të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, kjo nuk do të zbatohet për markat tregtare të regjistruara në Kosovë dhe për markat tregtare të krijuara përmes përdorimit të cilat janë në pronësi të shtetasve të vendeve të treta, me kusht që ato nuk janë të një natyre të tillë që mund të

mashtrojë në ndonjë mënyrë publikun sa i përket cilësisë, specifikimit dhe originës gjeografike të mallrave.

6. Çdo përdorim i treguesve gjeografikë të mbrojtur në pajtim me paragrafin 1 si terma tradicionalë në gjuhën e zakonshme dhe si emër i përbashkët për mallrat e tilla, ose për produktet që janë tregtuar në mënyrë të ligjshme me këtë term në Kosovë, do të pushojnë së ekzistuari më së largu pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

7. Kosova do të sigurojë që mallrat e eksportuara nga territori i saj pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të mos përbëjnë shkelje të këtij neni.

8. Kosova do të ofrojë mbrojtjen e referuar në paragrafët 1 deri 7 me iniciativë të saj, si dhe me kërkesë të palës së interesuar.

KAPITULLI III

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

NENI 36

Fushëveprimi

Ky Kapitull do të zbatohet për tregtinë e të gjitha produkteve ndërmjet Palëve, përveç rasteve kur parashihet ndryshe në këtë Kapitull ose në Protokollin I.

NENI 37

Koncesionet e përmirësuara

Ky Titull në asnjë mënyrë nuk do të ndikoj në aplikim, në baza të njëanshme, të masave më favorizuese nga cilado nga Palët.

NENI 38

Pezullimi

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, nuk do të vendosen tarifa të reja doganore për importet ose eksportet ose detyrime të reja me efekt të njëjtë, dhe nuk do të rriten as ato që zbatohen tashmë në tregtinë ndërmjet BE-së dhe Kosovës.
2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, nuk do të vendosen kufizime sasiore të reja për importet ose eksportet, apo masa të reja me efekt të njëjtë dhe nuk do të bëhen kufizime të mëtejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet BE-së dhe Kosovës.
3. Pa paragjykuar koncesionet e bëra me nenet 28, 29, 30, 31 dhe 32, paragrafët 1 dhe 2 të këtij

neni nuk do të kufizojnë në asnjë mënyre ushtrimin e politikave përkatëse bujqësore dhe të peshkatarisë së BE-së dhe Kosovës ose marrjen e ndonjë mase në kuadër të atyre politikave, për aq kohë sa nuk ndikon në regjimin e importeve në Shtojcat II deri V dhe në Protokollin I.

NENI 39

Ndalimi i diskriminimit fiskal

1. BE-ja dhe Kosova do të përmbahen nga marrja e masave ose praktikave me natyrë fiskale të brendshme, që drejtpërsëdrejti ose tërthorazi shkaktojnë diskriminim ndërmjet produkteve të njëjës Palë dhe produkteve të ngjashme që e kanë origjinën nga territori i Palës tjetër. Aty ku një masë apo praktikë e tillë ekziston, BE-ja dhe Kosova, sipas nevojës do të shfuqizojnë ose anulojnë atë.
2. Produktet e eksportuara në territorin e njëjës Palë nuk mund të përfitojnë nga rimbursimi për tatimin e tërthortë të brendshëm që kalon shumën e tatimit të tërthortë të vendosur mbi to.

NENI 40

Tarifat e natyrës fiskale

Dispozitat lidhur me shfuqizimin e tarifave doganore për importet zbatohen edhe për detyrimet doganore me natyrë fiskale.

NENI 41

Bashkimet doganore, zonat e tregtisë së lirë, Marrëveshjet ndërkufitare/kufitare

1. Kjo Marrëveshje nuk pengon vazhdimin apo krijimin e bashkimeve doganore, zonave të tregtisë së lirë apo marrëveshjeve për tregtinë kufitare/ndërkufitare, përveçse në rastet kur ato ndryshojnë rregullat tregtare të parashikuara nga kjo Marrëveshje.
2. Gjatë periudhave transitore të përcaktuara në nenin 20, kjo Marrëveshje nuk do të ndikon në zbatimin e marrëveshjeve preferenciale specifike që rregullojnë lëvizjen e mallrave, qoftë të parashtruara në Marrëveshjet kufitare/ndërkufitare të arritura më parë ndërmjet një ose më shumë Shteteve Anëtare dhe Kosovës, ose që kanë rrjedhur prej marrëveshjeve dypalëshe të përcaktuara në Titullin II të arritura nga Kosova për të promovuar tregtinë rajonale.
3. Konsultimet ndërmjet Palëve zhvillohen në kuadër të KSA-së lidhur me Marrëveshjet që referohen në paragrafët 1 dhe 2, dhe kur kërkohen, për çështje tjera të rëndësishme që lidhen me politikat e tyre përkatëse të tregtisë ndaj vendeve të treta. Veçanërisht në rast se një vend i tretë anëtarësohet në BE, konsultimet e tilla do të zhvillohen në mënyrë që të garantohet marrja parasysh e interesave të ndërsjella të BE-së dhe Kosovës siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje.

NENI 42

Dumpingu dhe subvencioni

1. Kjo marrëveshje nuk i pengon Palët që të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e tregtisë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni dhe nenit 43.
2. Nëse njëra nga Palët zbulon se në tregtinë me Palën tjetër po ndodh dumpingu dhe/ose subvencionimi kundërveprues, kjo Palë mund të ndërmarrë masat e duhura kundrejt kësaj praktike në përputhje me Marrëveshjen e OBT-së për Zbatimin e Nenit VI të GATT 1994 ose me Marrëveshjen e OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundër-balancuese dhe legjislacionin e brendshëm lidhur me ato marrëveshje.

NENI 43

Klauzola për masa mbrojtëse

1. Palët pajtohen që të zbatohen rregullat dhe parimet e nenit XIX të GATT 1994 dhe Marrëveshja e OBT-së për Masat Mbrojtëse.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1, Pala importuese mund të ndërmarrë masat e duhura mbrojtëse bilaterale sipas kushteve dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë nen, ku çdo produkt i njëjës Palë importohet në territorin e Palës tjetër në sasi të tilla të rritura dhe në kushte të tilla që shkakton ose rrezikon të shkaktoj:
 - (a) dëme serioze ndaj industrisë vendase të produkteve të ngjashme ose që janë drejtpërsëdrejti konkurruese, në territorin e Palës importuese; ose
 - (b) çrregullime serioze në cilindo sektor të ekonomisë apo vështirësi që mund të sjellin përkeqësim serioz të situatës ekonomike në një rajon të Palës importuese.
3. Masat mbrojtëse dypalëshe kundrejt importeve të Palës tjetër nuk duhet të tejkalojnë nivelin e nevojshëm për riparimin e problemeve, siç është përcaktuar në paragrafin 2, të cilat janë shfaqur si

rezultat i aplikimit të kësaj Marrëveshje. Masat e miratuara mbrojtëse duhet të konsistojnë me pezullimin e rritjes ose zvogëlimin e margjinës së preferencave të ofruara me këtë Marrëveshje për produktin përkatës deri në një kufi maksimal që korrespondon me normën bazike tarifore të referuar në nenin 20, paragrafin 4(a) dhe (b) dhe paragrafin 5 për të njëjtin produkt. Masa të tilla duhet të përmbajnë elementë të qarta që në mënyrë progresive dërgojnë drejt eliminimit të tyre më së voni në fund të periudhës së vendosur dhe nuk do të ndërmerren për një periudhë më të gjatë se dy vite.

Në rrethana shumë të jashtëzakonshme, masat mund të zgjaten për një periudhë shtesë maksimale prej dy vitesh. Asnjë masë mbrojtëse dypalëshe nuk do të zbatohet për importin e një produkti që më parë i është nënshtruar një mase të tillë për një periudhë të barabartë me atë gjatë së cilës masa ishte aplikuar me pare, me kusht që periudha e mos-aplikimit të jete të paktën dy vite që nga skadimi i masës.

4. Në rastet e përcaktuara në këtë nen, përpara marrjes së masave të parashikuara në të, ose në rastet kur aplikohet paragrafi 5 (b) i këtij neni, sapo të jetë e mundur BE-ja ose Kosova do t'i japin KSA-së të gjithë informacionin relevant të kërkuar për një ekzaminim të hollësishëm të situatës me synim për të kërkuar zgjidhje të pranueshme nga të dy Palët.

5. Për zbatimin e paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 aplikohen dispozitat e mëposhtme:

(a) Problemet që lindin nga situata e referuar në këtë nen i kalohen menjëherë për shqyrtim KSA-së, i cili mund të marrë çfarëdolloj vendimi të nevojshëm për t'i dhënë fund këtyre problemeve.

Nëse KSA-ja ose Pala eksportuese, brenda 30 ditëve pasi çështja i është kaluar për shqyrtim KSA-së nuk ka marrë një vendim për t'i dhënë fund këtyre problemeve ose kur nuk është arritur ndonjë zgjidhje tjetër e kënaqshme, Pala importuese mund të miratojë masat e duhura për të zgjidhur problemin në përputhje me këtë nen. Gjatë përzgjedhjes së masave mbrojtëse përparësi duhet dhënë atyre që pengojnë më pak funksionimin e aranzhimeve të vendosura në këtë Marrëveshje. Masat mbrojtëse do të ruajnë nivelin/margjinën e preferencave të ofruara nga kjo Marrëveshje.

(b) Kur rrethanat e jashtëzakonshme dhe kritike kërkojnë veprim të menjëhershëm dhe e bëjnë të pamundur informacionin ose shqyrtimin paraprak, siç mund të jete rasti, Pala përkatëse, në situatat e përcaktuara në këtë nen, mund të aplikoj menjëherë masa të përkohshme të

nevojshme për tu përballur me situatën dhe e informon menjëherë Palën tjetër për këtë.

Masat mbrojtëse i njoftohen menjëherë KSA-së, dhe do t'i nënshtrohen konsultimeve periodike brenda këtij organi, veçanërisht me synimin për të përcaktuar një kalendar veprimesh për anulimin e tyre sapo të lejojnë rrethanat.

6. Në rast se BE-ja ose Kosova, ju nënshtrohen importet e produkteve që rrezikojnë të shkaktojnë vështirësitë e përmendura në këtë nen, një procedure administrative që ka për qëllim sigurimin e shpejtë të informacionit për tendencën e rrjedhave tregtare, pra do të informoj Palën tjetër.

Klauzola e pamjaftueshmërisë

1. Kur pajtueshmëria me dispozitat e këtij Titulli sjell:
 - (a) një pamjaftueshmëri serioze, ose një rrezik për artikujt ushqimorë ose produkte tjera thelbësorë për Palën eksportuese; ose
 - (b) ri-eksportim në një vend të tretë të një produkti ndaj të cilit Pala eksportuese mban kufizime sasiore për eksportin, tarifat ose masat për eksport që kanë efekt të njëjtë, dhe kur situata e përmendur më sipër shkakton, ose mund të shkaktoj vështirësi të mëdha për Palën eksportuese, atëherë ajo Palë mund të marrë masat e duhura në përputhje me kushtet dhe procedurat e vendosura në këtë nen.
2. Gjatë përzgjedhjes së masave duhet dhënë përparësi atyre masave që ndikojnë më pak negativisht në funksionimin e aranzhimeve të kësaj Marrëveshje. Këto masa nuk zbatohen në mënyrë të atillë që të shkakton diskriminim arbitrar ose të pajustificueshëm ku mbizotërojnë të njëjtat kushte, ose një kufizim i tërthortë në tregti dhe duhet të eliminohen kur kushtet nuk e arsyetojnë më mbajtjen e tyre.
3. Përpara marrjes së masave të parashikuara në paragrafin 1 ose, sapo të jetë e mundur në rastet kur zbatohet paragrafi 4, BE-ja ose Kosova do t'i japin KSA-së të gjithë informacionin përkatës, me qëllim që të kërkohet një zgjidhje e pranueshme për Palët. KSA-ja mund të dakordohet për çfarëdo mase të nevojshme për t'i dhënë fund vështirësive. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje brenda 30 ditëve pasi çështja i është kaluar KSA-së, Pala eksportuese mund të zbatojë masat e përmendura në këtë nen për eksportimin e produktit përkatës.
4. Kur rrethanat e jashtëzakonshme dhe kritike kërkojnë veprim të menjëhershëm dhe e bëjnë të pamundur informimin ose shqyrtimin paraprak, siç mund të jete rasti, BE-ja ose Kosova mund të zbatojnë sa më parë masat parandaluese të nevojshme për të trajtuar situatën dhe do të informojnë Palën tjetër menjëherë për këtë.

5. Çdo masë e zbatuar sipas këtij neni i njoftohet menjëherë KSA-së dhe i nënshtrohet konsultimeve periodike brenda atij organi, në veçanti me qëllim të përcaktimit të një kalendari veprimesh për eliminim e tyre sapo ta lejojnë rrethanat.

NENI 45

Monopolet shtetërore

Sa i përket monopoleve shtetërore me karakter tregtar, Kosova do të sigurohet se që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje të mos ekzistojnë diskriminime lidhur me kushtet sipas të cilave prokurohen dhe tregtohen mallrat ndërmjet qytetarëve të Shteteve Anëtare dhe qytetareve të Kosovës.

NENI 46

Rregullat e origjinës

Përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë Marrëveshje, Protokollu III parashtron rregullat e origjinës për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje.

NENI 47

Kufizimet e autorizuara

Kjo Marrëveshje nuk përjashton ndalimet apo kufizimet e importeve, eksporteve ose mallrave transite të justifikuara në bazë të moralit publik, politikave publike, ose sigurisë publike; mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve; mbrojtjes së thesareve me vlerë artistike, historike ose arkeologjike, ose mbrojtjes së pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, ose të rregullave që ndërlidhen me arin dhe argjendin. Megjithatë, ndalimet ose kufizimet e tilla nuk do të përbëjnë diskriminim arbitrar ose kufizim të tërthortë në tregtinë ndërmjet Palëve.

Dështimi për të ofruar bashkëpunim administrativ

1. Palët bien dakord që bashkëpunimi administrativ është i domosdoshëm për zbatimin dhe kontrollin e trajtimit të privilegjuar të dhënë sipas këtij Titulli dhe theksojnë angazhimin e tyre për të luftuar parregullsitë dhe mashtrimin në dogana dhe çështjet relevante.

2. Kur njëra Palë, në bazë të informacionit objektiv, ka konstatuar mungesën e bashkëpunimit administrativ dhe/ose parregullsi apo mashtrim sipas këtij Titulli, ajo Palë (referuar në këtë nen si “Pala në fjalë”) mund të pezulloj përkohësisht trajtimin privilegjuar të produktit/produkteve përkatëse në përputhje me këtë nen.

3. Për qëllimet e këtij neni, mungesa e bashkëpunimit administrativ do të thotë, përveç të tjerash:

(a) mosrespektim i përsëritur i detyrimeve për të verifikuar statusin e origjinës së produktit/produkteve përkatës;

(b) refuzim i përsëritur ose vonesë e panevojshme për të kryer dhe/ose komunikuar rezultatet e një verifikimi pasues për dëshminë e origjinës;

(c) refuzim i përsëritur ose vonesë e panevojshme në marrjen e autorizimit për kryerjen e misionëve të bashkëpunimit administrativ për të verifikuar vërtetësinë e dokumenteve ose saktësinë e informacionit të nevojshëm për dhënien e trajtimit preferencial në fjalë.

Për qëllimet e këtij neni, konstatimi i parregullsive ose mashtrimit mund të bëhet, përveç tjerash, kur ka një rritje të shpejtë, pa shpjegime të kënaqshme të importeve të mallrave që tejkalojnë nivelin e zakonshëm të prodhimit dhe kapacitetit eksportues të Palës tjetër, e cila lidhet me informacionet objektive që kanë të bëjnë me parregullsitë ose mashtrimet.

4. Zbatimi i pezullimit të përkohshëm u nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

(a) Pala që ka bërë një konstatim mbi bazën e informacionit objektiv, të mungesës së bashkëpunimit administrativ dhe/ose parregullsive ose mashtrimit do të njofton pa vonesa të

panevojshme Komitetin e Stabilizim-Asociimit për konstatimin e tij së bashku me informacionin objektiv dhe do të fillon konsultimet me Palën tjetër pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit, në bazë të gjithë informacioneve përkatëse dhe konstatimeve objektive, me synim arritjen e një zgjidhjeje të pranueshme nga të dyja Palët.

- (b) Në rast se Palët kanë filluar konsultimet në kuadër të Komitetit të Stabilizim-Asociimit sipas pikës(a) dhe kanë dështuar të bien dakord për një zgjidhje të pranueshme brenda tri muajsh pas njoftimit, Pala e prekur mund të pezullojë përkohësisht trajtimin preferencial përkatës të produktit/produkteve përkatëse. Pezullimi i përkohshëm do t'i njoftohet menjëherë Komitetit të Stabilizim-Asociimit.
- (c) Pezullimet e përkohshme në bazë të këtij neni do të kufizohen në nivelin minimal të nevojshëm për të mbrojtur interesat financiare të Palës së prekur. Ato nuk zgjasin për më shumë se gjashtë muaj, periudhë e cila mund të rinovohet. Pezullimet e përkohshme i njoftohen Komitetit të Stabilizim-Asociimit menjëherë pas miratimit të tyre. Ato u nënshtrohen konsultimeve periodike në kuadër të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, veçanërisht me synimin për t'i përfunduar ato sapo të mos ketë më kushte për zbatimin e këtyre pezullimeve.

5. Njëkohësisht me njoftimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit sipas paragrafit 4a) të këtij neni, Pala e prekur duhet të publikojë një njoftim për importuesit në Gazetën e saj Zyrtare. Njoftimi për importuesit duhet të tregojë për produktin në fjalë se në bazë të informacioneve objektive, është konstatuar mungesa e bashkëpunimit administrativ dhe/ose e parregullsive apo mashtrimeve.

NENI 49

Në rast të gabimit të bërë nga autoritetet kompetente në menaxhimin e duhur të sistemit preferencial të eksportit dhe në veçanti gjatë zbatimit të Protokollit III, ku ky gabim shpjen në pasoja lidhur me tarifën e importit, Pala Kontraktuese që përballlet me këto pasoja mund t'i kërkojë KSA-së shqyrtimin e mundësive për miratimin e të gjitha masave të duhura që synojnë zgjidhjen e situatës.

TITULLI V

THEMELIMI, OFRIMI I SHËRBIMEVE DHE KAPITALI

NENI 50

Përkufizimi

Për qëllime të kësaj marrëveshje:

- (1) "Kompani e BE-së" dhe "Kompani e Kosovës" do të thotë një kompani e themeluar në përputhje me ligjet e Shtetit Anëtar, ose të Kosovës, dhe që ka zyrat e saj të regjistruar ose administratën qendrore apo vendin parësor të biznesit në territorin e BE-së apo të Kosovës. Megjithatë, nëse një kompani ka të regjistruar zyrën e saj vetëm në territorin e BE-së apo të Kosovës, atëherë kompania do të konsiderohet kompani e BE-së apo kompani e Kosovës nëse veprimtaria e saj posedon një lidhje reale dhe të vazhdueshme me ekonominë e një nga Shteteve Anëtare ose të Kosovës;
- (2) "Filial" i një kompanie nënkupton një kompani e cila kontrollohet në mënyrë efektive nga një kompani tjetër;
- (3) "Degë" e një kompanie nënkupton një vend biznesi i cili nuk gëzon personalitet juridik dhe që ka statusin e përhershëm, si një shtrirje e kompanisë amë, që ka një menaxhim dhe është e pajisur materialisht për të negociuar çështje biznesi me palët e treta, kështu që këto të fundit, ndonëse janë në dijeni, se në rast nevojë do të ekzistoj lidhja juridike me kompaninë amë, zyra qendrore e së cilës ndodhet jashtë vendit, nuk janë të detyruar të bashkëpunojnë direkt me një organ të tillë amë, por mund të bëjnë transaksione biznesi në vendin e biznesit që përbën shtrirjen;
- (4) "Themelimi" nënkupton të drejtën për të zhvilluar një veprimtari ekonomike duke themeluar kompani, përfshirë filialet dhe degët në BE ose në Kosovë;

- (5) "Veprimtari" nënkupton ushtrimin e veprimtarive ekonomike;
- (6) "Veprimtari ekonomike" në parim përfshin veprimtaritë me një karakter industrial, tregtar ose profesional si dhe veprimtaritë artizanale;
- (7) "Shtetas i BE-së" dhe "qytetar i Kosovës" nënkuptojnë një person fizik i cili është shtetas i Shtetit Anëtar apo qytetar i Kosovës;
- (8) "Shërbime financiare" nënkuptojnë veprimtaritë e përshkruara në Shtojcën VI.

KAPITULLI I

THEMELIMI

NENI 51

1. Kosova duhet të lehtësoj ngritjen e veprimtarive në territorin e saj nga kompanitë e BE-së. Për këtë qëllim, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Kosova duhet të ofrojë:
 - (a) për sa i përket vendosjes së kompanive të BE-së në territorin e Kosovës, trajtim jo më pak të favorshëm se ai që i ofron kompanive të saj ose kompanive të një vendi të tretë, cilado qoftë më e mirë;
 - (b) për sa i përket veprimtarive të filialeve dhe degëve të kompanive të BE-së në territorin e Kosovës pas themelimit të tyre, trajtim jo më pak të favorshëm se ai që i ofrohet kompanive dhe degëve të saja ose të një filiali apo dege të një kompanie të një vendi të tretë, cilado qoftë më e mirë.
2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, BE duhet të ofrojë:
 - (a) për sa i përket vendosjes së kompanive Kosovare, trajtim jo më pak të favorshëm se sa atë që ofrohet nga BE-ja për kompanitë e saja ose kompanitë e një vendi të tretë, cilado qoftë më e mirë;
 - (b) sa i përket veprimtarive të filialeve dhe degëve të kompanive Kosovare të vendosura në territorin e saj, trajtim jo më pak të favorshëm se atë të ofruar nga BE për kompanitë dhe degët e saja ose filialit dhe degës së një kompanie të një vendi të tretë, të vendosura në territorin e tyre, cilado qoftë më e mirë.
3. Palët nuk duhet të miratojnë asnjë rregull apo masë të re e cilat paraqet diskriminim lidhur me vendosjen e kompanive të cilësdo Palë në territorin e tyre ose në lidhje me veprimtaritë e tyre, pasi që janë themeluar, në krahasim me kompanitë e tyre.

4. Pavarësisht këtij neni,
- (a) që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, filialet dhe degët e kompanive të BE-së, gëzojnë të drejtën për të përdorur dhe marrë me qira pasuri të patundshme në Kosovë;
 - (b) filialet dhe degët e shoqërive të BE-së, duhet që brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, të gëzojnë të drejtën e përvetësimit dhe gëzimit të drejtave të pronësisë mbi pasuritë e patundshme sikurse kompanitë Kosovare dhe, për sa i përket të mirave publike/mallrave me interes të përbashkët, të njëjtat drejta të gëzuara nga kompanitë Kosovare, respektivisht ku këto të drejta janë të domosdoshme për kryerjen e veprimtarive ekonomike për të cilat ato janë vendosur.

NENI 52

1. Bazuar në nenin 54, Palët mund të rregullojnë vendosjen dhe veprimtarinë e kompanive në territorin e tyre, përderisa këto rregullore nuk diskriminojnë kompanitë e palëve tjera në krahasim me kompanitë e veta.
2. Për sa u përket shërbimeve financiare, pavarësisht nga dispozitat tjera të kësaj Marrëveshjeje, Pala nuk duhet të pengohet që të marrë masa për arsye kujdesi paraprak, përfshirë mbrojtjen e investitorëve, depozituesve, personave të siguar ose personave të cilët kanë detyrime financiare për të shlyer tek një ofrues i shërbimeve financiare, ose për të siguar integritetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Masat e tilla nuk përdoren si mënyrë për të shmangur detyrimet e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.
3. Në këtë Marrëveshje asgjë nuk interpretohet në mënyrë të atillë që të detyrojë Palën të bëjë publike informacione lidhur me punët dhe llogaritë e klientëve individualë ose çfarëdo informacioni konfidencial ose pronësor që disponojnë subjektet publike.

NENI 53

1. Ky kapitull nuk paragjykon dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Transportit me Ballkanin Perëndimor dhe të Marrëveshjes Shumëpalëshe për vendosjen e një Zone të Përbashkët Evropiane të Aviacionit të nënshkruar më 9 qershor 2006¹.
2. Në kuadër të fushëveprimit të politikës së transportit të BE, KSA mund të bëjë rekomandime në rastet specifike për përmirësimin e vendosjes dhe veprimtarive në zonat e trajtuara nga paragrafi.
3. Ky Kapitull nuk do të zbatohet për shërbimet e transportit detar.

NENI 54

1. Neni 51 dhe 52 nuk përjashtojnë zbatimin e rregullave të veçanta nga Pala lidhur me vendosjen dhe veprimtarinë në territorin e saj të degëve të shoqërive të një Pale tjetër jo të krijuar në territorin e Palës së parë, të cilat justifikohen me dallime legislative ose teknike ndërmjet degëve të tilla, krahasuar këto me degët e shoqërive të vendosura në territorin e saj ose për sa u përket shërbimeve financiare, për arsye të kujdesit.
2. Dallimi në trajtim nuk e tejkalon atë që është domosdoshme për shkak të dallimeve legislative ose teknike, apo për sa u përket shërbimeve financiare, për arsye të kujdesit.

¹ OJ EU L 285, 16.10.2006, f. 3.

KAPITULLI II

OFRIMI I SHËRBIMEVE

NENI 55

1. Një kompani e BE-së e vendosur në territorin e Kosovës ose një kompani Kosovare e vendosur në BE gëzon të drejtën të punësojë, ose të ketë të punësuar përmes një prej filialeve ose dege të saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin pritës të vendosjes së kompanisë, përkatësisht në territorin e BE-së dhe të Kosovës, punonjësit të cilët janë shtetas të BE-së apo qytetarë të Kosovës, me kusht që punonjësit e tillë të jenë personel kyç siç përcaktohet në paragrafin 2 dhe që janë punësuar ekskluzivisht nga kompania, filialet apo degët.

2. Personeli kyç i kompanive të sipërpërmendura, referuar më poshtë si “organizata”, janë “të transferuar brenda-kompanisë” siç përcaktohet në pikën (c) të këtij paragrafi në kategoritë e mëposhtme, me kusht që organizata të jetë një person juridik dhe që personat e interesuar të kenë qenë të punësuar prej saj ose partnerë me të (por jo aksionerë me shumicën e aksioneve), të paktën gjatë atij viti që paraprin një lëvizje e tillë:

(a) Personat që punojnë në një pozicion drejtues në një organizatë, të cilët drejtojnë kryesisht menaxhimin e ndërmarrjes, dhe që mbikëqyren në mënyrë të përgjithshme ose marrin udhëzime kryesisht nga bordi i drejtorëve ose i aksionerëve të biznesit ose ekuivalentëve të tyre, duke përfshirë këtu:

(i) drejtimin e ndërmarrjes ose të një departamenti apo nën-divizioni të saj;

(ii) mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së nëpunësve tjerë mbikëqyrës, specialistëve apo menaxherëve;

(iii) autoritetin që personalisht të punësoj dhe shkarkoj, ose të rekomandojë rekrutimin, shkarkimin ose veprime të tjera në lidhje me personelin;

- (b) Persona të punësuar në një organizatë, të cilët zotërojnë njohuri të veçanta që janë thelbësore në shërbimet e ndërmarrjes, mjetet kërkimore, teknika ose menaxhim. Vlerësimi i njohurive të tilla mund të pasqyrojë, përveç njohurive specifike të cilat lidhen me ndërmarrjen, një nivel të lartë kualifikimi që i referohet një lloj pune ose tregtie ku nevojiten njohuri teknike të veçanta, përfshirë edhe anëtarësimin në një profesion të akredituar;
 - (c) I "transferuari brenda korporatës" përkufizohet si person fizik i punësuar brenda një organizate në territorin e një Pale, dhe i transferuar përkohësisht në kontekst të vazhdimit të veprimtarive ekonomike në territorin e Palës tjetër; organizata përkatëse duhet të ketë vendin parësor të biznesit të saj në territorin e njëres Palës dhe transferimi të ndodhë në një ndërmarrje (degë, filial) të asaj organizate, duke ndjekur me efikasitet veprimtarinë ekonomike në territorin e Palës tjetër.
3. Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm në territorin e BE-së ose Kosovës, përkatësisht i qytetarëve të Kosovës dhe shtetasve të BE-së, lejohet atëherë kur këta përfaqësues të kompanive janë persona të punësuar në pozicion drejtues, siç është përcaktuar në paragrafin 2 (a), brenda një kompanie, dhe janë përgjegjës për ngritjen e një filiali të BE-së ose dege të një kompanie Kosovare ose të një filiali të Kosovës ose degë të një kompanie të BE-së në Shtetin Anëtar ose në Kosovë gjegjësisht kur:
- (a) këta përfaqësues nuk janë të angazhuar në shitjet e drejtpërdrejta apo në ofrimin e shërbimeve, dhe nuk marrin pagesë nga burimi që gjendet brenda territorit vendës të ndërmarrjes; dhe
 - (b) kompania ka vendin parësor të biznesit të saj përkatësisht jashtë BE-së ose Kosovës, dhe nuk ka përfaqësues, zyrë, degë ose filiale të tjera në atë Shtet Anëtar ose në Kosovë.

NENI 56

Me qëllim që të lehtësohet për shtetasit e BE-së dhe qytetarët e Kosovës që të fillojnë dhe ndjekin veprimtaritë e rregulluara profesionale respektivisht në Kosovë dhe në BE, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, KSA-ja do të shqyrtoj se cilat hapa janë të nevojshëm për njohjen reciproke të kualifikimeve. KSA-ja mund të marrë të gjitha masat e domosdoshme për këtë qëllim.

NENI 57

Pas gjashtë viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, KSA-ja duhet të krijoj modalitete për të zgjeruar dispozitat e këtij kapitulli për shtetasit e BE-së dhe qytetarët e Kosovës me qëllim të hyrjes së përkohshme dhe qëndrimit të përkohshëm të ofruesve të shërbimit të përcaktuar si të vetëpunësuar në territorin e një Pale dhe që kanë lidhur një kontratë mirëbesimi për t'i ofruar shërbime konsumatorit final tek ajo Palë, që kërkon praninë e tyre të përkohshme tek ajo Palë me qëllim të përmbushjes së kontratës për ofrimin e shërbimeve.

NENI 58

1. Në përputhje me paragrafët 2 dhe 3, BE-ja dhe Kosova angazhohen të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të lejuar në mënyrë progresive ofrimin e shërbimeve nga kompanitë e BE-së, nga kompanitë Kosovare ose nga shtetasit e BE-së dhe qytetarët e Kosovës të cilat janë të vendosur në territorin e njërës Pale, për persona tjerë sesa ai për të cilin synohen shërbimet.

2. Në përputhje me procesin e liberalizimit të përmendur në paragrafin 1, Palët lejojnë lëvizjen e përkohshme të personave fizikë të cilët japin shërbime ose janë punësuar nga ofruesi i shërbimeve si personel kyç siç përcaktohet në nenin 55, përfshirë personat fizikë të cilët janë përfaqësues të kompanive të BE-së ose Kosovës apo shtetas i BE-së apo i Kosovës të cilët kërkojnë hyrje të përkohshme për të negociuar shitjen e shërbimeve ose lidhjen e marrëveshjeve për shitjen e shërbimeve për ofruesin e shërbimit, ku këta përfaqësues nuk merren vetë me shitje të drejtpërdrejte për publikun e gjerë ose me ofrim të shërbimeve.

3. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, KSA-ja do të marrë masat e nevojshme për të zbatuar në mënyrë progresive paragrafët 1 dhe 2. Do të merret parasysh progresi i arritur i Kosovës në përafrimin e ligjeve të saj me *acquis* të BE-së.

NENI 59

1. Palët nuk ndërmarrin masa ose veprime të tilla, që i bëjnë kushtet për ofrimin e shërbimeve nga shtetasit ose kompanitë e BE-së dhe qytetarët apo kompanitë Kosovare të cilat kanë vendin e tyre të qëndrimit të përhershëm apo të themelimit në një Palë të ndryshme nga ajo e personit të cilit i drejtohet shërbimi, në mënyrë të konsiderueshme më kufizuese në krahasim me situatën ekzistuese në ditën para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.

2. Nëse njëra prej Palëve është e mendimit se masat e zbatuara nga Pala tjetër pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes shpijnë në një situatë e cila kufizon në mënyrë më të ndjeshme ofrimin e shërbimeve në krahasim me situatën ekzistuese në ditën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Pala e parë mund t'i kërkojë Palës tjetër që të hyjnë në konsultime.

NENI 60

Në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transportit ndërmjet BE-së dhe Kosovës, aplikohen dispozitat e mëposhtme:

- (1) Lidhur me transportin ajror, kushtet për qasjen reciproke të tregut, do të trajtohet nga Marrëveshja Shumëpalëshe për Vendosjen e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian.
- (2) Lidhur me transportin tokësor, kushtet për qasjen reciproke të tregut dhe të komunikacionit transit në transportin rrugor, do të trajtohet nga Traktati themelues i Komunitetit të Transportit.
- (3) Kosova duhet ta përshtatë legjislacionin e saj, duke përfshirë rregullat administrative, teknike dhe rregullat tjera, me ato ekzistuese të BE-së në fushën e transportit ajror dhe tokësor përderisa kjo avancon qëllimet e liberalizimit dhe qasjes së ndërsjellë të Palëve në tregje dhe lehtëson lëvizjen e udhëtarëve dhe mallrave.
- (4) Kosova angazhohet që t'iu përmbahet çdo konvente ndërkombëtare që lidhet me sigurinë rrugore, derisa i kushton vëmendje të veçantë rrjetit gjithëpërfshirës të dakorduar të Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore (SEETO).

(5) Ky Kapitull nuk do të zbatohet për shërbimet e transportit detar.

KAPITULLI III

TRAFIKU TRANSIT

NENI 61

Përkufizimet

Për qëllime të kësaj marrëveshje, do të aplikohen përkufizimet e mëposhtme:

- (1) Trafiku transit i BE-së: transporti, nga një transportues i themeluar në BE, i mallrave në transit përmes territorit të Kosovës në rrugën drejt, ose nga një Shtet Anëtar;
- (2) Trafiku transit i Kosovës: transporti, nga një transportues i themeluar në Kosovë, i mallrave në transit nga Kosova përmes territorit të BE-së me destinacion një vend të tretë, ose të mallrave nga një vend i tretë të destinuar për Kosovën.

NENI 62

Dispozitat e Përgjithshme

1. Ky kapitull do të pushojë së aplikuari pasi që të hyjë në fuqi Traktati i Komunitetit të Transportit.
2. Palët bien dakord për dhënien e qasjes së pakufizuar të trafikut transit të BE-së përmes Kosovës dhe trafikut transit të Kosovës përmes BE-së me efekt nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.
3. Nëse si rezultat i të drejtave të dhëna sipas paragrafit 2 të këtij neni, trafiku transit nga transportuesit e BE-së rritet në një shkallë të tillë që shkakton ose kërcënon të shkaktoj dëme serioze në infrastrukturën rrugore dhe/ose qarkullimin e trafikut në akset rrugore dhe në rrethanat e njëjta lindin problemet në territorin e BE-së në afërsi të kufirit të Kosovës, çështja do të paraqitet në

KSA në përputhje me nenin 128 të kësaj Marrëveshje. Palët mund të propozojnë masa të veçanta të përkohshme jo diskriminuese që janë të nevojshme për të kufizuar ose zbutur dëmin e tillë.

4. Palët duhet të shmangin marrjen e ndonjë veprimi të njëanshëm që mund të shpie në diskriminim ndërmjet transportuesve apo automjeteve nga BE-ja dhe transportuesve apo automjeteve nga Kosova. Palët do të marrin të gjitha hapat e nevojshëm për të lehtësuar transportin rrugor në ose përmes territorit të Palës tjetër.

NENI 63

Thjeshtimi i formaliteteve

1. Palët bien dakord që të lehtësojnë qarkullimin hekurudhor dhe tokësor të mallrave, qoftë bilateral ose në transit.

2. Palët bien dakord që të marrin veprime të përbashkëta, deri në masën e nevojshme dhe të nxisin miratimin e masave të mëtejshme thjeshtëzuese.

KAPITULLI IV

PAGESAT RRJEDHËSE DHE LËVIZJA E KAPITALIT

NENI 64

Palët angazhohen të autorizojnë, në monedha të këmbyeshme lirshëm, çdo pagesë apo transfer në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave ndërmjet BE-së dhe Kosovës në përputhje me Nenin VIII të Neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

NENI 65

1. Në lidhje me transaksionet në llogarinë kapitale dhe atë financiare të bilancit të pagesave, që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, Palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investimet e drejtpërdrejta nga kompanitë e krijuara në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe investimeve të bëra në përputhje me Kapitullin I të Titullit V, si dhe likuidimin ose riatdhesimin e këtyre investimeve dhe të çdo përfitimi që rrjedh prej tyre.
2. Në lidhje me transaksionet në llogarinë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave, që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, Palët sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me transaksionet tregtare ose me sigurimin e shërbimeve duke përfshirë huat financiare dhe kreditë, ku merr pjesë një rezident i njëjës prej Palëve. Ky nen nuk i mbulon investimet e portofolit, veçanërisht blerjen e aksioneve në tregun e kapitaleve me qëllim të vetëm për të bërë investim financiar pa ndonjë qëllim të ndikimit në menaxhmentin dhe kontrollin e ndërmarrjes.
3. Brenda pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, Kosova duhet t'i ofroj trajtim të barabartë me shtetasit e Kosovës për shtetasit e BE-së që blejnë pasuri të patundshme në territorin e saj.
4. Pa cenuar paragrafin 1, Palët nuk do të paraqesin kufizime të reja në lëvizjen e kapitalit dhe pagesave rrjedhëse ndërmjet rezidentëve të BE-së dhe Kosovës dhe nuk do t'i bëjnë marrëveshjet ekzistuese më tepër kufizuese.

5. Pa cenuar këtë nen dhe nenin 64, në rrethana të jashtëzakonshme, kur lëvizjet e kapitalit shkaktojnë, ose kërcënojnë të shkaktojnë vështirësi serioze për funksionimin e politikave të kursit të këmbimit ose politikave monetare në BE apo Kosovë, BE-ja dhe Kosova mund të marrin masa mbrojtëse lidhur me lëvizjet e kapitalit ndërmjet BE-së dhe Kosovës për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj në qoftë se masat e tilla janë të domosdoshme.

6. Palët konsultohen me njëra tjetrën me qëllim të lehtësimit të lëvizjes së kapitalit ndërmjet BE-së dhe Kosovës, në mënyrë që të promovohen objektivat e kësaj Marrëveshje.

NENI 66

1. Gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, Kosova do të marr masa që lejojnë krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e mëtejshëm gradual të rregullave të BE-së mbi lëvizjen e lirë të kapitalit.

2. Deri në fund të vitit të dytë nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, KSA-ja do të përcakton modalitetet për zbatimin e plotë të rregullave të BE-së për lëvizjen e lirë të kapitalit në Kosovë.

KAPITULLI V

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 67

1. Ky Titull do të zbatohet duke iu nënshtuar kufizimeve për arsye të politikave publike, sigurisë publike ose shëndetit publik.

2. Ky Titull nuk do të zbatohen për veprimtari të cilat kanë lidhje, edhe rastësisht, me ushtrimin e autoritetit zyrtar në territorin e secilës prej Palëve.

NENI 68

1. Për qëllimin e këtij Titulli, asgjë në këtë Marrëveshje nuk ndalon Palët të zbatojnë ligjet dhe rregullat e tyre në lidhje me hyrjen dhe qëndrimin, punësimin, kushtet e punës, vendosjes së personave fizikë dhe ofrimit të shërbimeve, sidomos për aq sa i përket dhënies, rinovimit ose refuzimit të lejes së qëndrimit, me kusht që duke vepruar në këtë mënyrë, ata nuk i zbatojnë ato masa në atë mënyrë që të anulojnë ose të dëmtojnë përfitimet e ndonjërës prej Palëve sipas kushteve të një dispozite të veçantë të kësaj Marrëveshje dhe *acquis*-i të BE-së. Kjo dispozitë nuk cenon zbatimin e nenit 67.

2. Ky Titull nuk do të zbatohet për masat që prekin personat fizik që kërkojnë qasje në tregun e punës të cilësdo Palë, dhe as nuk do të zbatohet për masat në lidhje me shtetësinë, vendbanimin apo punësimin e përhershëm.

NENI 69

Kompanitë të cilat kontrollohen dhe janë ekskluzivisht nën pronësi të përbashkët nga kompanitë e BE-së ose shtetasit e BE-së dhe nga kompanitë Kosovare apo qytetarët e Kosovës, janë gjithashtu subjekt i dispozitave të këtij Titulli.

NENI 70

1. Trajtimi i Kombit më të Favorizuar, i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij Titulli nuk do të zbatohet për avantazhe tatimore që Palët i ofrojnë ose do t'i ofrojnë në të ardhmen në bazë të marrëveshjeve që kanë për qëllim shmangien e tatimit të dyfishtë ose rregullime të tjera tatimesh

2. Ky Titull nuk do të interpretohet si masa për të penguar miratimin apo zbatimin nga ana e Palëve të çfarëdo mase që synon parandalimin e shmangies apo evazionit tatimor në bazë të dispozitave tatimore të marrëveshjeve për të shmangur tatimin e dyfishtë dhe rregullimeve tjera tatimore ose legjislacionit të brendshëm fiskal.

3. Ky Titull nuk do të interpretohet si masa për të parandaluar Palët që të zbatojnë dispozitat përkatëse të legjislacioneve të tyre fiskale, për dallimin mes taksapaguesve të cilët nuk gjenden në situata të njëjta, sidomos në lidhje me vendbanimin e tyre.

NENI 71

1. Palët përpiqen kurdo të jetë e mundur, të shmangin vendosjen e masave kufizuese, përfshirë masat e lidhura me importet, për qëllimet e bilancit të pagesave. Pala e cila miraton masa të tilla duhet t'i paraqesë sa më shpejt të jetë e mundur Palës tjetër një afat për tërheqjen e tyre.

2. Në rastin kur një ose më shumë Shtete Anëtare apo Kosova gjenden në vështirësi serioze të bilancit të pagesave, ose përballen me rrezik të pashmangshëm të tij, BE-ja dhe Kosova mund të miratojnë masa kufizuese, në përputhje me kushtet e vendosura nga Marrëveshja e OBT-së, përfshirë masa mbi importet të cilat duhet të jenë për një kohë të kufizuar dhe nuk duhet të tejkalojnë afatin e nevojshëm për të rregulluar situatën e bilancit të pagesave. BE-ja dhe Kosova do të informojnë menjëherë Palën tjetër.

NENI 72

Ky Titull duhet të përshtatet në mënyre progresive, veçanërisht në kuadër të kërkesave që dalin nga neni V i Marrëveshjes së përgjithshme për Tregtinë në Shërbime(GATS).

NENI 73

Kjo Marrëveshje nuk cenon zbatimin nga cilado Palë të masave të nevojshme për të parandaluar shmangien e masave lidhur me qasjen e vendeve të treta në tregun e tyre nëpërmjet kësaj Marrëveshje.

TITULLI VI

PËRAFRIMI I LIGJIT TË KOSOVËS ME *ACQUIS* TË BE-së, ZBATIMI I LIGJIT DHE RREGULLAT E KONKURENCËS

NENI 74

1. Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues të Kosovës me atë të BE-së dhe të zbatimit të tij efektiv. Kosova do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkoj gradualisht drejt përputhjes me *acquis*-in e BE-së. Kosova do të sigurohet se ligjet ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm do të implementohët dhe zbatohet siç duhet.

2. Ky përafrim do të fillon në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementët e *acquis*-it të BE-së të cekura në këtë Marrëveshje deri në fund të periudhës transitore të përcaktuar në nenin 9.

3. Në një fazë të hershme, përafrimi do të përqendrohet në elementet thelbësorë të *acquis*-it të BE në fushën e Tregut të Brendshëm, dhe në fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë, si dhe në fushat e lidhura me tregti. Në fazën e mëtejshme, Kosova duhet të përqendrohet në pjesët e mbetura të *acquis*-it të BE-së.

Përafrimi do të realizohet në bazë të një programi që do të dakordohet ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës.

4. Kosova gjithashtu duhet të përcaktojë, në marrëveshje me Komisionin Evropian, modalitetet për monitorimin e zbatimit të përafrimit të legjislacionit dhe veprimet që duhet ndërmarrë për zbatimin e ligjit, duke përfshirë përpjekjet e Kosovës për të reformuar gjyqësorin e vet për të zbatuar kornizën e saj të përgjithshme ligjore.

Konkurrenca dhe dispozitat tjera ekonomike

1. Dispozitat më poshtë nuk janë në pajtueshmëri me funksionimin përkatës të kësaj Marrëveshje, për aq sa ato mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet BE-së dhe Kosovës:

- (a) të gjitha Marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet e marra nga shoqatat e ndërmarrjeve dhe praktikatat e përbashkëta ndërmjet ndërmarrjeve të cilat kanë si objekt të tyre ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërim e konkurrencës;
- (b) abuzimi me pozicion dominues nga një ose më shumë ndërmarrje, në territoret e BE-së apo të Kosovës si tërësi ose në një pjese të konsiderueshme të tyre;
- (c) çdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara.

2. Çdo praktikë në kundërshtim me këtë nen do të vlerësohet në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të aplikueshme të konkurrencës në BE, veçanërisht nga nenet 101, 102, 106 dhe 107 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe instrumentet interpretuese të miratuara nga institucionet e BE-së.

3. Palët sigurojnë që një autoritetit me funksion të pavarur t'i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (a) dhe (b) të këtij Neni, lidhur me ndërmarrjet private dhe publike dhe ndërmarrjet të cilave u janë dhënë të drejtat e posaçme.

4. Kosova duhet të sigurohet që t'i jepen të gjitha kompetencat një autoriteti me funksion të pavarur për zbatimin e plotë të paragrafit 1(c). Ndër të tjera, ky autoritet duhet të ketë kompetenca të nevojshme për të autorizuar skemat e ndihmës shtetërore dhe grantet e ndihmës individuale në pajtueshmëri me paragrafin 2, si dhe kompetenca për të urdhëruar rikthimin e ndihmës shtetërore e cila është dhënë në mënyrë të paligjshme.

5. BE-ja në njërin anë dhe Kosova në anën tjetër do të sigurojnë transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, ndër të tjera, duke i ofruar Palës tjetër raportin e rregullt vjetor, ose ekuivalentin, duke ndjekur metodologjinë dhe paraqitjen e sondazhit të BE-së për ndihmën

shtetërore. Me kërkesë të njëjës Palë, Pala tjetër do t'i ofroj informacione për çështje të veçanta të ndihmës individuale shtetërore.

6. Kosova do të krijoj një inventar të plotë të skemave të ndihmës të filluara dhe do të përafrojnë skemat e tilla të ndihmës me kriteret e përmendura në paragrafin 2, brenda një periudhe jo më shumë se tre vite nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

7. (a) Me qëllim të zbatimit të paragrafit 1 (c), Palët pranojnë që gjatë pesë viteve të para pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, çdo ndihmë shtetërore e ofruar nga Kosova do të vlerësohet duke marrë parasysh faktin se Kosova do të konsiderohet si një zonë identike me ato zona të BE-së të përshkruara në nenin 107 (3) (a) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

(b) Brenda katër viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, Kosova do t'i paraqesë Komisionit Evropian shifrat e BPV-së së saj për kokë banori të harmonizuar me nivelin NUTS II. Më pas, autoriteti i referuar në paragrafin 4 dhe Komisioni Evropian bashkërisht do të vlerësojnë legjitimitetin e rajoneve të Kosovës, si dhe intensitetet maksimale të ndihmës në lidhje me to, në mënyrë që të hartojnë hartën rajonale të ndihmës në bazë të udhëzimeve përkatëse të BE-së.

8. Në lidhje me produktet e përmendura në Kapitullin II të Titullit IV:

(a) paragrafi 1(c) i këtij neni nuk do të zbatohet;

(b) çfarëdo praktike në kundërshtim me paragrafin 1 (a) të këtij neni do të vlerësohet në përputhje me kriteret e vendosura nga BE-ja në bazë të neneve 42 dhe 43 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe instrumenteve të veçanta të BE-së të miratuara mbi këtë bazë.

9. Nëse njëra prej Palëve vlerëson se një praktike e veçantë nuk përputhet me termat e paragrafit 1, ajo mund të marrë masat e nevojshme pas konsultimeve me KSA-në apo pas 30 ditëve të punës pas kërkesës për konsultim. Ky nen nuk do të cenohet ose ndikohet në ndonjë mënyrë në marrjen, nga BE-ja apo Kosova, të masave kundër-balancuese në përputhje me GATT 1994 dhe Marrëveshjen e OBT-së mbi Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese dhe legjislacionin e brendshëm përkatës për të.

NENI 76

Ndërmarrjet publike

Deri në fund të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, Kosova do të zbatoj, për ndërmarrjet publike dhe për ndërmarrjet të cilave u janë dhënë të drejta të veçanta dhe ekskluzive, parimet e përcaktuara në Traktatin për Funksonimin e Bashkimit Evropian, duke iu referuar veçanërisht nenit 106 të saj.

Të drejtat e veçanta të ndërmarrjeve publike gjatë periudhës transitore nuk duhet të përfshijnë mundësinë e vendosjes së kufizimeve sasiore, ose masave me efekt të njëjtë me to për importet nga BE-ja për në Kosovë.

NENI 77

Aspektet e përgjithshme të pronësisë intelektuale

1. Në bazë të këtij Neni dhe Shtojcës VII, Palët konfirmojnë rëndësinë që i japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si dhe zbatimit të të drejtave të pronës intelektuale, industriale dhe tregtare.
2. Kosova do të marrë masat e nevojshme në mënyrë që të garantojë, jo më vonë se pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, një nivel të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të ngjashme me ato që ekzistojnë në BE, duke përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.
3. Kosova merr përsipër që t'i përmbahet konventave shumëpalëshe mbi të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të referuara në Shtojcën VII. KSA-ja mund të vendosë të detyroj Kosovën që t'i përmbahet Konventave të veçanta shumëpalëshe në këtë fushë.

NENI 78

Aspekte të tregtisë që lidhen me pronën intelektuale

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje, Palët do t'i japin kompanive të njëra-tjetrës, shtetasve të BE-së dhe qytetarëve të Kosovës, sa i përket pranimit dhe mbrojtjes së pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, trajtim jo më pak të favorshëm se atë që ata i japin nga ana e tyre ndonjë vendi të tretë nën Marrëveshjet dypalëshe.
2. Nëse ndodhin probleme në fushën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare që ndikojnë në kushtet e tregtisë, ato do të referohen urgjentisht në KSA, me kërkesë të cilësdo Palë, me qëllim të arritjes së zgjidhjeve reciprokisht të kënaqshme.

NENI 79

Prokurimi Publik

1. BE-ja dhe Kosova konsiderojnë hapjen e dhënies së kontratave publike mbi bazën e mos-diskriminimit dhe reciprocitetit, duke ndjekur veçanërisht rregullat e OBT-së, për të qenë një objektiv i dëshirueshëm.
2. Nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, kompanitë e Kosovës, pavarësisht se a janë themeluar në BE apo jo, duhet t'u ofrohet qasje në procedurat e fitimit të kontratës në BE në pajtim me rregullat e prokurimit të BE-së sipas trajtimit jo më pak të favorshëm se sa atë që i ofrohet kompanive të BE-së.

Dispozitat e mësipërme zbatohen gjithashtu në kontratat në sektorin e shërbimeve publike, posa Kosova ta ketë miratuar legjislacionin duke vendosur rregullat e BE-së në këtë fushë. BE-ja do të shqyrtoj periodikisht nëse Kosova vërtetë ka miratuar legjislacionin e tillë.

3. Nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, kompanitë e BE-së të themeluara në Kosovë nën Kapitullin I të Titullit V do t'u jepet qasje në procedurat e fitimit të kontratës në Kosovë nën trajtim jo më pak të favorshëm se sa ai që i'u dhënë kompanive të Kosovës.

4. Nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, kompanitë e BE-së jo të themeluara në Kosovë nën Kapitullin I të Titullit V do t'u jepet qasje në procedurat e fitimit të kontratës në Kosovë nën trajtim jo më pak të favorshëm se sa ai që i'u është dhënë kompanive të Kosovës dhe kompanive të BE-së të themeluara në Kosovë me përjashtim të preferencave të çmimit të përshkruar në paragrafin 5.

5. Nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, Kosova do të ndryshoj çfarëdo preference ekzistuese për kompanitë Kosovare apo kompanitë e BE-së të themeluara në Kosovë dhe për kontratat e dhëna nën kriteret e tenderit më të favorshëm ekonomikisht dhe çmimit më të ulët, me një preferencë të çmimeve dhe gradualisht duhet të eliminoj këtë të fundit, brenda një periudhe pesë vjeçare në përputhje me kalendarin e mëposhtëm:

- preferencat nuk duhet të tejkalojnë 15% deri në fund të vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje;
- preferencat nuk duhet të tejkalojnë 10% deri në fund të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje;
- preferencat nuk duhet të tejkalojnë 5% deri në fund të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje; dhe;
- preferencat do të hiqen krejtësisht jo më vonë se deri në fund të vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.

6. Brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, KSA-ja mund të shqyrtojë preferencat e përcaktuara në paragrafin 5 dhe të vendos për shkurtimin e afateve të përcaktuara në paragrafin 5.

7. Brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, Kosova do të nxjerrë legjislacionin për zbatimin e standardeve procedurale të parashikuara nga *acquis* të BE-së.

8. Kosova do t'i raportoj KSA-së në baza vjetore mbi masat që ka ndërmarrë për të rritur transparencën dhe për të siguruar për shqyrtimin efektiv gjyqësor të vendimeve të marra në fushën e prokurimit publik.

9. Sa i përket themelimit, veprimtarisë, ofrimit të shërbimeve ndërmjet BE-së dhe Kosovës do të zbatohen nenet nga 50 deri 66. Sa i përket punësimit dhe lëvizjes së punëtorëve lidhur me përmbushjen e kontratave publike, *acquis* i BE-së i në lidhje me shtetasit e vendeve të treta do të zbatohet për sa i përket qytetarëve të Kosovës në BE. Në lidhje me shtetasit e BE-së në Kosovë, Kosova do t'i jap të drejta reciproke punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar ngjashëm me ato të qytetarëve të Kosovës në BE sa i përket punësimit dhe lëvizjes së punëtorëve lidhur me përmbushjen e kontratave publike.

NENI 80

Standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i konformitetit

1. Kosova do të marrë masat e nevojshme në mënyrë që gradualisht të arrijë përputhshmërinë me legjislacionin horizontal dhe sektorial të BE-së për sigurinë e produktit dhe të sjellë infrastrukturën e cilësisë, siç janë procedurat Evropiane të standardizimit, metrologjisë, akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit.
2. Për këtë qëllim, Palët do të kërkojnë që të:
 - (a) promovimin e përdorimit të rregulloreve teknike të BE-së, standardeve Evropiane dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit;
 - (b) të ofrojë ndihmë për nxitjen e zhvillimit të infrastrukturës së cilësisë: standardizimit, metrologjisë, akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit;
 - (c) promovojë bashkëpunimin e Kosovës me organizatat që kanë të bëjnë me standardet, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë, akreditimin dhe funksioneve të ngjashme (p.sh. CEN, CENELEC, ETSI, EA, WELMEC, EUROMET)¹ nëse rrethanat objektive e mundësojnë këtë;

¹Komiteti Evropian për Standardizim, Komiteti Evropian për Standardizim Elektroteknik, Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit, Bashkëpunimi Evropian për Akreditim, Bashkëpunimi Evropian për Metrologji Ligjore, Shoqata Evropiane e Instituteve Kombëtare të Metrologjisë.

- (d) sipas nevojës, të arrihen Marrëveshje për Vlerësimin e Konformitetit dhe Pranimin e Produkteve Industriale posa korniza legjislative dhe procedurat e Kosovës janë të përafuara mjaftueshëm me ato të BE-së dhe kur ekspertiza përkatëse është në dispozicion.

NENI 81

Mbrojtja e konsumatorit

Palët do të bashkëpunojnë me synim të përafrimit të legjislacionit të Kosovës për mbrojtjen e konsumatorit me atë të *acquis*-it të BE-së me qëllim që të sigurohet:

- (a) një politikë për mbrojtjen aktive të konsumatorëve, në përputhje me të drejtën e BE-së, duke përfshirë rritjen e informimit dhe zhvillimit të organizatave të pavarura në Kosovë;
- (b) harmonizimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorit në Kosovë me atë ekzistues në BE;
- (c) mbrojtjesefikase ligjore për konsumatorët në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mallrave të konsumit dhe ruajtjen e standardeve të duhura të sigurisë;
- (d) monitorimin e rregullave nga autoritetet kompetente dhe sigurimi i qasjes së kompenzimit përkatës ligjor në rastet e mosmarrëveshjeve;
- (e) shkëmbimi i informatave mbi produktet e rrezikshme.

NENI 82

Kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta

Kosova do të harmonizojë në mënyrë progresive legjislacionin e saj me atë të BE-së në fushat e kushteve të punës, sidomos të shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe mundësive të barabarta.

TITULLI VII

LIRIA, SIGURIA DHE DREJTËSIA

NENI 83

Fuqizimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit

Sa i përket bashkëpunimit të tyre në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, Palët do t'i kushtojnë rëndësi të veçantë konsolidimit të sundimit të ligjit, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi dhe administrimit të zbatimit të ligjit dhe administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi synon veçanërisht fuqizimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit në Kosovë dhe përmirësimit të efikasitetit të tij, zhvillimin e strukturave të përshtatshme për policinë, prokurorët dhe gjyqtarët dhe organet tjera gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit për t'i përgatitur ata në mënyrë adekuate për bashkëpunim në çështjet civile, tregtare dhe penale, dhe për t'ju mundësuar atyre që në mënyrë efektive të parandalojnë, hetojnë, ndjekin penalisht dhe gjykojnë krimin e organizuar, korrupsionin dhe terrorizmin.

NENI 84

Mbrojtja e të dhënave personale

Palët do të bashkëpunojnë për legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale me synim të arritjes së nivelit të mbrojtjes së të dhënave personale nga Kosova që korrespondon me atë të *acquis*-it të BE-së. Kosova do të sigurojë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për një ose më shumë organe të pavarura mbikëqyrëse për të monitoruar dhe garantuar në mënyrë efektive zbatimin e legjislacionit të saj për mbrojtjen e të dhënave personale.

Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e vizave, kontrollit të kufijve, azilit dhe migracionit dhe do të vendosin një kornizë të bashkëpunimit në këto fusha, përfshirë ato në nivel rajonal, duke marrë parasysh dhe duke përdorur plotësisht nismat e tjera ekzistuese në këtë fushë ashtu siç mund të jetë e përshtatshme.

Bashkëpunimi në çështjet e përmendura në paragrafin e parë bazohet në konsultimet e ndërsjella dhe bashkërendimit të ngushtë ndërmjet Palëve dhe mund të përfshijë asistencë teknike dhe administrative për:

- (a) shkëmbimin e statistikave dhe informatave mbi legjislacionin dhe praktikat;
- (b) hartimin e legjislacionit;
- (c) rritjen e efikasitetit së institucioneve;
- (d) trajnimin e personelit;
- (e) sigurinë e dokumenteve të udhëtimit dhe zbulimin e dokumenteve false;
- (f) menaxhimin e kontrollit të kufijve.

Bashkëpunimi përqendrohet veçanërisht:

- (a) në fushën e azilit, në miratimin dhe zbatimin e legjislacionit nga ana e Kosovës për përmbushjen e standardeve të Konventës lidhur me Statusin e Refugjatëve, të hartuar në Gjenevë më 28 korrik 1951, dhe Protokollin në lidhje me statusin e refugjatëve, të hartuar në Nju Jork më 31 janar të vitit 1967, për të siguruar në këtë mënyrë që parimi i "mos-kthimit" të respektohet si dhe të drejtat tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve;

- (b) në fushën e migracionit të ligjshëm, për rregullat e pranimit si dhe të drejtat dhe statusin e personave të pranuar. Lidhur me migracionin, Palët bien dakord për trajtimin e drejtë e shetasve jo të BE-së të cilët janë rezident të ligjshëm në territorin e një Shteti Anëtar ose Kosovës, si dhe për hulumtimin e mundësive për të vendosur masa për të siguruar nxitje dhe përkrahje për veprimet e Kosovës me synim të promovimit të integritit të shtetasve jo të BE-së që banojnë ligjërisht në Kosovë.

NENI 86

Migracioni i ligjshëm

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim të mbështetjes së Kosovës në përafrimin e legjislacionit të saj me *acquis* të BE-së për migracionin e ligjshëm.

Palët pranojnë se qytetarët e Kosovës gëzojnë të drejtat sipas *acquis* të BE-së, sidomos në fushën e kushteve të punës, kompensimit dhe shkarkimit, bashkimit familjar, vendbanimit afatgjatë, studentët, hulumtuesit dhe punonjësit me kualifikime të larta, punëtorët sezonal, të transferuarit brenda korporatave dhe pensionistët. Palët gjithashtu e pranojnë se kjo është pa i cenuar kushtet dhe modalitetet e zbatueshme në çdo Shtet Anëtar.

Brenda periudhës katër vjeçare pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, Kosova do t'i jap të drejta reciproke shtetasve të BE-së në fushat e përmendura në paragrafin e dytë. KSA-ja do të shqyrtojë masat e nevojshme që duhet marrë për këtë qëllim. KSA-ja mund të shqyrtoj çfarëdo çështje tjetër që lidhet me zbatimin e këtij neni.

NENI 87

Parandalimi dhe kontrolli i imigrimit të paligjshëm

KSA-ja do të bëjë përpjekje të përbashkëta të cilat mund të bëhen nga Palët për të parandaluar dhe kontrolluar imigracionin e paligjshëm, përfshirë trafikimin dhe kontrabandën e qenieve njerëzore, duke siguruar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të migrantëve dhe ndihmën e migrantëve në fatkeqësi.

NENI 88

Ri-pranimi

Me qëllim të bashkëpunimit në mënyrë që të parandalohet dhe të kontrollohet migrimi i paligjshëm, Palët sipas kërkesës dhe pa formalitete të mëtejshme duhet të:

- (a) ri-pranojnë cilindo qytetarë të Kosovës apo shtetas të BE-së të pranishëm në mënyrë të paligjshme në Palën tjetër gjegjëse;
- (b) të ri-pranojnë shtetasit jo të BE-së dhe personat pa shtetësi që kanë hyrë në territorin e Shtetit Anëtar nëpërmjet Kosovës apo në Kosovë nëpërmjet territorit të Shtetit Anëtar.

Kosova do t'i siguroj qytetarëve të saj dokumente të përshtatshme identifikimi dhe do t'u ofroj atyre lehtësime administrative për qëllime të tilla.

Palët bien dakord t'i shqyrtojnë mundësitë për të filluar negociatat me qëllim të nënshkrimit të një marrëveshje që rregullon procedurat specifike për ri-pranimin e personave të përmendur në pikat (a) dhe (b) të paragrafit të parë.

Kosova do të hulumtoj mundësitë që të lidh marrëveshje të ri-pranimit me vendet pjesëmarrëse në PSA, nëse e lejojnë rrethanat objektive, dhe merr përsipër të marrë masat e nevojshme për të siguruar zbatim fleksibil dhe të shpejtë të atyre marrëveshjeve. BE-ja do të shqyrtojë mundësitë të ndihmojë vendet përkatëse gjatë gjithë këtij procesi, nëse rrethanat objektive lejojnë.

NENI 89

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit

Palët do të bashkëpunojnë në parandalimin e përdorimit të sistemeve të tyre financiare për pastrimin e të ardhurave nga veprimtaritë kriminale në përgjithësi dhe veprat penale të drogës në veçanti, si dhe për qëllime të financimit të terrorizmit.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të përfshijë asistencën teknike dhe administrative ndaj Kosovës me qëllim të zhvillimit të zbatimit të rregulloreve dhe funksionimit efikas të standardeve dhe mekanizmave të përshtatshëm për ta luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit ekuivalente me ato të miratuara nga BE-ja dhe forumet tjera ndërkombëtare në këtë fushë, në veçanti Task Forca e Veprimit Financiar (FATF).

NENI 90

Bashkëpunimi kundër drogave të paligjshme

Palët do të bashkëpunojnë për të siguruar një qasje të balancuar dhe të integruar sa i përket çështjeve të drogës. Politikat dhe veprimet e drogës duhet të kenë për qëllim forcimin e strukturave të Kosovës për luftimin e drogave të paligjshme dhe të prekursorëve të tyre, reduktimin e furnizimit, trafikimit brenda dhe kërkesës për drogat e paligjshme, duke u përballur me pasojat shëndetësore dhe sociale nga keqpërdorimi me drogë, si dhe me një kontroll më efektiv të prekursorëve.

Palët do të bien dakord mbi metodat e nevojshme të bashkëpunimit për arritjen e këtyre objektivave. Veprimet duhet të bazohen në parime e përbashkëta të dakorduara përgjatë vijave të Strategjisë kundër Drogës 2013-2020 të BE-së dhe çdo dokumenti të tij vijues.

NENI 91

Parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera të paligjshme

Palët bashkëpunojnë me qëllim të përforcimit të strukturave të Kosovës në luftimin dhe parandalimin e veprimtarive kriminale, në veçanti të krimit të organizuar, korrupsionit dhe formave të tjera të krimit të rëndë në një shtrirje ndërkufitare. Kosova do t'i përmbahet konventave dhe instrumenteve përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë. Do të promovohet bashkëpunimi rajonal në luftën kundër krimit të organizuar.

Sa i përket falsifikimit të valutës në Kosovë, Kosova do të bashkëpunojë ngushtë me BE-në për të luftuar falsifikimin e kartëmonedhave dhe monedhave si dhe për të ndaluar dhe ndëshkuar çdo falsifikim të tyre. Në nivelin e parandalimit, Kosova duhet të synojë zbatimin e masave të cilat janë ekuivalente me ato të përcaktuara në legjislacionin përkatës të BE-së, dhe t'ju përmbahet konventave dhe instrumenteve përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë. Kosova mund të përfitojë nga mbështetja e BE-së për këmbim, ndihmë dhe trajnim në mbrojtjen kundër falsifikimit të valutave.

NENI 92

Lufta kundër terrorizmit

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim të përforcimit të strukturave të Kosovës në parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste dhe financimit të tyre, veçanërisht ato me shtrirje ndërkufitare. Bashkëpunimi në këtë kontekst do të jetë në përputhje me sundimin e ligjit, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ligjin ndërkombëtar mbi refugjatët dhe ligjin ndërkombëtar humanitar. Kosova do t'ju përmbahet konventave dhe instrumenteve përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë.

TITULLI VIII

POLITIKAT E BASHKËPUNIMIT

NENI 93

BE-ja dhe Kosova do të vendosin një bashkëpunim të ngushtë për të kontribuar në potencialin e zhvillimit dhe rritjes në Kosovës. Bashkëpunimi i tillë do të forcojë lidhjet ekonomike ekzistuese në një bazë sa më të gjerë për përfitimin e të dyja Palëve.

Politikat dhe masat tjera do të hartohen për të sjellë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social në Kosovë. Këto politika duhet të sigurojnë që çështjet e mjedisit dhe klimës të jenë të përfshira që nga fillimi dhe të lidhura me kërkesat për zhvillimin e harmonizuar social.

Politikat e bashkëpunimit do të integrohen në një kornizë rajonale të bashkëpunimit. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet masave që mund të nxisin bashkëpunim ndërmjet Kosovës dhe vendeve fqinje të saj, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal. KSA-ja do të përcaktojë përparësitë ndërmjet dhe brenda politikave të bashkëpunimit të përshkruara në këtë Titull.

NENI 94

Politikat ekonomike dhe tregtare

BE-ja dhe Kosova do të lehtësojnë procesin e reformave ekonomike nëpërmjet bashkëpunimit për të përmirësuar të kuptuarit e bazave të ekonomive të tyre përkatëse si dhe formulimin dhe zbatimin e politikave ekonomike në ekonomitë e tregut.

Për këto qëllime, BE-ja dhe Kosova do të bashkëpunojnë për:

- (a) shkëmbimin e informatave mbi performancën dhe perspektivat makroekonomike dhe për strategjitë për zhvillim;
- (b) analizimin e përbashkët të çështjeve ekonomike me interes të përbashkët, duke përfshirë mbështetjen e politikës ekonomike dhe zbatimin e saj; dhe
- (c) promovimin e bashkëpunimit më të gjerë me qëllim të përshpejtimin të fluksit të ekspertizës dhe qasjes në teknologjitë e reja.

Kosova do të përpiqet të krijoj një ekonomi funksionale të tregut dhe gradualisht të përafroj politikat e saj me politikat e orientuara drejt stabilitetit të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Me kërkesë të autoriteteve të Kosovës, BE-ja mund të ofroj asistencë të dizajnuar për përkrahjen e përpjekjeve të Kosovës në këtë drejtim.

Bashkëpunimi gjithashtu do të synojë forcimin e sundimit të ligjit në fushën e biznesit nëpërmjet një kornize ligjore jo diskriminuese të ndërlidhur me tregtinë.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të përfshin shkëmbimin e informatave në lidhje me parimet dhe funksionimin e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

NENI 95

Bashkëpunimi statistikor

Bashkëpunimi midis Palëve përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e statistikave. Ai synon veçanërisht zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm në Kosovë të aftë për të siguruar të dhëna të besueshme, objektive dhe të sakta, të krahasueshme me statistikat Evropiane, që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformës në Kosovë. Ky sistem duhet gjithashtu t'i mundësojë Agjencisë së Statistikave të Kosovës të përmbush më mirë nevojat e klientëve të saj (si të administratës publike ashtu edhe të sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të jetë në përputhje me parimet e Kodit Statistikor Evropian të Praktikës dhe parimeve themelore të statistikave nga OKB, citatet e drejtës Statistikore Evropiane, dhe duhet të zhvillohet në drejtim zbatimit të *acquis*-it të BE-së në fushën e statistikave. Palët do të bashkëpunojnë veçanërisht për të siguruar konfidencialitetin e të dhënave individuale, që në mënyrë progresive të rrisin grumbullimin e të dhënave dhe transmetimin e tyre në Sistemin Statistikor Evropian, si për të shkëmbyer informatat mbi metodat, transferimin e ekspertizës dhe trajnimet.

NENI 96

Veprimtaritë bankare, sigurimet dhe shërbimet tjera financiare

Bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe Kosovës do të përqendrohet në fusha prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushat e veprimeve bankare, sigurimeve dhe shërbimeve financiare. Palët bashkëpunojnë me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të një kornize të përshtatshme për nxitjen e sektorëve të shërbimeve bankare, sigurimeve, dhe atyre financiare në Kosovë bazuar në praktikën e konkurrencës së drejtë dhe sigurimin e nivelit të nevojshëm të fushës.

NENI 97

Kontrolli i brendshëm financiar publik dhe auditimi i jashtëm

Bashkëpunimi mes Palëve përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e kontrollit të brendshëm financiar publik. Në veçanti Palët do të bashkëpunojnë me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të zbatimit të kontrollit efikas të brendshëm dhe sistemit funksionalisht të pavarur të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë, në përputhje me kornizën e pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikatat e mira të BE-së.

Në mënyrë që të jetë në gjendje të përmbush koordinimin dhe harmonizimin e përgjegjësive që rrjedhin nga kërkesat e mësipërme, bashkëpunimi duhet gjithashtu të përqendrohet në krijimin dhe forcimin e njësive qendrore harmonizuese për menaxhimin financiar dhe kontroll.

Në fushën e Auditimit të Jashtëm, Palët do të bashkëpunojnë veçanërisht me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të auditimit të jashtëm të pavarur funksional në Kosovë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare dhe praktikatat e mira të BE-së. Bashkëpunimi gjithashtu do të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

NENI 98

Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

Bashkëpunimi mes Palëve në fushën e nxitjes dhe mbrojtjes së investimeve përqendrohet në mbrojtjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja dhe synon krijimin e një klime të favorshme për investimet private vendase dhe të huaja që është thelbësore për rimëkëmbjen ekonomike dhe industriale të Kosovës. Qëllimet e veçanta të bashkëpunimit do të jenë që Kosova të përmirësoj kornizën ligjore për të favorizuar dhe mbrojtur investimet.

NENI 99

Bashkëpunimi Industrial

Bashkëpunimi ka si synim të nxisë modernizimin dhe ristrukturimin e industrisë dhe sektorëve të veçantë në Kosovë. Gjithashtu, bashkëpunimi duhet të synoj të siguroj që ekzistojnë kushtet e nevojshme për konkurrueshmërinë e industrisë Kosovare sipas kushteve të cilat sigurojnë se mjedisi është i mbrojtur.

Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë aspektet rajonale të zhvillimit industrial, duke nxitur partneritetet ndërkufitare kur është relevante. Veçanërisht, iniciativat mund të synojnë të krijojnë një kornizë të përshtatshme për ndërmarrjet, përmirësimin e menaxhmentit dhe ekspertizës dhe për të nxitur tregjet, transparencën e tregut dhe mjedisin e biznesit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet krijimit të aktiviteteve efikase të promovimit të eksportit në Kosovë.

Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë të duhur *acquis* e BE-së në fushën e politikave industriale.

NENI 100

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Bashkëpunimi mes Palëve do të synojë zhvillimin dhe forcimin Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në sektorin privat, duke inkurajuar një mjedis të favorshëm për nismën dhe zhvillimin e ndërmarrjeve, veçanërisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe inkurajimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve. Bashkëpunimi duhet të jetë në përputhje me parimet e Aktit të Biznesit të Vogël dhe të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e NVM-ve.

Turizmi

Bashkëpunimi mes Palëve në fushën e turizmit synon të:

- (a) siguroj një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm të turizmit dhe çështjeve të ndërlidhura;
- (b) forcimin e qarkullimit të informacionit mbi turizmin (përmes rrjeteve ndërkombëtare, bazave të të dhënave, etj.);
- (c) nxitjen e zhvillimit të infrastrukturës së favorshme për investime në sektorin e turizmit.

Bashkëpunimi gjithashtu do të synojë studimin e mundësive për operacione të përbashkëta dhe forcimin e bashkëpunimit në mes të ndërmarrjeve turistike, ekspertëve, institucioneve dhe agjencie të tyre kompetente në fushën e turizmit, si dhe transferimin e ekspertizës (nëpërmjet trajnimeve, shkëmbimeve, seminareve).

Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë pjesën e duhur nga *acquis* i BE-së në fushën e turizmit.

Bashkëpunimi mund të integrohet në një kornizë rajonale të bashkëpunimit.

NENI 102

Bujqësia dhe sektori agro-industrial

Bashkëpunimi mes Palëve do të zhvillohet në të gjitha fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së në fushën e bujqësisë, si dhe në skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore, sigurinë ushqimore, veterinare dhe fushat fitosanitare. Bashkëpunimi do të ketë si synim veçanërisht modernizimin dhe ristrukturimin e sektorit të bujqësisë dhe sektorit agro-industrial në Kosovë, posaçërisht që të arrij kërkesat sanitare të BE-së, të përmirësojë menaxhimin e ujit dhe zhvillimin rural si dhe të zhvillojë aspektet e lidhura me sektorin e pylltarisë në Kosovë dhe të mbështesë përafrimin gradual të legjislacionit dhe praktikave të Kosovës me *acquis* të BE-së.

NENI 103

Peshkataria

Palët do të shqyrtojnë mundësinë e identifikimit të fushave me përfitim të ndërsjellë dhe interes të përbashkët në akuakulturë dhe në sektorët e peshkatarisë. Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në këto fusha, dhe parimet e menaxhimit dhe ruajtjen e burimeve të peshkatarisë bazuar në rregullat e zhvilluara nga organizatat relevante ndërkombëtare dhe rajonale të peshkatarisë.

NENI 104

Dogana

Palët do të vendosin një bashkëpunim në këtë fushë me synim garantimin e përputhjes me dispozitat që do të miratohen në fushën e tregtisë, dhe për të arritur përafrimin e sistemit doganor të Kosovës me atë të BE-së, duke ndihmuar kështu në hapjen e rrugës për marrjen e masave liberalizuese të planifikuara në këtë Marrëveshje dhe për përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës për doganat me atë të *acquis* të BE-së.

Bashkëpunimi do të marrë parasysh në mënyrën e duhur fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e doganës.

Protokolli IV vendos rregullat e asistencës të ndërsjellë administrative mes Palëve në fushën e doganës.

NENI 105

Tatimet

BE-ja do të bashkëpunojë me Kosovën me synimin që të ndihmoj zhvillimin e saj në fushën e tatimeve përfshirë edhe masat që synojnë reformimin e mëtejshëm të sistemit fiskal të Kosovës dhe ristrukturimin e administratës tatimore me qëllim të sigurimit të efektivitetit të vjeljes së tatimeve dhe luftën kundër mashtrimit fiskal.

Bashkëpunimi do të marrë parasysh fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e tatimeve dhe luftës kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Bashkëpunimi do të merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e tatimeve dhe në luftën kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Kosova me rastin e përgatitjes së legjislacionit të saj për eliminimin e konkurrencës së dëmshme të tatimeve, duhet të marr parasysh parimet e Kodit të Mirësjelljes për tatimin e biznesit të miratuar nga Këshilli dhe Përfaqësuesit e Qeverive të Shteteve

Anëtare, takim në kuadër të Këshillit më 1 dhjetor 1997¹.

Bashkëpunimi do të synojë promovimin e parimeve të qeverisjes së mirë në çështjet tatimore, transparencën, shkëmbimin e informatave dhe konkurrencës së ndershme të tatimeve në Kosovë, me qëllim të lehtësoj zbatimin e masave të parandalimit të mashtrimit tatimor, evazionit apo shmangies.

¹ Konkluzionet e takimit të Këshillit ECOFIN më 1 dhjetor 1997 në lidhje me politikën tatimore (OJ i BE-C 2, 6.1.1998, f. 1).

Bashkëpunimi social

Palët do të bashkëpunojnë për lehtësimin e reformave të politikave të punësimit në Kosovë, në kontekstin e forcimit të reformave ekonomike dhe të integritit dhe me qëllim të mbështetjes të rritjes përfshirëse. Bashkëpunimi do të synon nxitjen e dialogut social si dhe përafrimin gradual ligjor të legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së për punën, shëndetin, sigurinë në punë dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, për personat me aftësi të kufizuara dhe për personat që i përkasin grupeve minoritare dhe grupeve të tjera të cënueshme, duke ju referuar nivelit ekzistues të mbrojtjes në BE. Kjo mund të përfshijë përafrimin e Kosovës me *acquis* të BE-së në fushën e ligjit të punës dhe në lidhje me kushtet e punës për gratë. Bashkëpunimi gjithashtu do të nxisë miratimin e inkuadrimin gjithëpërfshirës social dhe politikave kundër-diskriminimit në Kosovë. Bashkëpunimi gjithashtu do të përfshijë krijimin e një sistemi të mbrojtjes sociale në Kosovë të aftë për të mbështetur punësimin dhe rritjen ekonomike përfshirëse.

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim që të sigurojnë përafrimin e legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së, dhe me qëllim të përmirësimit të shëndetit dhe të parandalimit të sëmundjeve në popullsi, krijimit të strukturat administrative të pavarura dhe efektive, kompetencat e zbatimit për të siguruar kërkesat thelbësore për kujdesin shëndetësor dhe sigurinë, për të mbrojtur të drejtat e pacientëve, për të mbrojtur qytetarët nga kërcënimet shëndetësore dhe sëmundjet si dhe për të promovuar jetesë të shëndetshme.

Kosova do të veproj në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe instrumentet tjera në këto fusha. Bashkëpunimi merr parasysh fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në këto fusha.

NENI 107

Arsimi dhe trajnimi

Palët bashkëpunojnë me synim ngritjen e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe aftësimin profesional, ashtu si edhe të politikave për rininë dhe punës me rininë, si mënyrë për të nxitur zhvillimin e aftësive, punësimin, përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Një nga përparësitë për sistemin e arsimit të lartë është arritja e standardeve adekuate të cilësisë të institucioneve dhe programeve të saj në përputhje me objektivat e Procesit dhe Deklaratës së Bolonjës.

Palët bashkëpunojnë gjithashtu për të garantuar që qasja në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Kosovë të mos i nënshtrohet diskriminimit në bazë të gjinisë, origjinës racore apo etnike, fesë apo besimit, aftësisë së kufizuar, moshës apo orientimit seksual. Bashkëpunimi do synoj trajtimin e nevojave të studentëve me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Bashkëpunimi do të synojë gjithashtu zhvillimin e kapaciteteve për hulumtim dhe inovacion, sidomos përmes projekteve të përbashkëta të kërkimit dhe inovacionit që përfshijnë të gjitha palët e interesit dhe duke siguruar transferimin e ekspertizës.

Programet dhe instrumentet përkatëse të BE-së do të kontribuojnë në përmirësimin e strukturave dhe veprimtarive arsimore, trajnimeve, kërkimit dhe inovacionit në Kosovë.

Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në këtë fushë.

NENI 108

Bashkëpunimi kulturor

Palët marrin përsipër të nxisin bashkëpunimin kulturor. Ky bashkëpunim do të shërben për të fuqizuar kapacitetin e politikës kulturore, forcimin e kapacitetit të operatorëve kulturor dhe përmirësimin e mirëkuptimit të ndërsjellët midis individëve, minoriteteve dhe popujve. Bashkëpunimi gjithashtu do të mbështet reformat institucionale për të nxitur shumëllojshmërinë

kulturore, veçanërisht në bazë të parimeve në kuadrin e Konventës së UNESCO-s për mbrojtjen dhe nxitjen e larmisë të shprehjeve kulturore, të miratuar në Paris me 20 tetor 2005.

NENI 109

Bashkëpunimi në fushën audio-vizuale

Palët do të bashkëpunojnë për nxitjen e industrisë audio-vizuale në Evropë, dhe për të përkrahur bashkëprodhimin në fushat e kinemasë dhe mediave audio-vizuale.

Bashkëpunimi mund të përfshijë, *ndër të tjera*, programet dhe lehtësirat për trajnimin e gazetarëve dhe profesionistëve në industrinë e mediave audio-vizuale, ashtu si edhe asistencën teknike për mediat publike dhe private të Kosovës, me qëllim të përforcimit të pavarësisë së tyre, profesionalizmin dhe lidhjeve me median evropiane.

Kosova do t'i përafrojë politikat e saj mbi rregullimin e aspekteve të përmbajtjes së transmetimeve ndërkufitare me ato të BE-së dhe do të harmonizojë legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së. Kosova do t'i kushtojë kujdes të veçantë përvetësimit të së drejtës së pronësisë intelektuale për programet dhe transmetimin si dhe për të siguruar dhe fuqizuar pavarësinë e autoriteteve rregullatore përkatëse.

NENI 110

Shoqëria e informacionit

Bashkëpunimi do të zhvillohet në të gjitha fushat që lidhen me *acquis* e BE-së për shoqërinë e informacionit. Ai do të mbështesë kryesisht përafrimin gradual të politikave dhe legjislacionit të Kosovës në këtë sektor me ato të BE-së.

Palët gjithashtu do të bashkëpunojnë për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë së informacionit në Kosovë. Objektivat globale do të jenë në përgatitjen e shoqërisë në tërësi për epokën digjitale, si dhe identifikimin e masave për të siguruar interoperabilitetin e rrjeteve dhe shërbimeve.

NENI 111

Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik

Bashkëpunimi do të përqendrohet së pari në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në këtë fushë.

Palët do të forcojnë, në veçanti bashkëpunimin në fushat e rrjeteve të komunikimit elektronik dhe shërbimeve të komunikimit elektronik, me objektivin përfundimtar të miratimit nga Kosova të *acquis* të BE-së në sektor pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë sigurimit dhe forcimit të pavarësisë së autoriteteve rregullatore relevante.

NENI 112

Informacioni dhe komunikimi

Palët do të marrin masat e nevojshme për nxitjen e shkëmbimit të ndërsjellë të informacionit. Përparësi do u jepet programeve që synojnë dhënien informacionit bazë publikut të gjerë për BE-në dhe rrethet profesionale në Kosovë me informata më të specializuara.

Transporti

Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e transportit.

Bashkëpunimi mund të synojë veçanërisht ristrukturimin dhe modernizimin e sistemit të transportit, përmirësimin e infrastrukturës (përfshirë lidhjet rajonale siç është identifikuar nga Observatori i Transportit të Evropës Juglindore), përmirësimin e lëvizjes së lirë të pasagjerëve dhe mallrave, përmbushjen e standardeve ndërvepruese të krahasueshme me standardet dominuese të BE-së si dhe përshtatjen e legjislacionit të transportit me atë të BE-së, nëse rrethanat objektive mundësojnë një gjë të tillë.

Bashkëpunimi do të synojë të kontribuojë në një qasje progresive të ndërsjellë në tregjet e transportit të BE-së dhe të Kosovës dhe në lehtësimet siç parashikohet me këtë Marrëveshje, duke zhvilluar në Kosovë një sistem të transportit kompatibil, ndërveprues dhe në përputhje me sistemin e BE-së, si dhe përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit në fushën e transportit.

Energjia

Në përputhje me *acquis* përkatës të BE-së, Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre në fushën e energjisë në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut dhe të Traktatit themelues të Komunitetit të Energjisë, i nënshkruar në Athinë më 25 tetor të vitit 2005¹. Bashkëpunimi do të zhvillohet me synim të integritimit gradual të Kosovës në tregjet Evropiane të energjisë.

Bashkëpunimi mund të përfshijë ndihmën për Kosovën në veçanti sa i përket:

- (a) përmirësimit dhe shumëllojshmërisë së furnizimit dhe përmirësimit të qasjes në tregun e energjisë, në përputhje me *acquis* të BE-së mbi sigurinë e furnizimit dhe të strategjisë rajonale të energjisë të Komunitetit të Energjisë, si dhe aplikimin e rregullave të BE-së dhe Evropiane në transit, transmetim, shpërndarje dhe restaurim i ndërlydhjeve energjetike me rëndësi rajonale me fqinjët e saj;
- (b) ndihmës për Kosovën që të zbatojë *acquis* të BE-së për eficiencën e energjisë, burimeve të ripërtëritshme të energjisë si dhe ndikimit mjedisor nga sektori i energjisë, duke nxitur kështu kursimin e energjisë, eficiencën e energjisë, energjinë e ripërtëritshme si dhe hulumtimin dhe zbutjen e ndikimit mjedisor nga prodhimi i energjisë dhe konsumi;
- (c) hartimit të kushteve të kornizës për ristrukturimin e shoqërive të energjisë dhe bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve në këtë sektor, në përputhje me rregullat e tregut të brendshëm të energjisë të BE-së për shthurjen (unbundling).

¹ OJ BE L 198, 20.7.2006, f. 18.

Mjedisi

Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në fushën e mjedisit me detyrën shumë të rëndësishme të ndalimit të degradimit të mëtejshëm mjedisor dhe fillimin e përmirësimit të gjendjes mjedisore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë. Palët do të bashkëpunojnë në fushën e cilësisë së ajrit dhe ujit (përfshirë substanca radioaktive në ujin e destinuar për konsum njerëzor), standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen nga rreziqet që dalin nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues, të gjitha llojet e menaxhimit të mbetjeve (përfshirë menaxhimin e përgjegjshëm dhe të sigurt të mbetjeve radioaktive) dhe mbrojtjen e natyrës, monitorimin dhe zvogëlimin e emetimeve industriale, duke garantuar sigurinë në instalimet industriale, si dhe klasifikimin dhe trajtimin e sigurt të kimikateve në Kosovë.

Në veçanti Palët do të krijojnë bashkëpunim me qëllim të fuqizimit të strukturave dhe procedurave administrative të Kosovës për të siguruar planifikimin strategjik të çështjeve mjedisore dhe koordinimit midis aktorëve relevantë dhe do të përqendrohet në përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së dhe është e përshtatshme me *acquis* të Euratom. Bashkëpunimi mundet gjithashtu të përqendrohet në zhvillim të strategjive nga Kosova, për të zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme ndotjen e ajrit dhe e ujit në nivel lokal, rajonal dhe ndërkufitar, për të krijuar një kornizë për prodhim dhe konsum të energjisë efikase, të pastër, të qëndrueshme dhe të rinovueshme, dhe për të realizuar vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe vlerësimin strategjik mjedisor.

NENI 116

Ndryshimi Klimatik

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim që të ndihmojë Kosovën të zhvilloj politikën e saj klimatike dhe të i përfshijë shqetësimet klimatike në energji, transport, industri, bujqësi, arsim dhe në politikat tjera përkatëse. Një bashkëpunim i tillë gjithashtu do të mbështes përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së mbi ndryshimin klimatik, në veçanti monitorimin, raportimin dhe verifikimin efektiv të emetimit të gazrave serrë. Bashkëpunimi i tillë do ta ndihmojë Kosovën në ngritjen e kapaciteteve të duhura administrative dhe procedurave të koordinimit ndërmjet gjithë aktorëve relevantë për të mundësuar miratimin dhe zbatimin e politikave të karbonit të ulët dhe të rritjes fleksibile klimatike. Palët do të bashkëpunojnë me qëllim për të ndihmuar përfshirjen e Kosovës në përpjekjet globale dhe rajonale për të zbutur dhe përshtatur me ndryshimet e klimës, nëse e mundësojnë rrethanat objektive.

NENI 117

Mbrojtja civile

Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre në përmirësimin e parandalimit, përgatitjes dhe reagimit ndaj katastrofave natyrore dhe atyre të shkaktuara nga faktori njeri. Në veçanti bashkëpunimi do të synojnë rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes civile të Kosovës dhe në përafrimin gradual të Kosovës me *acquis* të BE-së lidhur me menaxhimin e katastrofave.

Bashkëpunimi mund të përqendrohet në përparësitë e mëposhtme:

- (a) Njoftimin dhe paralajmërimin e hershëm për fatkeqësitë; mbulimi i Kosovës nga sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe nga mjete monitoruese Evropiane,
- (b) vendosjen e komunikimit efektiv 24 orësh mes shërbimeve emergjente të Kosovës dhe ato të Komisionit Evropian,
- (c) sigurimin e bashkëpunimit në rast të emergjencave të mëdha duke përfshirë lehtësimin e ofrimit dhe pranimit të asistencës dhe mbështetjes vendëse,

- (d) Përmirësimin e bazës së njohurive mbi fatkeqësitë dhe rreziqet dhe zhvillimi i planeve për vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e fatkeqësive për gjithë Kosovën,
- (e) zbatimin e praktikave më të mira dhe udhëzimeve në fushën e parandalimit të fatkeqësive, gatishmërisë dhe reagimit.

NENI 118

Kërkimi shkencor dhe zhvillimi teknologjik

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin në kërkimet civile shkencore dhe zhvillimin teknologjik mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë dhe duke marrë parasysh burimet e disponueshme, qasjen e duhur në programet e tyre përkatëse, të kushtëzuara këto nga nivelet e përshtatshme të mbrojtjes efikase të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik.

NENI 119

Zhvillimi rajonal dhe lokal

Palët do të përpiqen të identifikojnë masat për të forcuar bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe zvogëlimin e pabarazive rajonale. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkufitar, transkombëtar dhe ndër-rajonal.

Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e zhvillimit rajonal.

NENI 120

Administrata publike

Bashkëpunimi dhe dialogu do të synojnë mundësimin e zhvillimit të mëtejshëm të një administrate publike profesionale, efiçente dhe llogaridhënëse në Kosovë, duke u bazuar në përpjekjet e ndërmarra për reforma në këtë fushë deri më tani, përfshirë reformat që ndërlidhen me procesin e decentralizimit dhe të krijimit të komunave të reja. Bashkëpunimi do të mbështes në veçanti sundimin e ligjit, funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore për të mirën e popullsisë së Kosovës në tërësi si dhe zhvillimin normal të marrëdhënieve mes BE-së dhe Kosovës.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të përqendrohet kryesisht në ndërtimin e institucioneve, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit të bazuara në merita, transparencë dhe paanshmëri si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm dhe promovimin e etikës në kuadër të administratës publike. Bashkëpunimi do të përfshij gjithashtu përmirësimin e efikasitetit dhe kapacitetit të organeve të pavarura që shërbejnë për funksionimin e administratës publike dhe për një sistem efikas të kontrolleve dhe balancave.

TITULLI IX

BASHKËPUNIMI FINANCIAR

NENI 121

Për të arritur objektivat e kësaj marrëveshjeje dhe në përputhje me nenet 7, 122 dhe 123 dhe 125 Kosova mund të marrë asistencë financiare nga BE-ja në formë grantesh dhe huash, duke përfshirë huat nga Banka Evropiane e Investimeve. Ndihma financiare e BE-se kushtëzohet me përparimin e mëtutjeshëm në përmbushjen e kriterëve politike të Kopenhagës. Duhet, po ashtu, të merret në konsideratë përmbushja e detyrimeve të Kosovës me këtë marrëveshje si dhe raportet vjetore të progresit për Kosovën. Ndihma financiare e BE-së, po ashtu, do t'i nënshtrohet kushtëzimeve të PSA-së, në veçanti sa i përket angazhimit të përfituesit për të kryer reformat demokratike, ekonomike dhe institucionale. Ndihma financiare që i jepet Kosovës do të orientohet drejt nevojave të konstatuara, prioriteteve të pajtuara dhe kapacitetit për të thithur dhe për të dhënë rezultate si dhe masave të marra për të reformuar dhe për të ristrukturuar ekonominë.

NENI 122

Asistenca financiare, në formën grantesh, do të sigurohet në përputhje me rregulloret përkatëse të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit brenda një kornize indikative shumë-vjeçare të bazuar në programe vjetore apo shumëvjeçare të caktuara nga BE-ja pas konsultimeve me Kosovën.

NENI 123

Asistenca financiare mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së, zhvillimit socio-ekonomik, qeverisjes së mirë, reformës së administratës publike, energjisë dhe bujqësisë.

NENI 124

Me kërkesë të Kosovës dhe në raste me nevoja të veçanta, BE-ja, në koordinim me institucionet ndërkombëtare financiare mund të shqyrtojë mundësinë e dhënies së asistencës makro-financiare në baza të jashtëzakonshme e cila varet nga kushte të caktuara, duke marrë parasysh disponueshmërinë e të gjitha burimeve financiare. Kjo asistencë mund të jepet pas përmbushjes së kushteve që do të vendosen në kontekstin e një programi për të cilin është arritur pajtimi në mes Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

NENI 125

Me qëllim që të mundësohet përdorimi sa më optimal i burimeve ekzistuese, Palët do të sigurohen që asistencë financiare e BE-së të jepet në bashkëpunim të ngushtë me atë nga burimet e tjera si ato prej shteteve anëtare, vendeve të tjera jashtë BE-së dhe institucioneve financiare ndërkombëtare.

Për këtë qëllim, Kosova duhet rregullisht të ofrojë informata për të gjitha burimet e asistencës.

TITULLI X

DISPOZITAT INSTITUCIONALE, TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

NENI 126

Me anë të kësaj krijohet një Këshill i Stabilizim Asociimit (KSA), i cili do të mbikëqyr aplikimin dhe zbatimin dhe e kësaj Marrëveshjeje. Ai mblidhet në një nivel të përshtatshëm në intervale të rregullta dhe të thërras mbledhje të jashtëzakonshme kur e kërkojnë rrethanat. Ai do të shqyrtoj çdo çështjet madhore që dalin në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo çështje tjetër të interesit të përbashkët.

NENI 127

1. KSA do të përbëhet nga përfaqësuesit e BE-së nga njëra anë dhe përfaqësuesit e Kosovë nga ana tjetër.
2. KSA do të vendosë rregullat e veta të procedurës
3. Anëtarët e KSA-së mund të organizohen që të përfaqësohen në përputhje me kushtet e parashikuara në rregullat e veta të procedurës.
4. KSA-ja do të kryesohet me rotacion nga një përfaqësues i BE-së dhe nga një përfaqësues i Kosovës, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në rregullat e veta të procedurës.
5. Për çështjet që lidhen me të, Banka Evropiane e Investimeve do të merr pjesë si vëzhgues në punën e KSA-së.

NENI 128

KSA-ja me qëllim të arritjes së objektivave të kësaj Marrëveshjeje, ka fuqinë të marrë vendime brenda fushëveprimit të kësaj Marrëveshjeje në rastet e parashikuara në të. Vendimet e marra do të jenë detyruese për Palët, të cilat do të marrin masat e nevojshme për t'i zbatuar vendimet e marra. KSA-ja, gjithashtu mund të bëjë rekomandime përkatëse. Ai harton vendimet dhe rekomandimet e tij me marrëveshjeje në mes të Palëve.

NENI 129

1. KSA asistohet gjatë kryerjes së detyrave të tij nga Komisioni i Stabilizim Asociimit, i cili nga njëra anë përbëhet nga përfaqësues të BE-së dhe Kosovës nga ana tjetër.
2. Në rregulloren e tij të punës, KSA-ja përcakton detyrat e Komisionit të Stabilizim Asociimit, të cilat përfshijnë përgatitjen e takimeve të KSA, dhe vendosë për mënyrën e funksionimit të Komisionit.
3. KSA mund t'i delegojë Komisionit të Stabilizim Asociimit cilëndo kompetencë të tij. Në këtë rast Komisioni i Stabilizim Asociimit merr vendimet e tij duke ju përmbajtur kushteve të parashikuara në nenin 128.

NENI 130

Komisioni i Stabilizim Asociimit mund të krijojë nën-komitete dhe grupe të veçanta. Para përfundimit të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Komisioni i Stabilizim Asociimit do të krijojë nën-komisionet e nevojshme për zbatimin e duhur të Marrëveshjes.

Do të krijohet një nën-komitete që do të trajtoj çështjet e migrimit.

NENI 131

KSA mund të vendosë që të ngrejë komitete ose organe të tjera të veçanta, që mund ta ndihmojë atë në kryerjen e detyrave të tij. Në rregulloren e tij të brendshme, KSA vendos përbërjen dhe detyrat e komiteteve apo organeve të tilla dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

NENI 132

Me këtë themelohet Komisioni Parlamentar për Stabilizim Asociimin (në tekstin e mëtejshëm “Komisioni Parlamentar”). Ky do të jetë një forum i Anëtarëve të Parlamentit Evropian dhe Anëtarëve të Parlamentit të Kosovës për tu takuar dhe shkëmbyer mendimet e tyre. Ai do të mbledhet në intervale kohore që vendosen nga vetë ai, por të paktën një herë në vit.

Komiteti Parlamentar përbëhet nga Deputet të Parlamentit Evropian dhe Deputet të Parlamentit të Kosovës.

Komisioni Parlamentar do të hartoj vetë rregulloren e punës.

Komisioni Parlamentar kryesohet me rotacion nga një Anëtarë i Parlamentit Evropian dhe nga një Anëtarë i Parlamentit të Kosovës, sipas dispozitave që do të parashikohen nga rregullorja e punës.

Komisioni Parlamentar mund t’i bëjë rekomandime KSA.

NENI 133

Në kuadër të fushëveprimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët marrin përsipër t’u sigurojë personave fizik dhe juridik të Palës tjetër kanë qasje, pa i diskriminuar, në mjetet e duhura juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

NENI 134

Kjo Marrëveshje nuk pengon asnjërën Palë të marrë masa të cilat i konsideron të nevojshme për të parandaluar publikimin e informacionit në kundërshtim me interesat e saja themelore të sigurisë.

NENI 135

1. Në fushat që mbulon kjo Marrëveshje:

(a) rregullimet e zbatuara nga Kosova në lidhje me BE-në nuk duhet të jenë burim diskriminimi mes Shteteve Anëtare, qytetarëve të tyre, kompanive ose firmave të tyre;

(b) rregullimet e zbatuara nga BE-ja në lidhje me Kosovën nuk duhet të jenë burim diskriminimi mes qytetarëve të Kosovës si dhe në mes të kompanive apo firmave Kosovare.

2. Paragrafi 1 nuk cenon dispozitat e veçanta në këtë marrëveshje, përfshirë dhe sidomos Nenin 70 (3).

NENI 136

1. Palët do të marrin të gjitha masat specifike ose të përgjithshme që duhen për të përmbushur detyrimet e dala nga kjo Marrëveshje. Ato do të kujdesen që objektivat e parashikuara në këtë Marrëveshje të përmbushen.

2. Palët bien dakord që të konsultohen sa më shpejt që të jetë e mundur nëpërmjet kanaleve përkatëse, me kërkesë të njërës prej Palëve, për të diskutuar çdo çështje që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje si dhe aspekte të tjera relevante të marrëdhënieve ndërmjet Palëve.

3. Secila Palë i referohet KSA-së për mosmarrëveshje lidhur me zbatimin apo interpretimin e kësaj Marrëveshje. Në atë rast, neni 137 dhe, sipas nevojës, mund të aplikohet Protokollin V.

KSA-ja mund të zgjidh mosmarrëveshjet përmes vendimeve detyruese.

4. Nëse njëra nga Palët vlerëson se Pala tjetër ka dështuar në përmbushjen e një prej detyrimeve të kësaj Marrëveshje, ajo mund të marrë masat e duhura. Para se të veprojë në këtë mënyrë, me përjashtim të rasteve tepër urgjente, ajo i paraqet KSA-së informacionin përkatës të nevojshëm për një ekzaminim të plotë të situatës, me synim kërkimin e një zgjidhjeje të pranueshme për Palët.

Gjatë përzgjedhjes së masave, përparësi u jepet detyrimit atyre që cenojnë më pak funksionimin e kësaj Marrëveshje. Këto masa i bëhen të ditura menjëherë KSA-së dhe bëhen objekt konsultimesh, nëse këtë e kërkon Pala tjetër, në kuadër të KSA-së, Komisionit të Stabilizim-Asociimit, apo ndonjë organi tjetër të krijuar mbi bazat e nenit 130 dhe nenit 131.

5. Paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni nuk duhet assesi të ndikojnë dhe të cenojnë nenet 34,42,43,44,48 dhe Protokollin III (Përkufizimi i konceptit të produkteve origjinale dhe metodat e bashkëpunimit administrativ).

6. Paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni nuk do të zbatohen në nenet 5 dhe 13.

1. Kur mes Palëve ka mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose me zbatimin e kësaj Marrëveshje, cilado Palë duhet të njoftoj Palën tjetër dhe KSA-në me kërkesë formale që çështja e mosmarrëveshjes të zgjidhet.

Në rast se njëra Palë konsideron që masa e miratuar nga Pala tjetër, apo dështimi i Palës tjetër për të vepruar, përbën shkelje të obligimeve të saja sipas kësaj Marrëveshje, kërkesa formale që të zgjidhet mosmarrëveshja duhet të paraqes arsyet për këtë mendim dhe të tregojë, sipas rastit, që Pala mund të miratoj masa siç janë paraparë në Nenin 136(4).

2. Palët duhet të përpiqen t'i zgjidhin mosmarrëveshjet duke hyre në konsultime me mirëbesim në kuadër të KSA-së dhe organeve tjera të parapara në paragrafin 3, me qëllim të arritjes sa më parë të një zgjidhje të pranueshme për të dy palët.

3. Palët duhet t'i sigurojnë KSA-së të gjitha informatat e nevojshme përkatëse për një shqyrtim të plotë të situatës.

Për aq sa kohë sa nuk ka zgjidhje të mosmarrëveshjes, kjo çështje duhet të diskutohet në çdo takim të KSA-së, përveç nëse është inicuar procedura e arbitrazhit e paraparë sipas Protokollit V. Një mosmarrëveshje do të vlerësohet e zgjidhur atëherë kur KSA-ja merr vendim detyrues për të zgjidhur çështjen sipas Nenit 136(3), ose kur deklaron se nuk ekziston më një mosmarrëveshje.

Konsultimet rreth mosmarrëveshjes mund të mbahen po ashtu edhe gjatë takimeve të Komitetit të Stabilizim-Asocimit apo në ndonjë komitet ose organ tjetër përkatës bazuar në nenin 130 dhe 131, siç është dakorduar mes Palëve ose me kërkesë të njërës Palë. Konsultimet mund të mbahen gjithashtu në formë të shkruar.

Të gjitha informatat e shpalosura gjatë konsultimeve duhet të mbesin konfidenciale.

4. Për çështjet në kuadër të fushëveprimit të zbatimit të Protokollit V, cilado Palë mund të paraqesë ndonjë mosmarrëveshje për zgjidhje përmes arbitrazhit në përputhje me atë Protokoll, kur Palët kanë dështuar të zgjidhin mosmarrëveshjen brenda dy muajve pas fillimit të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni.

NENI 138

Derisa të arrihen të drejtat ekuivalente për individët dhe operatorët ekonomikë sipas kësaj Marrëveshje, kjo Marrëveshje nuk ndikojnë në të drejtat e tyre të siguruara përmes marrëveshjeve ekzistuese, që është obligative për një ose më shumë Shtete Anëtare, nga njëra anë, dhe Kosovën në anën tjetër.

NENI 139

Shtojcat nga I deri VII, Protokollet 1, 2, 3, 4 dhe 5, si dhe Deklarata përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshje.

NENI 140

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pakufizuar.

Secila Palë mund të shpall të pavlefshme këtë Marrëveshje duke njoftuar Palën tjetër. Kjo Marrëveshje shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së këtij njoftimi.

Secila Palë mund të pezullojë tërësisht ose një pjesë të kësaj Marrëveshje, me efekt të menjëhershëm, në rast të mos-pajtueshmërisë nga Pala tjetër me njërin nga elementet thelbësore të kësaj Marrëveshje.

BE-ja mund të marrë masa që ajo i konsideron të përshtatshme, përfshirë edhe pezullimin në tërësi ose të një pjesë të kësaj Marrëveshje, me efekt të menjëhershëm, në rast të mos-pajtueshmërisë nga ana e Kosovës me parimet themelore të përcaktuara në nenet 5 dhe 13.

NENI 141

Kjo Marrëveshje zbatohet, në njërin anë, në territoret në të cilat zbatohen Traktati mbi Bashkimin Evropian, Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe Traktati Themelues i Komunitetit

Evropian të Energjisë Atomike dhe sipas kushteve të përcaktuara në këto Traktate , dhe nga ana tjetër në territorin e Kosovës.

NENI 142

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian do të jetë depozitari i kësaj Marrëveshje.

NENI 143

Kjo Marrëveshje do të hartohet në dublikatë në gjuhët: Bullgare, Kroate, Çeke, Daneze, Holandeze, Angleze, Estoneze, Finlandeze, Frënge, Gjermane, Greke, Hungareze, Italiane, Letoneze, Lituaneze, Malteze, Poloneze, Portugeze, Rumune, Sllovake, Sllovene, Spanjolle, Suedeze, Shqipe dhe Serbe, dhe në tekste njësoj autentike.

NENI 144

Palët do të miratojnë këtë Marrëveshje në pajtim me procedurat e tyre.

Kjo Marrëveshje do të hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës në të cilën Palët do të njoftojnë njëra tjetrën se procedurat e referuara në paragrafin e parë kanë përfunduar.

LISTA E SHTOJCAVE, PROTOKOLLEVE DHE DEKLARATAVE

SHTOJCAT

Shtojca I (Neni 23)	Tarifat koncesionare të Kosovës për produktet industriale të BE-së
Shtojca II (Neni 28)	Përkufizimi i produkteve të “mishit të viçit”
Shtojca III (Neni 29)	Tarifat koncesionare të Kosovës për produktet bujqësore të BE-së
Shtojca IV (Neni 31)	Koncesionet e BE-së për produktet e peshkimit të Kosovës
Shtojca V (Neni 32)	Tarifat koncesionare të Kosovës për produktet e peshkut dhe peshkimit të BE-së
Shtojca VI (Neni 50)	Themelimi: Shërbimet financiare
Shtojca VII (Neni 77)	Të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare

PROTOKOLLET

Protokolli I (Neni 27)	Tregtia mes BE-së dhe Kosovës së produkteve të përpunuara bujqësore
Protokolli II (Neni 30)	Verërat, pijet alkoolike dhe verërat e aromatizuara
Protokolli III (Neni 46)	Lidhur me konceptin e "origjinës së produkteve”
Protokolli IV (Neni 104)	Asistenca reciproke administrative në çështjet doganore
Protokolli V (Neni 136)	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

DEKLARATAT

Deklarata e përbashkët

SHTOJCA Ia

TARIFAT KONCESIONARE TË KOSOVËS
PËR PRODUKTET INDUSTRIALE TË BE-së

Të referuara në Nenin 23

Tarifa bazë mbi të cilin zbatohen reduktimet tarifore të mëvonshme të përcaktuara në këtë Shtojcë që do të aplikohen, do të jetë tarifa bazë prej 10% e aplikuar në Kosovë që nga 31 Dhjetori 2013. Normat e tarifave do të reduktohen si më poshtë.

- (a) Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 80% të tarifës bazë, d.m.th 8%;
- (b) në datën 1 janar të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 60% të tarifës bazë, d.m.th 6%;
- (c) në datën 1 janar të vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 40% të tarifës bazë, d.m.th 4%;
- (d) në datën 1 janar të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 20% të tarifës bazë, d.m.th 2%;
- (e) në datën 1 janar të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifat e mbetura të importit do të anulohen.

Kodi	Përshkrimi ¹
2501 00	Kripe (duke përfshirë kripen e tavolinës dhe kripen e denatruar) dhe klorurin e pastër të natriumit, nëse është apo jo në solucion ujor apo që përmban apo jo agjente shtesë kundër aglomerimit apo agjente që sigurojnë një fluiditet të mire; uji i detit:
	- Kripe (duke përfshirë kripen e tavolinës dhe kripen e denatruar) dhe klorurin e pastër të natriumit, nëse është apo jo në solucion ujor apo që përmban apo jo agjente shtesë kundër aglomerimit apo agjente që sigurojnë një fluiditet të mire:
	- -Të tjera:
2501 00 51	- - - E denatruar apo për përdorim industrial (duke përfshirë rafinimin) ndryshe nga ruajtja apo përgatitja e ushqimeve për konsum human apo shtazor
	- - - Tjera:
2501 00 91	- - - - Kripë e përshtatshme për konsum njerëzor
2501 00 99	- - - - Të tjera
2505	Rërë natyrale e të gjitha llojeve, nëse është apo jo e ngjyrosur, përveç rërës metal-duruese të Kapitullit 26:
2505 10 00	- Rërë silici dhe rërë kuarci
2506	Kuarc (përveç rërërave natyrale); kuarcite, nëse janë apo jo të punuar trashë apo thjesht të prera, nga sharrimi apo ndryshe, në blloqe apo në pllaka me formë drejtkëndëshe (përfshirë edhe katrorin):
2506 10 00	- Kuarc
2507 00	Kaoline dhe argjila të tjera kaolinike, nëse janë apo jo të kalciuara:
2507 00 80	- Argjila të tjera kaolinike
2508	Argjila të tjera (pa përfshirë argjilat e zgjerueshme të kreut 6806), andaluzite, cianide dhe silimanite, nëse janë apo jo të kalciuara; mullite, dhera shamoti apo dhera dinas:
2508 10 00	- Bentonite
2508 40 00	- Argjila të tjera
2508 70 00	- Dhera shamoti apo dhera dinas

¹ Referencat për kodet dhe përshkrimet e mallrave janë në përputhje me Nomenklaturën e Kombinuar të zbatuar në vitin 2014, në përputhje me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1001/2013 të 4 tetorit 2013 që ndryshon Shtojcën I të Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 2658/87 mbi tarifën dhe nomenklaturën statistikore dhe mbi Tarifën e Përbashkët Doganore (OJ L BE 290, 31.10.2013, f. 1).

Kodi	Përshkrimi ¹
2515	Mermer, travertine, ekauzine gëlqerorë dhe gurë tjerë monumentale apo ndërtimor gëlqeror me një gravitet specifik të dukshëm prej 2.5 apo më shumë, dhe alabaster, nëse është apo jo e prerë trashë apo thjesht e prerë, nga sharrimi apo ndryshe, në blloqe apo pllaka në formë drejtkëndëshe (përfshirë katrorin)
2517	Guralecët, zhavorri, gurët e thyer apo të shtypur, të një lloji të përdorur kryesisht për betonim, për metalizimin e rrugëve apo për hekurudha apo balaste tjera, petaver dhe strall, nëse janë apo jo të trajtuara me nxehtësi; zhavorr për të shtruar rrugët prej zgjyre, bramce apo prej mbeturinave të ngjashme industriale, nëse janë apo jo të bashkuar me materialet e dhëna në pjesën e parë të kreut; zhavorr i lyer me katran për të shtruar rrugët; copat, pluhuri dhe granulet e gurëve të kreut nr. 2515 apo 2516, nëse janë apo jo të trajtuara me nxehtësi:
2517 10	- Guralecët, zhavorri, gurët e thyer apo të shtypur, të një lloji të përdorur kryesisht për betonim, për metalizimin e rrugëve apo për hekurudha apo balaste tjera, petaver dhe strall, nëse janë apo jo të trajtuara me nxehtësi;
2517 10 20	- - Gur gëlqeror, dolomite dhe gur tjetër gëlqeror , të thyer ose grimcuar
2517 30 00	- Zhavorr i lyer me katran
2520	Gips; anhidrit; suva (e përbërë nga gipsi i kalcinuar apo sulfat kalciumi) nëse është apo jo e ngjyrosur, me ose pa sasi të vogla të përshpejtuesve apo të ngadalësuesve
2522	Gëlqere e pashuar, gëlqere e shuar dhe gëlqere hidraulike, përveç oksidit dhe hidroksidit të kalciumit të kreut nr. 2825:
2522 20 00	- Gëlqere e shuar
2523	Çimento portland, çimento oksidalumini, çimento skorjesh, çimento supersulfati dhe çimento të ngjashme hidraulike, nëse janë apo jo të ngjyrosur apo në formën e klinkerit:
2523 10 00	- Klinkerët e çimentos
2526	Steatitet natyrale, nëse janë apo jo të punuar trashë apo thjesht të prera, nga sharrimi apo ndryshe, në blloqe apo pllaka në formë drejtkëndëshe (duke përfshirë edhe katrorin); talk:
2526 20 00	- E grimcuar ose e pluhurosur
2530	Substanca minerale të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër:
2530 90 00	- Të tjera

Kodi	Përshkrimi ¹
3001	Gjëndrat dhe organe të tjera për përdorim organo-terapik, të thara, nëse janë apo jo të puderzuara; ekstraktet e gjendrave apo të organeve të tjera apo të sekrecioneve të tyre për përdorim organo-terapik; heparine dhe kripërat e tij; substanca të tjera njerëzore apo shtazore të përgatitura për përdorime terapeutike apo profilaktike, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër:
3001 20	- Ekstraktet e gjendrave dhe organeve tjera ose të sekrecioneve të tyre:
3001 20 10	- - Të origjinës njerëzore
3001 90	- Të tjera:
	- - Të tjera:
3001 90 91	- - - Heparine dhe kripërat e tij
3001 90 98	- - - Tjera
3002	Gjaku i njerëzve; gjaku i kafshëve i përgatitur për përdorime terapeutike, profilaktike apo diagnostikuese; antisera dhe fraksione të tjera të gjakut dhe produktet e modifikuara imunologjike, nëse janë apo jo të fituara me anë të proceseve bioteknologjike; vaksinat, toksinat, kulturat e mikroorganizmave (përjashto tharmin) dhe produkte të ngjashme:
3002 10	- Antisera dhe fraksione të tjera të gjakut dhe produktet imunologjike, nëse janë apo jo të modifikuara apo fituara me anë të proceseve bioteknologjike
3002 30 00	- Vaksinat për mjekësinë veterinare
3002 90	- Të tjera:
3002 90 30	- - Gjaku i kafshëve i përgatitur për përdorime terapeutike, profilaktike apo diagnostikuese
3002 90 50	- - Kulturat e mikro-organizmave
3002 90 90	- - Të tjera
3003	Medikamentet (përjashtuar mallrat e kreut nr. 3002, 3005 apo 3006), të përbëra nga dy apo më shumë përbërës të përzier së bashku për përdorime terapeutike apo profilaktike, jo të vendosura në doza të caktuara apo në forma apo paketa për shitje me pakicë:
3003 10 00	- Që përmbajnë penicilinë ose derivate të tyre, me strukturë acidi penicillanik, ose streptomycin ose derivate të tyre

Kodi	Përshkrimi ¹
3003 20 00	- Me përmbajtje të antibiotikëve tjerë
	- Që përmbajnë hormone ose produkte tjera të kreut nr. 2937, por që nuk përmbajnë antibiotikë:
3003 31 00	- -Që përmbajnë insulinë
3003 40	- Që përmbajnë alkaloidë apo derivate të saj, por që nuk përmbajnë hormone ose produkte tjera të kreut 2937 ose antibiotikë
3003 90 00	- Të tjera
3004	Medikamentet (përjashto mallrat e kreut nr. 3002, 3005 apo 3006) të përbëra prej produkteve të përziara apo të papërziara për përdorime terapeutike apo profilaktike, të vendosura në doza të caktuara (duke i përfshirë ato në formë të sistemeve të administrimit transdermal) apo në forma apo paketa për shitje me pakicë:
	- Që përmbajnë hormone ose produkte tjera të kreut nr. 2937, por që nuk përmbajnë antibiotikë:
3004 32 00	- - Që përmbajnë hormone kortikosteroide, derivate të tyre apo analoge strukturore
3004 50 00	- Barnat tjera që përmbajnë vitamina ose produkte tjera të kreut nr. 2936
3004 90 00	- Të tjera
3005	Mbushjet, gazrat, fashat dhe artikuj të ngjashëm (p.sh, veshjet, leukoplast, poultices), të mbuluara apo të ngopura me substanca farmaceutike apo vendosur në forma apo paketa për shitjen me pakicë për qëllime medikale, kirurgjikale, dentare apo veterinare:
3005 90	- Të tjera:
	- - Të tjera:
	- - - Prej materialeve tekstile:
3005 90 50	- - - - Të tjera

Kodi	Përshkrimi ¹
3006	Mallrat farmaceutike të specifikuara në shënimin 4 të këtij kapitulli:
3006 10	- Kordat sterile kirurgjikale, materialet e ngjashme sterile (përfshirë fjet absorbuese sterile kirurgjike apo dentare) për qepjen e plagëve dhe ngjitësit sterile për mbylljen e plagëve kirurgjikale; mbuluesit steril laminaria dhe laminaria sterile; hemostatikët dentar apo hemostatikët steril absorbues kirurgjikal; barrierat ngjitëse sterile kirurgjikale apo dentare nëse janë apo jo absorbuese:
3006 10 10	- - Kordat sterile kirurgjikale
3006 20 00	- Reagjentët e grupit të gjakut
3006 30 00	- Preparatet e padepërtueshme nga drita për ekzaminime me rreze X; reagjentët diagnostikues të përcaktuara për tu administruar tek pacienti
3006 50 00	- Kutitë dhe çantat e ndihmës së parë
3006 60 00	- Preparatet kontraceptive kimike bazuar në hormone, në produkte tjera të Kapitullit 2937 apo në spermicide
3006 70 00	- Përgatitja e prezantuar në formë xheli, destinuar për përdorim në mjekësi apo veterinari, si lubrifikant për disa pjesë të trupit në vijim të operacioneve kirurgjikale apo ekzaminimeve mjekësore, ose si agjente lidhës ndërmjet trupit dhe instrumenteve mjekësore.
	- Të tjera:
3006 92 00	- - Mbeturinat farmaceutike
2208 60 19	- - - Më shumë se 2 litra	80	60	40	20	0	0	0
	- - Të një force alkoolike ndaj volumit prej më shumë se 45,4% vol në kontejnerë që mban:							
2208 60 91	- - - 2 litra ose më pak	90	80	70	50	30	10	0
2208 60 99	- - - Më shumë se 2 litra	80	60	40	20	0	0	0
2208 70	- Liker dhe tonike							
2208 70 10	- - Në kontejnerë që mbajnë 2 litra ose më pak	90	80	70	50	30	10	0
2208 70 90	- - Në kontejnerë që mbajnë më shumë se 2 litra	80	60	40	20	0	0	0
2208 90	- Të tjera	80	60	40	20	0	0	0

Kodi NK	Përshkrimi ¹	Tarifa doganore (% e MFN)						
		Viti 1 Hyrja në fuqi	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7 dhe përtej
2402	Puro, cigare dhe cigarillos, prej duhanit ose prej zëvendësuesve të duhanit:							
2402 10 00	- Puro dhe cigarillos, që përmbajnë duhan	0	0	0	0	0	0	0
2402 20	- Cigare që përmbajnë duhan:							
2402 20 10	- - Që përmban karafil	0	0	0	0	0	0	0
2402 20 90	- - Të tjera	90	80	70	50	30	10	0
2402 90 00	- Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
2403	Prodhime tjera të duhanit dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit; duhan i "homogjenizuar" apo i "rindërtuar"; ekstraktet dhe esencat e duhanit:							
	- Duhan për pirje, nëse përmban apo jo zëvendësues të duhanit në çfarëdo proporcioni:							
2403 11 00	- - Nargjile siç është specifikuar në shënimin e nën-kreut 1 të këtij kapitulli	0	0	0	0	0	0	0
2403 19	- - Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
	- Të tjera:							
2403 91 00	- - Duhan i "homogjenizuar" apo i "rindërtuar"	0	0	0	0	0	0	0
2403 99	- - Të tjera:	0	0	0	0	0	0	0

Kodi NK	Përshkrimi ¹	Tarifa doganore (% e MFN)						
		Viti 1 Hyrja në fuqi	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7 dhe përtej
2905	Alkoolet aciklike dhe derivatet e tyre të halogjenizuara, të sulfonatuara, të nitratuara ose të nitrosaturuara:							
	- Alkoolet tjera polihidrike:							
2905 43 00	- - Mannitol	0	0	0	0	0	0	0
2905 44	- - D-glucitol (sorbitol)	0	0	0	0	0	0	0
2905 45 00	- - Glicerine	0	0	0	0	0	0	0
3301	Vajra esenciale (të terpentuara ose jo), përfshirë vajrat konkrete dhe absolute; rrëshirat; oleoresinat e ekstraktuara; koncentratet e vajrave esenciale në yndyra, në vajra të fiksuara, në formë dylli apo të ngjashme, të fituara nëpërmjet zbutjes ose heqjes së esencave; nënproduktet terpenike të fituara nëpërmjet deterpentimit të vajrave esenciale; distilatet ujore dhe solucionet ujore të vajrave esenciale:							
3301 90	- Të tjera	0	0	0	0	0	0	0

Kodi NK	Përshkrimi ¹	Tarifa doganore (% e MFN)						
		Viti 1 Hyrja në fuqi	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7 dhe përtej
3302	Përzierjet e substancave aromatike dhe përzierjet (përfshirë solucionet alkoolike) me bazë të një ose më shumë prej këtyre substancave, të një lloji të përdorur si lëndë e parë në industri; preparatet e tjera të bazuara në substancat aromatike, të një lloji të përdorur për prodhimin e pijeve:							
3302 10	- Të një lloji të përdorur në industrinë e ushqimit ose të pijeve:							
	- - Të një lloji të përdorur në industrinë e pijeve:							
	- - - Preparatet që përmbajnë të gjithë agjentët aromatizues që karakterizojnë një pije:							
3302 10 10	- - - - Me një force alkoolike aktuale më shumë se 0,5% ndaj volumit	0	0	0	0	0	0	0
	- - - - Të tjera:							
3302 10 21	- - - - - Që nuk përmban yndyrë qumështi, sakarozë, izo-glukozë, glukozë ose niseshte ose që përmban, ndaj peshës, me pak se 1,5% yndyrë qumështi, 5% sakarozë ose izo-glukozë, 5% glukozë ose niseshte	0	0	0	0	0	0	0
3302 10 29	- - - - - Të tjera	0	0	0	0	0	0	0

Kodi NK	Përshkrimi ¹	Tarifa doganore (% e MFN)						
		Viti 1 Hyrja në fuqi	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7 dhe përtej
3501	Kaseine, kaseinate dhe derivatet e tjera prej kaseine; tutkall kaseine:							
3501 10	- Kaseine	0	0	0	0	0	0	0
3501 90	- Të tjera:							
3501 90 90	- - Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
3505	Dekstrinat dhe niseshtet tjera të modifikuara (p.sh, niseshtet e esterefikuara apo të paraxhelatinuara); ngjitësat e bazuar në niseshte, apo mbi dekstrinat apo mbi niseshtet e tjera të modifikuara:							
3505 10	- Dekstrinat dhe niseshtet e tjera të modifikuara:	0	0	0	0	0	0	0
3505 20	- Ngjitësat	0	0	0	0	0	0	0

Kodi NK	Përshkrimi ¹	Tarifa doganore (% e MFN)						
		Viti 1 Hyrja në fuqi	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7 dhe përtej
3809	Agjentët ilustrues, agjentët mbajtës të bojës për të shpejtuar ngjyrosjen apo fiksimin e bojërave si dhe produkte dhe preparate tjera (për shembull, materialet lidhëse dhe fiksuese), të një lloji të përdorur në industrinë tekstile, të letrës, lëkurës ose në industri të ngjashme, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër:							
3809 10	- Me bazë nga substancat e niseshtës							
3809 10 10	- - Që përmbajnë ndaj peshës së substancave të tilla më pak se 55%	80	60	40	20	0	0	0
3809 10 30	- - Që përmbajnë ndaj peshës së substancave të tilla 55% apo më shumë por më pak se 70%	0	0	0	0	0	0	0
3809 10 50	- - Që përmbajnë ndaj peshës së substancave të tilla 70% apo më shumë por më pak se 83%	0	0	0	0	0	0	0
3809 10 90	- - Që përmbajnë ndaj peshës së substancave të tilla 83% apo më shumë	80	60	40	20	0	0	0
3823	Acidet yndyrore monokarboksilike industriale; vajrat acide nga rafinimi; alkoolet industriale yndyrore							
	- Acidet yndyrore monokarboksilike industriale, vajrat acide nga rafinimi:							
3823 11 00	- - Acidi stearik	0	0	0	0	0	0	0
3823 12 00	- - Acidi oleik	0	0	0	0	0	0	0
3823 13 00	- - Acidet yndyrore të tall oil (tallol)	0	0	0	0	0	0	0

Kodi NK	Përshkrimi ¹	Tarifa doganore (% e MFN)						
		Viti 1 Hyrja në fuqi	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7 dhe përtej
3823 19	- - Të tjera:	0	0	0	0	0	0	0
3823 70 00	Alkoolet industriale yndyrore	80	60	40	20	0	0	0
3824	Lidhësit e përgatitur për format ose bërthamat në fonderi; produktet kimike dhe preparatet kimike të industrive kimike ose aleate (duke përfshirë edhe ato të përbërë nga përzierjet e produkteve natyrore), të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër:							
3824 60	- Sorbitol përveçse atij të nën-kreut 2905 44:							
	- - në solucion ujor:							
3824 60 11	- - - Që përmbajnë 2% apo më pak ndaj peshës D-manitol, llogaritur në bazë të përmbajtjes së D-glucitolit	0	0	0	0	0	0	0
3824 60 19	- - - Të tjera	80	60	40	20	0	0	0
	- - Të tjera:							
3824 60 91	- - - Që përmbajnë 2% apo më pak ndaj peshës D-manitol, llogaritur në bazë të përmbajtjes së D-glucitolit	0	0	0	0	0	0	0
3824 60 99	- - - Të tjera	80	60	40	20	0	0	0

PROTOKOLLI II
MBI KONCESIONET RECIPROKE PREFERENCIALE
PËR VERËRAT E CAKTUARA, NJOHJA, MBROJTJA
DHE KONTROLI RECIPROK I EMRAVE TË VERËRAVE,
PIJEVE ALKOOLIKE DHE VERËRAVE TË AROMATIZUARA

NENI 1

Ky Protokoll përfshin:

(1) një Marrëveshje mbi koncesionet reciproke preferenciale tregtare për verërat e caktuara (Shtojca I e këtij Protokoll),

(2) një Marrëveshje mbi njohjen reciproke, mbrojtjen dhe kontrollin e emrave të verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara (Shtojca II e këtij Protokoll).

Listat e referuara në Nenin 4 (b) të Marrëveshjes së përmendur në pikën 2 të këtij Neni do të krijohen gjatë një fazë të mëvonshme dhe do të miratohen në pajtim me procedurën e përcaktuar në Nenin 11 të Marrëveshjes.

NENI 2

Marrëveshjet e referuara në Nenin 1 të këtij Protokolli do të zbatohen për:

(1) verërat në kuadër të kreut 22.04 të Sistemit të Harmonizuar të Konventës Ndërkombëtare mbi Përshkrimin e Harmonizuar të Mallrave dhe Sistemit të Kodimit¹ (këtu e tutje të referuar si "Sistemi i Harmonizuar"), nënshkruar në Bruksel më 14 qershor 1983, të cilat janë prodhuar nga rrushi i freskët, të cilat:

(a) kanë origjinë nga BE-ja dhe janë prodhuar në përputhje me rregullat që rregullojnë praktikën dhe proceset enologjike të referuara në Rregulloren (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për themelimin e një organizate të përbashkët të tregjeve për produktet bujqësore², në veçanti rregullat e prodhimit në sektorin e verës, në përputhje me Nenet 75, 80, 81, 83 dhe 91 dhe shtojcës VIII, Pjesës I dhe II dhe Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 606/2009³ dhe Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 607/2009⁴, në veçanti Neneve 7, 57, 58, 64 dhe 66 dhe Shtojcave XIII, XIV dhe XVI të asaj Rregullore;

¹ OJ EU L 198, 20.7.1987, f. 3.

² Rregullorja (BE) Nr. 1308/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për themelimin e një organizate të përbashkët të tregjeve për produktet bujqësore dhe shfuqizimi i Rregulloreve të Këshillit (EEC) Nr. 922/72, (EEC) Nr. 234/79, (KE) Nr. 1037/2001 dhe (KE) Nr. 1234/2007 (OJ EU L 347, 20.12.2013, f. 671).

³ Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 606/2009 e datës 14 korrik 2009 që përcakton rregulla të caktuara të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 479/2008 sa i përket kategorive të produkteve nga rrushi, praktikën enologjike dhe kufizimet e aplikueshme (OJ EU L 193, 24.7.2009, f. 1).

⁴ Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 607/2009 e datës 14 korrik 2009 që përcakton rregulla të caktuara të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 479/2008 sa i përket emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografike, kushtet tradicionale, etiketimin dhe prezantimin e produkteve të caktuara në sektorin e verës (OJ EU L 193, 24.7.2009, f. 60).

ose

- (b) kanë origjinën në Kosovë dhe janë prodhuar në përputhje me rregullat që rregullojnë praktikat dhe proceset enologjike, në përputhje me ligjin e Kosovës. Këto rregulla rregullojnë praktikat dhe proceset enologjike dhe duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së.
- (2) pijet alkoolike në kuadër të kreut 22.08 të Sistemit të Harmonizuar të cilat:
- (a) kanë origjinën në BE dhe janë në përputhje me Rregulloren (KE) 110/2008¹, dhe Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 716/2013²;

ose

- (b) kanë origjinën në Kosovë, dhe janë prodhuar në përputhje me ligjin e Kosovës, të cilat do të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

¹ Rregullorja (KE) Nr. 110/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 janar 2008 mbi përkufizimin, përshkrimin, prezantimin, etiketimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografike të pijeve alkoolike dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 1576/89 (OJ EU L 39, 13.2.2008, f. 16).

² Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) Nr. 716/2013 e datës 25 korrik 2013 që parashtron rregullat për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 110/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi përkufizimin, përshkrimin, prezantimin, etiketimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografikë të pijeve alkoolike (OJ EU L 201, 26.7.2013, f. 21).

- (3) verërat e aromatizuara në kuadër të kreut 22.05 të Sistemit të Harmonizuar, që:
- (a) kanë origjinën në BE dhe janë në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 251/2014¹;
- ose
- (b) kanë origjinën në Kosovë, dhe janë prodhuar në përputhje me ligjin e Kosovës, të cilat do të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

¹ Rregullorja (BE) Nr. 251/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 mbi përkufizimin, përshkrimin, prezantimin, etiketimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografik të produkteve të verërave të aromatizuara dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 1601/91 (OJ EU L 84, 20.3.2014, f. 14).

SHTOJCA I E PROTOKOLLIT II

MARRËVESHJA MBI KONCESIONET RECIPROKE PREFERENCIALE TREGTARE PËR VERËRAT E CAKTUARA

1. Importet e verërave të mëposhtme në BE të referuara në Nenin 2 të këtij Protokollit do të jenë subjekt i koncesioneve të përcaktuar më poshtë:

Kodi NK	Përshkrimi (në përputhje me Nenin 2(1)(b) të këtij Protokollit)	tarifa e aplikueshme	sasitë (hl)
ex 2204 21 ex 2204 29	Verë nga rrushi i freskët	përrjashtim	40 000
ex 2204 10 ex 2204 21	Verërat cilësore me gaz Verë nga rrushi i freskët	përrjashtim	10 000

2. BE-ja do të cakton një tarifë preferenciale në vlerë zero për kuotat tarifore të përcaktuara në pikën 1, me kusht që të mos paguhet asnjë subvencion për eksportet e këtyre sasive nga ana e Kosovës.

3. Importet në Kosovë të verërave të mëposhtme të referuara në Nenin 2 të këtij Protokollit i nënshtrohen koncesioneve të përcaktuara më poshtë:
- (i) Tarifa bazë mbi të cilin do të zbatohen reduktimet tarifore të mëvonshme të përcaktuara në këtë pikë, do të jetë tarifa bazë prej 10% e aplikuar në Kosovë që nga data 31 dhjetor 2013. Normat tarifore do të reduktohen dhe eliminohen si vijon për secilin produkt të listuar nën këtë pikë:
- (a) Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 90% të tarifës baze, d.m.th 9%;
 - (b) në datën 1 janar të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 80% të tarifës baze, d.m.th 8%;
 - (c) në datën 1 janar të vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 70% të tarifës baze, d.m.th 7%;
 - (d) në datën 1 janar të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 50% të tarifës baze, d.m.th 5%;
 - (e) në datën 1 janar të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 30% të tarifës baze, d.m.th 3%;
 - (f) në datën 1 janar të vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 10% të tarifës baze, d.m.th 1%;
 - (g) në datën 1 janar të vitit të gjashtë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifat e mbetura të importit do të hiqen.

Kodi NK	Përshkrimi
22042109	Të tjera
22042111	Alsace
22042112	Bordeaux
22042113	Bourgogne (Burgundy)
22042124	Lazio (Latium)
22042126	Toscana (Tuscany)

Kodi NK	Përshkrimi
22042127	Trentino, Alto Adige dhe Friuli
22042138	Të tjera
22042142	Bordeaux
22042143	Bourgogne (Burgundy)
22042146	Côtes-du-Rhône
22042147	Languedoc-Roussillon
22042162	Piemonte (Piedmont)
22042166	Toscana (Tuscany)
22042176	Rioja
22042178	Të tjera
22042179	Të bardha
22042180	Të tjera
22042181	Të bardha
22042182	Të tjera
22042183	Të bardha
22042184	Të tjera
22042189	Port
22042191	Të tjera
22042194	Të tjera
22042195	Të bardha
22042196	Të tjera
22042197	Të bardha
22042198	Të tjera
22042910	Verë, ndryshe nga se ato të referuara në nën-kreun 2204 10, në shishe me tapë "kërpudhë" që lidhet me mbërthyesë ose me tela; verë ndryshe e vendosur, me një presion të tepërt për shkak të dyoksidit të karbonit në tretësirë jo më pak se 1 bar por më pak se 3 bar, matur në një temperaturë prej 20°C

- (ii) Tarifa bazë mbi të cilin do të zbatohen reduktimet tarifore të mëvonshme të përcaktuara në këtë pikë, do të jetë tarifa bazë prej 10% e aplikuar në Kosovë që nga data 31 dhjetor 2013. Normat tarifore do të reduktohen dhe eliminohen si vijon për secilin produkt të listuar nën këtë pikë:
- (a) Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 80% të tarifës baze, d.m.th 8%;
 - (b) në datën 1 janar të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 60% të tarifës baze, d.m.th 6%;
 - (c) në datën 1 janar të vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 40% të tarifës baze, d.m.th 4%;
 - (d) në datën 1 janar të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifa e importit do të reduktohet në masën 20% të tarifës baze, d.m.th 2%;
 - (e) në datën 1 janar të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, tarifat e mbetura të importit do të anulohen.

Kodi NK	Përshkrimi
22041011	Shampanjë
22041091	Asti spumante
22041093	Të tjera
22041094	Me tregues gjeografik të mbrojtur (PGI)
22041096	Varietete tjera të verërave
22041098	Të tjera

Kodi NK	Përshkrimi
22042107	Me tregues gjeografik të mbrojtur (PGI)
22042117	Val de Loire (Loire Valley)
22042118	Mosel
22042119	Pfalz
22042122	Rhein Hessen
22042123	Tokaj
22042128	Veneto
22042132	Vinho Verde
22042134	Penedés
22042136	Rioja
22042137	Valencia
22042168	Veneto
22042177	Valdepeñas
22042185	Madeira dhe Setubal muscatel
22042186	Sherry
22042187	Marsala
22042188	Samos dhe Muscat de Lemnos
22042190	Të tjera
22042192	Të një force aktuale alkoolike ndaj volumit më tepër se 22 % vol
22042193	Të bardha
22043010	Në fermentim apo me fermentim të penguar ndryshe nga shtesa e alkoolit
22043098	Të tjera

(iii) Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, tarifat do të jenë të vendosura në vlerë zero për importet në Kosovë të verërave me origjinë nga BE-ja, të listuara në vazhdim.

Kodi NK	Përshkrimi
22042144	Beaujolais
22042148	Val de Loire (Loire Valley)
22042167	Trentino dhe Alto Adige
22042169	Dão, Bairrada and Douro
22042171	Navarra
22042174	Penedés
22042911	Tokaj
22042912	Bordeaux
22042913	Bourgogne (Burgundy)
22042917	Val de Loire (Loire Valley)
22042918	Të tjera
22042942	Bordeaux
22042943	Bourgogne (Burgundy)
22042944	Beaujolais
22042946	Côtes-du-Rhône
22042947	Languedoc-Roussillon
22042948	Val de Loire (Loire Valley)
22042958	Të tjera
22042979	Të bardha
22042980	Të tjera
22042981	Të bardha
22042982	Të tjera
22042983	Të bardha
22042984	Të tjera

Kodi NK	Përshkrimi
22042985	Madeira and Setubal muscatel
22042986	Sherry
22042987	Marsala
22042988	Samos dhe Muscat de Lemnos
22042989	Port
22042990	Të tjera
22042991	Të tjera
22042992	I një force aktuale alkoolike ndaj volumit që tejkalon 22% vol
22042993	Të bardha
22042994	Të tjera
22042995	Të bardha
22042996	Të tjera
22042997	Të bardha
22042998	Të tjera
22043092	Të koncentruar
22043094	Të tjera
22043096	Të koncentruar

4. Kosova duhet t'i jap trajtim të privilegjuar me tarife zero siç përcaktohet në pikën 3, me kusht që të mos paguhen subvencione të eksportit për eksporte nga ana e BE-së.
5. Rregullat e origjinës të zbatueshme sipas kësaj Marrëveshje do të jene siç janë përcaktuar në Protokollin III.

6. Importet e verës sipas koncesioneve të parashikuara në këtë Marrëveshje do t'i nënshtrohen paraqitjes së një certifikate dhe një dokumenti përcjellës në përputhje me Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 436/2009¹ dhe Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 555/2008² se vera në fjalë është në pajtueshmëri me Nenin 2 (1) të këtij Protokolli. Certifikata dhe dokumenti përcjellës duhet të lëshohet nga një organ zyrtar i pranuar reciprokisht që shfaqet në listat e hartuara bashkërisht.
7. Palët do të shqyrtojnë mundësitë për t'i akorduar njëri-tjetrit koncesione të mëtejshme duke marrë parasysh zhvillimin e tregtisë së verërave mes Palëve jo më vonë se tri vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.
8. Palët sigurojnë që përfitimet e akorduara reciprokisht nuk vihen në dyshim nga masat tjera.
9. Konsultimet do të mbahen me kërkesë të secilës Palë për çdo problem që lidhet me mënyrën se si aplikohet kjo Marrëveshje.

¹ Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 436/2009 e datës 26 maj 2009 përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 479/2008 sa i përket regjistrat të vreshtave, deklarimeve të detyrueshme dhe grumbullimin e informacionit për të monitoruar tregun e verës, duhet të ruhen dokumentet përcjellëse të dërgesave të produkteve të verës si dhe regjistrat e sektorit të verës (OJ EU L 128, 27.5.2009, f. 15).

² Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 555/2008 e datës 27 qershor 2008 përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 479/2008 mbi organizimin e përbashkët të tregut të verës sa i përket programeve mbështetëse, tregtisë me vendet e treta, potencialit të prodhimit dhe kontrolleve në sektorin e verës (OJ EU L 170, 30.6.2008, f. 1).

SHTOJCA II E PROTOKOLLIT II

MARËVESHJE MBI NJOHJEN, MBROJTJEN DHE KONTROLLIN RECIPROK TË EMRAVE TË VERËRAVE, PIJEVE ALKOOLIKE DHE VERËRAVE TË AROMATIZUARA

NENI 1

Objektivat

1. Palët, në baza të mos-diskriminimit dhe reciprocitetit, do të njohin, mbrojnë dhe kontrollojnë emrat e produkteve të referuara në Nenin 2 të këtij Protokollit në përputhje me kushtet e parapara në këtë Shtojcë.
2. Palët do të marrin të gjitha masat e nevojshme të përgjithshme dhe specifike për të siguruar që detyrimet e përcaktuara nga kjo Shtojcë të jenë përmbushur dhe të arrihen objektivat e vendosura në këtë Shtojcë.

NENI 2

Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Marrëveshje dhe përveç rasteve kur shprehimisht parashihet ndryshe:

- (1) kur përdoret termi "me origjinë" në lidhje me emrin e një Pale, do të thotë se:
 - një verë është prodhuar tërësisht nga Pala në fjalë vetëm nga rrushi që është vjelë në tërësi nga ajo Palë,
 - një pije alkoolike apo verë e aromatizuar e prodhuar nga ajo Palë;
- (2) "treguesi gjeografik" i listuar në Shtojcën 1 do të thotë një tregues siç përcaktohet në Nenin 22 (1) të Marrëveshjes mbi Aspektet e Ndërlidhura me Tregtinë e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (këtu e tutje e referuar si "Marrëveshja TRIPS");
- (3) "termi tradicional" është një term i përdorur tradicionalisht, siç specifikohet në Shtojcën 2, duke iu referuar në veçanti metodës së vjetër apo të prodhimit ose të cilësisë, ngjyrës, llojit ose vendit apo një ngjarjeje të veçantë që lidhet me historinë e verës në fjalë dhe e njohur nga ligjet dhe rregulloret e një Pale, me qëllim të përshkrimit dhe paraqitjes së verës së tillë me origjinë nga territori i asaj Pale;
- (4) "homonim" do të thotë tregues i njëjtë gjeografik ose term i njëjtë tradicional, ose një term i tillë aq i ngjashëm sa që ka të ngjarë të shkaktojë konfuzion, për të treguar vende të ndryshme, procedura apo gjëra të ndryshme;

- (5) "përshkrimi" nënkupton termat e përdorur në etiketim, prezantim dhe paketim në dokumentet që shoqërojnë transportin e një pije; në dokumentet tregtare, veçanërisht në fatura dhe fletë pranime, dhe në reklamat e saj;
- (6) "etiketimi" nënkupton të gjitha përshkrimet dhe referencat tjera, shenjat, dizajnët, treguesit gjeografikë apo markat tregtare që dallojnë verërat, pijet alkoolike apo verërat e aromatizuara dhe të cilat shfaqen në të njëjtin kontejner, duke përfshirë emblemën e vulosjes apo etiketën e ngjitur në kontejner dhe mbështjellësin që mbulon qafën e shisheve;
- (7) "prezantimi" nënkupton tërësinë e termave, aluzioneve dhe referimeve të ngjashme për një verë, pije alkoolike ose vere të aromatizuar që përdoret në etiketim, në paketimin; në kontejner, mbyllje, në reklama dhe/ose promovimin e shitjeve të çdo lloji;
- (8) "paketimi" nënkupton mbështjellësin mbrojtëse, siç janë letrat, zarfet e të gjitha llojeve, kartonët dhe kutitë, të përdorura në transport dhe /ose për shitjen e një ose më shumë kontejnerëve;
- (9) "prodhimi" nënkupton gjithë procesin e prodhimit të verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara;
- (10) "verë" nënkupton vetëm pijen që rezulton nga fermentimi i plotë ose i pjesshëm i rushit të freskët të varieteteve të vreshtave, të referuara në këtë Marrëveshje nëse janë apo jo të shtypura, ose nga mushti i saj;
- (11) "variete të rushit për verëra" nënkupton varietetin e bimëve të llojit *Vitis Vinifera* pa cenuar ndonjë legjislacion që mund të ketë një Palë në lidhje me përdorimin e varieteteve të ndryshme të verërave për verërat e prodhuara në atë Palë;
- (12) "Marrëveshja e OBT-së" nënkupton Marrëveshjen e Marrakeshit që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë të nënshkruar më 15 prill 1994.

NENI 3

Rregullat e përgjithshme të importit dhe marketingut

Përveç rasteve kur kjo Marrëveshje parasheh ndryshe, importimi dhe marketingu i produkteve të referuara në Nenin 2 do të bëhet në përputhje me ligjet dhe rregulloret që zbatohen në territorin e Palës.

titulli i

MBROJTJA RECIPROKE E EMRAVE TË VERËRAVE, PIJEVE ALKOOLIKE DHE VERËRAVE TË AROMATIZUARA

NENI 4

Emrat e mbrojtur

Pa cenuar Nenet 5,6 dhe 7, do të mbrohen të poshtëshënuarat:

- (a) për sa i përket produkteve të referuara në Nenin 2:
- referenca për emrin e Shtetit Anëtar nga ku kanë origjinën verërat, pijet alkoolike apo verërat e aromatizuara apo emra tjerë për të treguar Shtetin Anëtar,
 - treguesit gjeografikë, të renditur në Shtojcën I, Pjesën A, pikat (a) për verëra, (b) për pijet alkoolike dhe (c) për verërat e aromatizuara,
 - termat tradicional të renditur në Shtojcën 2, Pjesën A;
- (b) për sa i përket verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara me origjinë në Kosovë, duhet të krijohen treguesit gjeografik në përputhje me Nenin 11(4)(a)

NENI 5

Mbrojtja e emrave që i referohen Shteteve Anëtare dhe Kosovës

1. Në Kosovë, referencat për Shtetet Anëtare, dhe emrat tjerë të përdorur për të treguar Shtetin Anëtar, me qëllim identifikimin e origjinës së verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara:

- (a) do të rezervohen për verërat, pijet alkoolike dhe verërat e aromatizuara me origjinë nga Shteti Anëtar përkatës, dhe
- (b) nuk do të përdoren nga BE-ja përveçse sipas kushteve të përcaktuara nga ligjet dhe rregulloret e BE-së.

2. Në BE, referencat për Kosovën dhe emrat tjerë të përdorur për të treguar Kosovën (pavarësisht se a përcillen me emrin e varietetit të verës) me qëllim identifikimin e origjinës së verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara:

- (a) do të rezervohen për verërat, pijet alkoolike dhe verërat e aromatizuara me origjinë në Kosovë, dhe
- (b) nuk do të përdoren nga Kosova përveçse sipas kushteve të përcaktuara nga ligjet dhe rregulloret e Kosovës.

NENI 6

Mbrojtja e treguesve gjeografikë

1. Në Kosovë, treguesit gjeografikë për BE-në që renditen në Shtojcën I, Pjesën A:
 - (a) do të mbrohen për verërat, pijet alkoolike dhe verërat e aromatizuara me origjinë në BE, dhe
 - (b) nuk do të përdoren përveçse sipas kushteve të përcaktuara nga ligjet dhe rregulloret e BE-së, dhe;
2. Në BE, treguesit gjeografikë për Kosovën të cilat do të krijohen dhe të renditen në Shtojcën I, Pjesën B:
 - (a) do të mbrohen për verërat, pijet alkoolike dhe verërat e aromatizuara me origjinë në Kosovë, dhe
 - (b) nuk do të përdoren përveçse sipas kushteve të përcaktuara nga ligjet dhe rregulloret e Kosovës.
3. Palët kontraktuese do të marrin të gjitha masat e nevojshme, në përputhje me këtë Marrëveshje, për mbrojtjen reciproke të emrave të referuar në Nenin 4(a), indentin e dytë, dhe 4(b), të cilët përdoren për përshkrimin, etiketimin dhe paraqitjen e verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara me origjinë në territorin e Palëve. Për këtë qëllim, çdo Palë do të përdor mjetet e duhura ligjore të referuara në Nenin 23 të Marrëveshjes TRIPS për të siguruar mbrojtjen efektive dhe për të parandaluar përdorimin e treguesve gjeografikë për identifikimin e verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara që nuk përfshihen në treguesit apo përshkrimet në fjalë.
4. Treguesit gjeografikë të përmendur në Nenin 4 do të rezervohen ekskluzivisht për produktet me origjinë në territorin e Palës për të cilin aplikohen, dhe mund të përdoren vetëm sipas kushteve të përcaktuara në ligjet dhe rregulloret e asaj Pale.

5. Treguesit gjeografik të referuar në Nenin 4 do të mbrohen nga:

(a) çdo përdorim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë tregtar i një emri të mbrojtur:

- për produktet e krahasueshme që nuk janë në përputhje me specifikimet e produktit të emrit të mbrojtur, ose
- për aq sa një përdorim i tillë shfrytëzon reputacionin e treguesit gjeografik;

(b) çdo keqpërdorim, imitim apo thirrje, edhe në qoftë se tregohet origjina e vërtetë e produktit apo shërbimit apo nëse emri i mbrojtur është përkthyer apo shoqëruar me shprehje të tilla si "stil", "tip", "metodë", "siç është prodhuar në", "imitim", "aromë", "sikur" ose të ngjashme;

(c) çdo shenjë tjetër e rreme ose mashtruese lidhur me prejardhjen, origjinën, natyrën ose cilësitë thelbësore në përshkrim, prezantim, apo etiketim të produktit përgjegjës për të përçar përshlytje të rreme rreth origjinës së tij;

(d) çdo praktike tjetër përgjegjëse për të çorientuar konsumatorin për origjinën e vërtetë të produktit.

6. Nëse treguesit gjeografikë të listuar në Shtojcën I janë homonime, çdo tregues do të mbrohet me kusht që të përdoret me mirëbesim. Palët do të vendosin bashkërisht rreth kushteve praktike të përdorimit sipas të cilave treguesit gjeografikë homonim dallohen nga njëri-tjetri, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar trajtim të barabartë të prodhuesve përkatës dhe që konsumatorët të mos çorientohen.

7. Nëse një tregues gjeografik i listuar në Shtojcën I është homonim me një tregues gjeografik të një shteti të tretë, zbatohet Neni 23(3) i Marrëveshjes TRIPS.

8. Kjo marrëveshje nuk do të cenon në asnjë mënyrë të drejtën e ndonjë personi për të përdorur, gjatë rrjedhës së tregtisë, emrin e atij personi apo emrin e paraardhësit të atij personi në biznes, përveç rastit kur ky emër përdoret në mënyrë të tillë për t'i çorientuar konsumatorët.

9. Asnjë pjese e kësaj Marrëveshje nuk e detyron njërën Palë të mbrojtë treguesin gjeografik të Palës tjetër të renditur në Shtojcën I, i cili nuk është i mbrojtur ose pushon së qenit i mbrojtur në vendin e tij të origjinës, ose që nuk përdoret me në atë vend.

10. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje, Palët nuk do të gjykojnë më të arsyeshme që emrat gjeografikë të mbrojtur, të renditur në Shtojcën I, të jenë të zakonshëm në gjuhën e përbashkët të Palëve si një emër i përbashkët për verërat, pijet alkoolike dhe verërat e aromatizuara, siç parashihet në Nenin 24(6) të Marrëveshjes TRIPS.

NENI 7

Mbrojtja e termave tradicionale

1. Në Kosovë, termat tradicional për BE-në të renditura në Shtojcën 2:

- (a) nuk do të përdoren për përshkrimin apo prezantimin e verërave me origjinë në Kosovë; dhe
- (b) nuk do të përdoren për përshkrimin apo prezantimin e verërave me origjinë në BE përveçse në lidhje me verërat e origjinës si dhe kategorinë dhe në gjuhë siç është listuar në Shtojcën II dhe sipas kushteve të parapara sipas ligjeve dhe rregulloreve të BE-së.

2. Kosova do të merr masat e nevojshme, në përputhje me këtë Marrëveshje, për mbrojtjen e termave tradicional të referuar në Nenin 4 dhe të cilat përdoren për përshkrimin dhe prezantimin e verërave me origjinë nga territori i BE-së. Për këtë qëllim, Kosova do të ofron mjetet e duhura ligjore për të siguruar një mbrojtje efektive dhe të parandaloj përdorimin e termave tradicionale për përshkrimin e verërave që nuk gëzojnë ata terma tradicional, edhe kur termat e përdorur tradicional shoqërohen me termat siç janë “lloji”, “tipi”, “stili”, “imitimi”, “metoda” apo të ngjashme.

3. Mbrojtja e një termi tradicional zbatohet vetëm:
 - (a) për gjuhën ose gjuhët që shfaqen në Shtojcën II dhe jo në përkthim; dhe
 - (b) për një kategori të produktit në lidhje me të cilin mbrohet në BE siç përcaktohet në Shtojcën 2.
4. Mbrojtja e parapare në paragrafin 3 të këtij Neni nuk cenon Nenin 4.

NENI 8

Markat tregtare

1. Zyrat përgjegjëse të Palëve do të refuzojnë regjistrimin e një marke tregtare të një verë, pije alkoolike apo verë të aromatizuar që është identike me, apo e ngjashme, ose përmban, apo përbëhet nga një referencë e një treguesi gjeografik të mbrojtur sipas Nenit 4 të Titullit 1 të kësaj Marrëveshje, nëse përdorimi i saj do të shpinte në njërën nga situatat e referuara në Nenin 6(5).
2. Zyrat përgjegjëse të Palëve do të refuzojnë regjistrimin e një marke tregtare të një verë që përmban apo përbëhet nga një term tradicional i mbrojtur sipas kësaj Marrëveshje, nëse për verën në fjalë nuk është rezervuar termi tradicional siç përcaktohet në Shtojcën 2.
3. Kosova do të miratoj masat e nevojshme për të ndryshuar të gjitha markat tregtare me qëllim që të heq të gjithë referencat për treguesit gjeografikë të BE-së të mbrojtur sipas Nenit 4 të Titullit I të kësaj marrëveshje. Të gjitha referencat e përmendura duhet të hiqen pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.

NENI 9

Eksportet

Palët do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që, atje ku verërat, pijet alkoolike dhe verërat e aromatizuara me origjinë nga njëra Palë eksportohen dhe tregtohen jashtë kësaj Pale kontraktuese, treguesit gjeografikë të mbrojtur të përmendur në Nenin 4(a), indentin e dytë, dhe 4(b) dhe në rastin e verërave, termat tradicional të kësaj Pale të referuar në Nenin 4 (a)(iii) nuk përdoren për të përshkruar dhe prezantuar këto produkte me origjinë nga Pala tjetër.

TITULLI II

ZBATIMI DHE ASISTENCA RECIPROKE NDËRMJET AUTORITETEVE KOMPETENTE DHE MENAXHIMI I MARRËVESHJES

NENI 10

Grupi Punues

1. Do të themelohet një Grup Punues që funksionon nën mbikëqyrjen e Nën-Komitetit për Bujqësi, i cili do të themelohet në përputhje me nenin 130 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës.
2. Grupi Punues do të kujdeset për funksionimin e duhur të kësaj Marrëveshje dhe do të shqyrtoj të gjitha çështjet që mund të dalin gjatë zbatimit të saj.

3. Grupi Punues mund të bëjë rekomandime, të diskutojë dhe të bëjë propozime për çdo çështje me interes reciprok në sektorin e verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara që do të kontribuonin në arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshje. Grupi Punues mblidhet me kërkesë të cilësdo Palë, qoftë në BE apo në Kosovë, në kohë, vend dhe mënyrë të vendosur bashkërisht nga Palët.

NENI 11

Detyrat e Palëve

1. Palët në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes Grupit Punues të referuar në Nenin 10 do të mbajnë kontakte për të gjitha çështjet në lidhje me zbatimin dhe funksionimin e kësaj Marrëveshje.
2. Kosova cakton Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si organin e saj përfaqësues. BE-ja cakton Drejtorinë e Përgjithshme të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Komisionit Evropian si organin e saj përfaqësues. Pala do të njofton Palën tjetër nëse ndryshon organin e saj përfaqësues.
3. Organi përfaqësues do të siguron koordinimin e veprimtarive të të gjitha organeve përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të kësaj Marrëveshje.
4. Palët do të:
 - (a) krijojnë dhe ndryshojnë me vendim të Komitetit për Stabilizim-Asociim listat e referuara në Nenin 4, dhe do të marrin parasysh çdo ndryshim të ligjeve dhe rregulloreve të Palëve;
 - (b) vendosin në mënyrë reciproke, me vendim të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, që Shtojcat e kësaj Marrëveshje duhet të ndryshohen. Shtojcat do të vlerësohen për ndryshim nga data e regjistruar në një letërkëmbim ndërmjet Palëve, ose nga data e vendimit të Grupit Punues, sipas rastit;

- (c) vendosin në mënyrë reciproke kushtet praktike të referuara në Nenin 6(6);
- (d) informojnë njëra-tjetrën për synimin për të vendosur rregullore të reja apo ndryshime të rregulloreve ekzistuese që lidhen me politikat publike, siç janë shëndeti apo mbrojtja e konsumatorit, që kanë implikime në sektorin e verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara;
- (e) njoftojnë njëra-tjetrën për çdo vendim legjislativ, administrativ dhe gjyqësor në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshje dhe informojnë njëra-tjetrën me masat e miratuara në bazë të këtyre vendimeve.

NENI 12

Aplikimi dhe funksionimi i Marrëveshjes

1. Palët caktojnë pikat kontaktuese siç është caktuar në Shtojcën 3 për të qenë përgjegjës për aplikimin dhe funksionimin e kësaj Marrëveshje.

NENI 13

Zbatimi dhe asistenca reciproke ndërmjet Palëve

1. Nëse përshkrimi, prezantimi apo etiketimi i një vere, pije alkoolike apo vere të aromatizuar është në kundërshtim me këtë Marrëveshje, atëherë Palët do të aplikojnë masat e nevojshme administrative dhe/ose do të fillojnë procedura ligjore me synimin për të luftuar konkurrencën e padrejtë apo parandalimin e përdorimit të gabuar të emrit të mbrojtur në ndonjë mënyrë tjetër.

2. Masat dhe procedurat e referuara në paragrafin 1 veçanërisht do të ndërmerren:
 - (a) kur përshkrimet apo përkthimet e përshkrimit, emrat, mbishkrimet apo ilustrimet në lidhje me verërat, pijet alkoolike apo verërat e aromatizuara, emrat e të cilave mbrohen sipas kësaj Marrëveshje përdoren në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthortë që japin informacion të rremë apo të gabuar për origjinën, karakteristikën apo cilësinë e verërave, pijeve alkoolike apo verërave të aromatizuara;
 - (b) kur përdoren kontejnerë që shpijnë në çorientim të origjinës së verës.
3. Nëse njëra nga Palët dyshon që:
 - (a) një verë, pije alkoolike apo verë e aromatizuar siç është përcaktuar në Nenin 2 të këtij Protokollit, është apo do të tregtohet në BE dhe Kosovë dhe nuk përputhet me rregullat që rregullojnë sektorin e verërave, pijeve alkoolike apo verërave të aromatizuara në BE apo në Kosovë ose me këtë Marrëveshje; dhe
 - (b) kjo mos-përputhje është me interes të veçantë për Palën tjetër dhe mund të rezultojë në marrjen e masave administrative dhe/ose iniciimin e procedurave ligjore,do të njofton menjëherë organin përfaqësues të Palës tjetër.
4. Informacioni që do të sigurohet sipas paragrafit 3, duhet të përfshij detaje të mospërputhjes me rregullat që rregullojnë sektorin e verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara të Palës dhe/ose kësaj Marrëveshje dhe do të shoqërohet me dokumente zyrtare, tregtare apo me dokumente tjera të përshtatshme, të detajuara ku përfshihet mundësia e marrjes së masave administrative apo iniciimi i procedurave ligjore, nëse është e nevojshme.

NENI 14

Konsultime

1. Palët do të konsultohen mes veti nëse njëra prej tyre mendon se pala tjetër ka dështuar në përmbushjen e një detyrimi sipas kësaj Marrëveshje.
2. Pala e cila kërkon konsultime, duhet t'i ofroj Palës tjetër të gjithë informacionin e nevojshëm për një shqyrtim të hollësishëm të çështjes në fjalë.
3. Në rastet kur ndonjë vonesë mund të rrezikojë shëndetin apo të dëmtojë efektivitetin e masave për të kontrolluar mashtrimin, mund të merren masat e duhura të përkohshme mbrojtëse, pa konsultim paraprak, me kusht që konsultimet të bëhen menjëherë pas marrjes së këtyre masave.
4. Nëse, pas konsultimeve të parapara me paragrafët 1 dhe 3, Palët nuk arrijnë marrëveshje, Pala e cila ka kërkuar konsultim ose e cila ka marrë masat e referuara në paragrafin 3 mund të marrë masat e duhura në përputhje me Nenin 136 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për të lejuar zbatimin e duhur të kësaj Marrëveshje.

TITULLI III

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 15

Transiti i sasive të vogla

1. Kjo marrëveshje nuk do të zbatohet për verërat, pijet alkoolike dhe verërat e aromatizuara, të cilat:
 - (a) kalojnë transit nëpër territorin e njërës Palë, ose
 - (b) janë me origjinë nga territori i njërës Palë dhe të cilat dërgohen në sasi të vogla ndërmjet këtyre Palëve sipas kushteve dhe në përputhje me procedurat e parapare në paragrafin II.
2. Produktet e mëposhtme që i referohen verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara do të konsiderohen të jenë sasi të vogla:
 - (a) sasi të në kontejnerë të etiketuar prej jo më shumë se 5 litrave, të pajisur me një pajisje jo të ripërdorshme për mbyllje, ku sasia totale e transportuar, qoftë apo jo e përbërë nga dërgesa individuale, nuk i tejkalon 50 litra;
 - (b)
 - (i) sasi të cilat janë të përfshira në bagazhin personal të udhëtarëve në sasi që nuk i tejkalon 30 litra;
 - (ii) sasi të cilat dërgohen në dërgesa nga një individ privat tek një tjetër, në sasi që nuk i tejkalon 30 litra;
 - (iii) sasi të cilat janë pjesë e bagazhit të individëve privatë të cilët janë duke u zhvendosur;

- (iv) sasi të cilat importohen me qëllim të eksperimenteve shkencore apo teknike, subjekt i një maksimumi prej 1 hektolitri;
- (v) sasi të cilat importohen për institucione diplomatike, konsullore apo të ngjashme si pjesë e mallrave pa doganë;
- (vi) sasi të cilat mbahen në bordin e mjeteve të transportit ndërkombëtar si furnizime ushqimore.

Rasti i përjashtimit i referuar në pikën a nuk duhet të kombinohet me një apo më shumë raste të përjashtimit, të referuara në pikën b.

NENI 16

Tregtimi i stokeve para-ekzistuese

1. Verërat, pijet alkoolike apo verërat e aromatizuara, të cilat në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje janë prodhuar, përgatitur, përshkruar dhe prezantuar në përputhje me ligjet dhe rregulloret e brendshme të Palëve, por të cilat janë të ndaluara me këtë Marrëveshje, mund të shiten deri në mbarimin e stokeve.
2. Përveç rasteve kur Palët zbatojnë dispozita me efekt të kundërt, verërat, pijet alkoolike apo verërat e aromatizuara që janë prodhuar, përgatitur, përshkruar dhe paraqitur në përputhje me këtë Marrëveshje por prodhim, përgatitja, përshkrimi dhe paraqitja e të cilave nuk përputhet me to për shkak të një ndryshimi të tyre, mund të vazhdojnë të deri në mbarimin e stokeve.

LISTA E EMRAVE TË MBROJTURA
(siç referohen në Nenet 4 dhe 6 të Shtojcës II të këtij Protokolli)

PJESA A: NË BE

(a) VERËRAT ME ORIGJINË NGA BE-ja

AUSTRI

1. Emërtimi i mbrojtur i origjinës

Wachau	PDO-AT-A0205
Weinviertel	PDO-AT-A0206
Burgenland	PDO-AT-A0207
Kremstal	PDO-AT-A0208
Kamptal	PDO-AT-A0209
Traisental	PDO-AT-A0210
Mittelburgenland	PDO-AT-A0214
Eisenberg	PDO-AT-A0215
Leithaberg	PDO-AT-A0216
Carnuntum	PDO-AT-A0217
Kärnten	PDO-AT-A0218
Neusiedlersee	PDO-AT-A0219
Neusiedlersee-Hügelland	PDO-AT-A0220
Niederösterreich	PDO-AT-A0221
Oberösterreich	PDO-AT-A0223
Salzburg	PDO-AT-A0224
Steiermark	PDO-AT-A0225
Süd-Oststeiermark	PDO-AT-A0226
Südburgenland	PDO-AT-A0227
Südsteiermark	PDO-AT-A0228

Thermenregion	PDO-AT-A0229
Tirol	PDO-AT-A0230
Vorarlberg	PDO-AT-A0231
Wagram	PDO-AT-A0233
Weststeiermark	PDO-AT-A0234
Wien	PDO-AT-A0235

2. Treguesi i mbrojtur gjeografik

Bergland	PGI-AT-A0211
Weinland	PGI-AT-A0212
Steirerland	PGI-AT-A0213

BELGIKË

1. Emërtimi i mbrojtur i origjinës

Côte de Sambre et Meuse	PDO-BE-A0009
Vin mousseux de qualité de Wallonie	PDO-BE-A0011
Crémant de Wallonie	PDO-BE-A0012
Heuvellandse wijn	PDO-BE-A1426
Vlaamse mousserende kwaliteitswijn	PDO-BE-A1430
Haspengouwse wijn	PDO-BE-A1492
Hagelandse wijn	PDO-BE-A1499

2. Treguesi i mbrojtur gjeografik

Vin de pays de jardins de Wallonie	PGI-BE-A0010
Vlaamse landwijn	PGI-BE-A1429

BULLGARI

1. Emërtimi i mbrojtur i origjinës

	Termi ekuivalent	
Сакар	Sakar	PDO-BG-A0013
Лозица	Lozitsa	PDO-BG-A0360
Върбица	Varbitsa	PDO-BG-A0370
Ново село	Novo Selo	PDO-BG-A0382
Павликени	Pavlikeni	PDO-BG-A0420
Поморие	Pomorie	PDO-BG-A0430
Асеновград	Asenovgrad	PDO-BG-A0877
Евксиноград	Evksinograd	PDO-BG-A0881
Велики Преслав	Veliki Preslav	PDO-BG-A0885
Брестник	Brestnik	PDO-BG-A0944
Хърсово	Harsovo	PDO-BG-A0946
Лясковец	Lyaskovets	PDO-BG-A0951
Драгоево	Dragoevo	PDO-BG-A0952
Враца	Vratsa	PDO-BG-A0955
Ловеч	Lovech	PDO-BG-A0956
Свищов	Svishtov	PDO-BG-A0957
Болярово	Bolyarovo	PDO-BG-A0985
Шумен	Shumen	PDO-BG-A0997
Сандански	Sandanski	PDO-BG-A1006
Славянци	Slavyantsi	PDO-BG-A1008
Сухиндол	Suhindol	PDO-BG-A1018
Хан Крум	Khan Krum	PDO-BG-A1030
Нови Пазар	Novi Pazar	PDO-BG-A1031
Варна	Varna	PDO-BG-A1032
Хасково	Haskovo	PDO-BG-A1043
Карлово	Karlovo	PDO-BG-A1044
Ивайловград	Ivaylovgrad	PDO-BG-A1047

Карнобат	Karnobat	PDO-BG-A1175
Любимец	Lyubimets	PDO-BG-A1177
Ямбол	Yambol	PDO-BG-A1179
Пазарджик	Pazardjik	PDO-BG-A1182
Септември	Septemvri	PDO-BG-A1185
Сливен	Sliven	PDO-BG-A1190
Пловдив	Plovdiv	PDO-BG-A1297
Монтана	Montana	PDO-BG-A1314
Оряховица	Oryahovitsa	PDO-BG-A1344
Видин	Vidin	PDO-BG-A1346
Южно Черноморие	Southern Black Sea Coast	PDO-BG-A1347
Шивачево	Shivachevo	PDO-BG-A1391
Черноморски район	Northern Black Sea	PDO-BG-A1392
Хисаря	Hisarya	PDO-BG-A1393
Стара Загора	Stara Zagora	PDO-BG-A1394
Русе	Ruse	PDO-BG-A1425
Търговище	Targovishte	PDO-BG-A1439
Лом	Lom	PDO-BG-A1441
Мелник	Melnik	PDO-BG-A1472
Долината на Струма	Struma valley	PDO-BG-A1473
Перушица	Perushtitsa	PDO-BG-A1474
Плевен	Pleven	PDO-BG-A1477
Стамболово	Stambolovo	PDO-BG-A1487
Сунгурларе	Sungurlare	PDO-BG-A1489
Нова Загора	Nova Zagora	PDO-BG-A1494

2. Treguesi i mbrojtur gjeografik

	Termi ekuivalent	
Дунавска равнина	Danube Plain	PGI-BG-A1538
Тракийска низина	Thracian Lowlands	PGI-BG-A1552

QIPRO

1. Emërtimi i mbrojtur i origjinës

	Termi ekuivalent	
Κουμανδάρια	Commandaria	PDO-CY-A1622
Κρασοχώρια Λεμεσού - Αφάμης	Krasohoria Lemesou - Afames	PDO-CY-A1623
Κρασοχώρια Λεμεσού - Λαόνα	Krasohoria Lemesou - Laona	PDO-CY-A1624
Βουνί Παναγιάς – Αμπελίτης	Vouni Panayia – Ambelitis	PDO-CY-A1625
Λαόνα Ακάμα	Laona Akama	PDO-CY-A1626
Πιτσιλιά	Pitsilia	PDO-CY-A1627
Κρασοχώρια Λεμεσού	Krasohoria Lemesou	PDO-CY-A1628

2. Treguesi i mbrojtur gjeografik

	Termi ekuivalent	
Πάφος	Pafos	PGI-CY-A1618
Λεμεσός	Lemosos	PGI-CY-A1619
Λάρνακα	Larnaka	PGI-CY-A1620
Λευκωσία	Lefkosia	PGI-CY-A1621

REPUBLIKA ÇEKE

1. Emërtimi i mbrojtur i origjinës

Čechy	PDO-CZ-A0888
Slovácká	PDO-CZ-A0890
Znojemská	PDO-CZ-A0892
Litoměřická	PDO-CZ-A0894
Mělnická	PDO-CZ-A0895
Velkopavlovická	PDO-CZ-A0896
Mikulovská	PDO-CZ-A0897
Morava	PDO-CZ-A0899
Znojmo	PDO-CZ-A1086
Šobeské víno	PDO-CZ-A1089
Šobes	PDO-CZ-A1089
Novosedelské Slámové víno	PDO-CZ-A1321

2. Treguesi i mbrojtur gjeografik

české	PGI-CZ-A0900
moravské	PGI-CZ-A0902

GJERMANI

1. Emërtimi i mbrojtur i origjinës

Ahr	PDO-DE-A0867
Baden	PDO-DE-A1264
Franken	PDO-DE-A1267
Hessische Bergstraße	PDO-DE-A1268
Mittelrhein	PDO-DE-A1269
Mosel	PDO-DE-A1270
Nahe	PDO-DE-A1271
Pfalz	PDO-DE-A1272
Rheingau	PDO-DE-A1273
Rheinhessen	PDO-DE-A1274
Saale-Unstrut	PDO-DE-A1275
Württemberg	PDO-DE-A1276
Sachsen	PDO-DE-A1277

2. Treguesi i mbrojtur gjeografik

Ahrtaler Landwein	PGI-DE-A1278
Badischer Landwein	PGI-DE-A1279
Bayerischer Bodensee-Landwein	PGI-DE-A1280
Brandenburger Landwein	PGI-DE-A1281
Landwein Main	PGI-DE-A1282
Landwein der Mosel	PGI-DE-A1283
Landwein Neckar	PGI-DE-A1284
Landwein Oberrhein	PGI-DE-A1285
Landwein Rhein	PGI-DE-A1286
mlado vino	Të gjitha	Verë cilësore psr	Slllovene
Cviček	Dolenjska	Verë cilësore psr	Slllovene
Teran	Kras	Verë cilësore psr	Slllovene

Termit tradicional	Verërat përkatëse	Kategoria e verës	Gjuha
SLLOVAKIA			
forditáš	Tokaj / -ská / -ský / -ské	Verë cilësore psr	Slllovakë
mášláš	Tokaj / -ská / -ský / -ské	Verë cilësore psr	Slllovakë
samorodné	Tokaj / -ská / -ský / -ské	Verë cilësore psr	Slllovakë
výber ... putňový, (the space marked by the dots is to be completed by the numbers 3-6)	Tokaj / -ská / -ský / -ské	Verë cilësore psr	Slllovakë
výberová esencia	Tokaj / -ská / -ský / -ské	Verë cilësore psr	Slllovakë
esencia	Tokaj / -ská / -ský / -ské	Verë cilësore psr	Slllovakë
BULLGARIA			
Гарантирано наименование за произход (ГНП) (guaranteed appellation of origin)	Të gjitha	Verë cilësore psr, verë cilësorë me gaz psr, verë cilësore gjysmë e gazuar psr, verë cilësore likerë psr	Bullgare
Гарантирано и контролирано наименование за произход (ГКНП) (guaranteed and controlled appellation of origin)	Të gjitha	Verë cilësore psr, verë cilësorë me gaz psr, verë cilësore gjysmë e gazuar psr, verë cilësore likerë psr	Bullgare

Terminat tradicional	Verërat përkatëse	Kategoria e verës	Gjuha
Благородно сладко вино (БСВ) (noble sweet wine)	Të gjitha	Verë cilësore likerit psr	Bullgare
регионално вино (Regional wine)	Të gjitha	Verë tavoline me GI	Bullgare
Ново (young)	Të gjitha	Verë cilësore psr Verë tavoline me GI	Bullgare
Премиум (premium)	Të gjitha	Verë tavoline me GI	Bullgare
Резерва (reserve)	Të gjitha	Verë cilësore psr Verë tavoline me GI	Bullgare
Премиум резерва (premium reserve)	Të gjitha	Verë tavoline me GI	Bullgare
Специална резерва (special reserve)	Të gjitha	Verë cilësore psr	Bullgare
Специална селекција (special selection)	Të gjitha	Verë cilësore psr	Bullgare
Колекционно (collection)	Të gjitha	Verë cilësore psr	Bullgare

Termat tradicional	Verërat përkatëse	Kategoria e verës	Gjuha
Премиум оук, или първо зареждане в бъчва (premium oak)	Të gjitha	Verë cilësore psr	Bullgare
Беритба на презряло грозде (vintage of over ripe grapes)	Të gjitha	Verë cilësore psr	Bullgare
Розенталер (Rosenthaler)	Të gjitha	Verë cilësore psr	Bullgare
RUMANIA			
Vin cu denumire de origine controlată (D.O.C.)	Të gjitha	Verë cilësore psr	Rumune
Cules la maturitate deplină (C.M.D.)	Të gjitha	Verë cilësore psr	Rumune
Cules târziu (C.T.)	Të gjitha	Verë cilësore psr	Rumune
Cules la înnobilarea boabelor (C.I.B.)	Të gjitha	Verë cilësore psr	Rumune
Vin cu indicație geografică	Të gjitha	Verë tavoline me GI	Rumune
Rezervă	Të gjitha	Verë cilësore psr	Rumune
Vin de vinotecă	Të gjitha	Verë cilësore psr	Rumune

LISTA E PIKAVE KONTAKTUESE
Siç referohet në Nenin 12 të Shtojcës II të këtij Protokoll

(a) Kosova

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Departamenti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë
Drejtori i departamentit të vreshtarisë dhe verëtarisë
Prishtinë,
Kosovë
Telefoni: +38138211834
E-mail: mbpzhr@rks-gov.net

(b) BE

Komisioni Evropian
Drejtorja e Përgjithshme (DG) për Bujqësi dhe Zhvillimi Rural
Drejtorja A Marrëdhëniet Ndërkombëtare Bilaterale
Udhëheqës i Njësitit A.4 Politikat e Fqinjësisë, EEA, EFTA dhe Zgjerimit
B-1049, Bruksel
Belgjikë
Telefoni: + 32 2 299 11 11 Faks: + 32 2 296 62 92
E-mail: AGRI-EC-KOSOVO-WINE-TRADE@ec.europa.eu

PROTOKOLLI III
NË LIDHJE ME
KONCEPTIN E “ORIGINËS SË PRODUKTEVE”

NENI 1

Rregullat e zbatueshme të origjinës

Me qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshje, do të aplikohen Shtojca I dhe dispozitat përkatëse të Shtojcës II të Konventës Rajonale mbi rregullat preferenciale pan-Euro-Mesdhetare të origjinës ¹ (këtu e tutje të referuara si “Konventa Rajonale”).

Të gjitha referencat për "marrëveshjen përkatëse" në Shtojcën I të Konventës Rajonale dhe në dispozitat përkatëse të Shtojcës II të Konventës Rajonale do të interpretohen siç parashihet në këtë Marrëveshje.

NENI 2

Kumulimi

Pavarësisht Neneve 16 (5) dhe 21 (3) të Shtojcës I të Konventës Rajonale, ku kumulimi përfshin vetëm shtetet e EFTA-së, Ishujt Faroe, BE-në, Turqinë dhe pjesëmarrësit në PSA, dëshmi e origjinës mund të jetë certifikata e qarkullimit EUR.1 ose një deklaratë e origjinës.

¹ OJ EU L 54, 26.2.2013, f. 4.

NENI 3

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kur lindin mosmarrëveshje lidhur me procedurat e verifikimit nga Neni 32 i Shtojcës I të Konventës Rajonale, të cilat nuk mund të zgjidhen midis autoriteteve doganore që kërkojnë verifikim dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, atëherë ato do të dërgohen tek KSA-ja.

Në të gjitha rastet, zgjidhjet e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesve dhe autoriteteve doganore të vendit të importit do të bëhen në bazë të legjislacionit të autoriteteve doganore të vendit.

NENI 4

Ndryshimet në Protokoll

KSA-ja mund të vendosë të ndryshojë këtë Protokoll.

NENI 5

Tërheqja nga Konventa Rajonale

1. Në qofte se BE-ja apo Kosova dorëzojnë njoftimin me shkrim tek organet e Konventës Rajonale për tërheqjen e tyre nga Konventa Rajonale, në pajtim me nenin 9, BE-ja dhe Kosova menjëherë do të hyjnë në negociata për rregullat e origjinës me qëllim të zbatimit të Marrëveshjes.
2. Deri në nisjen e zbatimit të rregullave të tilla të origjinës të cilat rishtazi janë negociuar, do të vazhdojnë të aplikohen rregullat e origjinës të përfshira në Shtojcën I të Konventës Rajonale dhe, ku është e përshtatshme, dispozitat përkatëse të Shtojcës II të Konventës Rajonale, të zbatueshme në momentin e tërheqjes, për këtë Marrëveshje. Megjithatë, që nga momenti i tërheqjes, rregullat e origjinës të përfshira në Shtojcën I të Konventës Rajonale dhe, ku është e përshtatshme, dispozitat përkatëse të Shtojcës II të Konventës Rajonale do të interpretohet ashtu që të lejojnë kumulimin bilateral vetëm midis BE-së dhe Kosovës.

PROTOKOLLI IV

MBI ASISTENCËN RECIPROKE ADMINISTRATIVE
NË ÇËSHTJET DOGANORE

NENI 1

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij Protokollit:

- (a) "legjislacioni doganor" nënkupton çdo dispozitë ligjore ose rregullative të zbatueshme në territoret e Palëve, që rregullon importin, eksportin dhe transitin e mallrave dhe vendosjen e tyre nën çdo regjim ose procedurë tjetër doganore, duke përfshirë masat e ndalimit, kufizimit dhe kontrollit;
- (b) "autoriteti aplikues" nënkupton autoritetin kompetent administrativ i cili është caktuar nga Pala për këtë qëllim dhe i cili bën kërkesë për asistencë në bazë të këtij Protokollit;
- (c) "autoriteti i kërkuar" nënkupton një autoritet kompetent administrativ i cili është caktuar nga Pala për këtë qëllim dhe i cili pranon kërkesën për asistencë në bazë të këtij Protokollit;
- (d) "të dhënat personale" nënkuptojnë të gjitha informatat në lidhje me një individ të identifikuar apo të identifikueshëm;
- (e) "veprim shkelës i legjislacionit doganor" nënkupton çdo shkelje apo tentim për shkelje të legjislacionit doganor.

NENI 2

Fushëveprimi

1. Palët do t'i ndihmojnë njëra-tjetrën, në fusha brenda kompetencave të tyre, sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara në këtë Protokoll për të siguruar zbatimin e drejtë të legjislacionit doganor, veçanërisht duke parandaluar, hetuar dhe luftuar veprimet shkelëse të atij legjislacion.
2. Asistenca për çështjet doganore, siç parashihet me këtë Protokoll, do të zbatohet për çdo autoritet administrativ të Palëve i cili është kompetent për zbatimin e këtij Protokolli. Kjo nuk do të paragjykojë rregullat që administrojnë asistencën reciproke në çështjet penale. Po ashtu nuk do të mbulojë informacionin e fituar nën ushtrimin e kompetencave me kërkesë të autoritetit gjyqësor, përveçse kur komunikimi i këtij informacioni është i autorizuar nga ai autoritet.
3. Asistenca për të rikthyer tarifatat, taksat ose gjobat nuk mbulohet nga ky Protokoll.

NENI 3

Asistenca sipas kërkesës

1. Me kërkesë të autoritetit aplikues, autoriteti i kërkuar do t'i ofrojë atij të gjithë informacionin përkatës i cili mund t'i ndihmoj atij që të sigurohet se legjislacioni doganor është duke u zbatuar drejtë, duke përfshirë informacion në lidhje me aktivitetet e vërejtura ose të planifikuara që janë ose mund të jenë veprime shkelëse të legjislacionit doganor.

2. Me kërkesë të autoritetit aplikues, autoriteti i kërkuar do të informojë atë:
 - (a) nëse mallrat e eksportuara nga territori i njëjës Palë janë importuar në mënyre të duhur në territorin e Palës tjetër, duke specifikuar, sipas nevojës procedurën doganore të zbatuar për mallra;

 - (b) nëse mallrat e importuara në territorin e njëjës Palë janë eksportuar në mënyre të duhur në territorin e Palës tjetër, duke specifikuar, sipas nevojës procedurën doganore të zbatuar për mallra.

3. Me kërkesë të autoritetit aplikues, autoriteti i kërkuar, brenda kornizës së dispozitave të tij ligjore ose rregullative, do të marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar mbikëqyrje speciale të:

- (a) personave fizik ose juridik në lidhje me të cilët ka arsye të besohet se janë ose kanë qenë të përfshirë në veprime shkelëse të legjislacionit doganor;
- (b) vendeve ku stoqet e mallrave kanë qenë ose mund të montohen në mënyrë të tillë që ka arsye të besohet se këto mallra synohen të përdoren për veprime që shkelin legjislacionin doganor;
- (c) mallrave që janë apo mund të transportohen në mënyrë të tilla ku ka arsye të besohet se synohet të përdoren për veprime që shkelin legjislacionin doganor;
- (d) mjeteve transportuese që përdoren ose mund të përdoren në mënyrë të tillë që ka arsye të besohet se synohen të përdoren për veprime që shkelin legjislacionin doganor.

NENI 4

Asistenca e paparashikuar

Palët do të asistojnë njëra tjetrën, me iniciativën e tyre dhe në përputhje me dispozitat e tyre ligjore ose rregullative, nëse e konsiderojnë asistencën e tillë të nevojshme për zbatimin e drejtë të legjislacionit doganor, veçanërisht duke siguruar informacion e ftuar në lidhje me:

- (a) aktivitetet që janë ose kanë të ngjarë të jenë veprime shkelëse të legjislacionit doganor, dhe që mund të jene me interes për Palën tjetër;
- (b) mjetet ose metodat e reja të përdorura për kryerjen e veprimeve shkelëse të legjislacionit doganor
- (c) mallrat e njohura që janë subjekt i veprimeve shkelëse të legjislacionit doganor;
- (d) personat fizik ose juridik në lidhje me të cilët ka arsye të besohet se janë ose kanë qenë të përfshirë në veprime shkelëse të legjislacionit doganor;
- (e) mjetet e transportit në lidhje me të cilat ka arsye të besohet se kanë qenë, janë ose mund të përdoren për veprime shkelëse të legjislacionit doganor.

NENI 5

Dorëzimi, Njoftimi

Me kërkesë të autoritetit aplikues, autoriteti i kërkuar, në përputhje me dispozitat ligjore ose rregullative të zbatueshme për këtë të fundit, do të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që:

- (a) të dorëzojë çdo dokument ose
- (b) të njoftojë për çfarëdo vendimi,

që buron nga autoriteti kërkues dhe që hyn brenda fushëveprimit të këtij Protokolli, ndaj një të adresuari që banon apo është i vendosur në territorin e autoritetit të kërkuar.

Kërkesat për dorëzimin e dokumenteve ose njoftimin e vendimeve do të bëhen me shkrim në një gjuhë zyrtare të autoritetit të kërkuar ose në një gjuhë të pranueshme për atë autoritet.

NENI 6

Forma dhe përmbajtja e kërkesave për asistencë

1. Kërkesat, sipas këtij Protokolli, do të bëhen me shkrim. Ato do të shoqërohen me dokumentet e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me kërkesën. Kur kërkohen për shkak të urgjencës së situatës, mund të pranohen kërkesat gojore, megjithatë ato duhet të konfirmohen menjëherë me shkrim.
2. Kërkesat sipas paragrafit 1, do të përfshijnë informacionet e mëposhtme:
 - (a) autoritetin aplikues;
 - (b) masën e kërkuar;
 - (c) qëllimin dhe arsyen e kërkesës;
 - (d) dispozitat ligjore ose rregullative dhe elementet tjera ligjorë të përfshira;
 - (e) të dhëna sa më të sakta dhe të plota të mundshme në lidhje me personat fizik ose juridik të cilët janë subjekt hetimi;

(f) një përmbledhje e fakteve relevante dhe të hetimeve të kryera.

3. Kërkesat do të dorëzohen në gjuhën zyrtare të autoritetit të kërkuar ose në një gjuhë të pranueshme për atë autoritet. Kjo kërkesë nuk do të zbatohet për ndonjë dokument që e shoqëron kërkesën sipas paragrafit 1.

4. Nëse një kërkesë nuk i përmbush kërkesat formale të përcaktuara më sipër, atëherë autoriteti i kërkuar mund të kërkojë përmirësimin ose kompletimin e kërkesës. Mund të urdhërohen masa parandaluese gjatë pritje së përmirësimit apo përfundimit të tillë.

NENI 7

Ekzekutimi i kërkesave

1. Me qëllim që të përmbushet kërkesa për asistencë, autoriteti i kërkuar do të procedojë, brenda kufijve të kompetencave të tij dhe burimeve në dispozicion, sikur të ishte duke vepruar në llogarinë e tij ose me kërkesë të autoriteteve tjera të po asaj Pale, duke dhënë informacion që tashmë është në posedim, duke kryer hetimet e duhura ose duke angazhuar kryerjen e tyre. Kjo dispozitë do të zbatohet gjithashtu për çdo autoritet tjetër tek i cili është adresuar kërkesa nga autoriteti i kërkuar, kur ky i fundit nuk mund të veprojë vetë.

2. Kërkesat për asistencë do të ekzekutohen në përputhje me dispozitat ligjore ose rregullative të Palës së kërkuar.

3. Zyrtarët e autorizuar të një Pale mundën me pëlqimin e Palës tjetër të përfshihen dhe sipas kushteve të përcaktuara nga kjo e fundit, të jenë të pranishëm për të marrë informacion në zyrat e autoritetit të kërkuar ose të çdo autoriteti tjetër të interesuar në përputhje me paragrafin 1, informacionin në lidhje me aktivitetet që janë ose mund të jenë veprime që shkelin legjislacionin doganor, i cili nevojitet nga autoriteti i kërkuar për qëllime të këtij Protokollit.

4. Zyrtarët e autorizuar të një Pale të përfshirë mundën me pëlqimin e Palës tjetër të përfshihen dhe sipas kushteve të përcaktuara nga kjo e fundit, të jenë të pranishëm në hetimet e kryera në territorin e kësaj të fundit.

NENI 8

Mënyra me të cilën bëhet komunikimi i informacionit

1. Autoriteti i kërkuar do të komunikojë me shkrim rezultatet e hetimeve tek autoriteti kërkuar, së bashku me dokumentet relevante, kopjet e certifikuar ose gjërat tjera.

2. Ky informacion mund të jetë në formë elektronike.
3. Dokumentet origjinale do të transmetohen vetëm me kërkesë, në rastet kur kopjet e certifikuara do të ishin të pamjaftueshme. Këto dokumente origjinale do të kthehen në mundësinë e parë.

NENI 9

Përgjashtimet nga obligimet për ofrimin e asistencës

1. Asistenca mund të refuzohet ose mund të jetë subjekt i përmbushjes së disa kushteve ose kërkesave, në rastet kur një Palë është e mendimit se asistenca sipas këtij Protokolli, do të:
 - (a) mundësonte cenimin e politikës publike, sigurisë apo interesave tjera thelbësore, veçanërisht rastet e referuara në Nenin 10 (2); ose
 - (b) shkelte një sekret industrial, tregtar apo profesional.

2. Asistenca mund te shtyhet nga autoriteti i kërkuar me arsyetim se do te ndërhynte në një hetim, ndjekje penale apo procedure që është në vazhdim e sipër. Në këtë rast, autoriteti i kërkuar do të konsultohet me autoritetin aplikues për të vendosur nëse mund të jepet asistenca sipas këtyre kushteve ose afateve që mund të kërkohen nga autoriteti i kërkuar.
3. Kur autoriteti aplikues kërkon asistencë, të cilën do të ishte e pamundur të siguronte vetë, do të duhej të theksonte këtë fakt në kërkesën e tij. Më pas autoriteti i kërkuar do të vendosë si t'i përgjigjet kësaj kërkesë.
4. Për rastet e referuara në paragrafët 1 dhe 2, vendimi i autoritetit të kërkuar dhe arsyet përkatëse duhet t'i komunikohet pa vonesë autoritetit aplikues.

NENI 10

Shkëmbimi i informacioneve dhe konfidencialiteti

1. Çdo informacion i komunikuar në çfarëdolloj forme sipas këtij Protokolli do të jetë i një natyre konfidenciale apo i kufizuar, në varësi të rregullave të zbatueshme për secilën Palë. Kjo do të mbulohet nga obligimi i fshehtësisë zyrtare dhe do të gëzojë mbrojtjen që jepet për informacion të ngjashëm, sipas ligjeve përkatëse të Palës që e ka marrë atë.

2. Të dhënat personale mund të shkëmbehen vetëm kur Pala e cila mund ti pranojë ato ndërmerr masa për mbrojtjen e të dhënave të tilla në mënyrën që konsiderohet përkatëse nga Pala që mund t'i ofroj ato.

3. Përdorimi i informacioneve të fituara sipas këtij Protokollit, në procedurat administrative dhe të ngjashme të krijuara në lidhje me veprimet në shkelje të legjislacionit doganor, konsiderohet se bëhen për qëllime të këtij Protokollit. Prandaj Palët mundën, në regjistrat e tyre të evidencave, në raporte dhe dëshmi të tyre dhe në procedurat dhe për akuzat e paraqitura në kontekstin e procedurave administrative dhe të ndërlidhura, të përdorin si provë informacionin e përftuar dhe dokumentet e konsultuara në përputhje me dispozitat e këtij Protokollit. Autoriteti kompetent që ka dhënë këtë informacion ose ka dhënë qasje në ato dokumente do të njoftohet në lidhje me këtë përdorim.

4. Informacioni i përftuar do të përdoret vetëm për qëllime të këtij Protokollit. Kur njëra prej Palëve dëshiron të përdorë këtë informacion për qëllime të tjera, ajo do të marrë miratimin paraprak me shkrim nga autoriteti, i cili ka siguruar informacionin. Ky përdorim më pas do të jetë subjekt ndaj kufizimeve të parashtruara nga ai autoritet.

NENI 11

Ekspertët dhe dëshmitarët

Një zyrtar i një autoriteti të kërkuar mund të jetë i autorizuar të paraqitet, brenda kufijve të autorizimit të dhënë, si një ekspert ose dëshmitar në procedurat administrative apo të ndërlidhura në lidhje me çështje të mbuluara nga ky Protokoll dhe të krijojë objekte, dokumente ose kopje të certifikuara të tilla pasi që mund të nevojiten për procedura. Kërkesa për paraqitje duhet të tregojë specifikisht se tek cili autoritet duhet të paraqitet zyrtari, dhe mbi cilat çështje dhe në bazë të cilës së drejtë ose cilësi do të merret në pyetje ai zyrtar.

NENI 12

Shpenzimet e asistencës

Palët do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet ndaj njeri-tjetrit për kompensim të shpenzimeve të bëra në pajtim me këtë Protokoll, përveçse për shpenzimet e ekspertëve dhe dëshmitarëve dhe për përkthyesit dhe interpretët të cilët nuk janë punëtorë të shërbimit publik.

NENI 13

Zbatimi

1. Zbatimi i këtij Protokolli do t'i besohet nga njëra anë autoriteteve doganore të Kosovës dhe nga ana tjetër shërbimeve kompetente të Komisionit Evropian dhe autoriteteve doganore të Shteteve Anëtare, si të shihet e arsyeshme. Ata do të vendosin në lidhje me të gjitha masat dhe rregullimet praktike të nevojshme për zbatimin e saj, duke marrë në konsideratë rregullat në fuqi, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të dhënave. Ata mund t'i rekomandojnë organeve kompetente ndryshime, që konsiderojnë se duhet t'i bëhen këtij Protokolli.
2. Palët do të konsultohen me njëra tjetrën dhe më pas do të informojnë njëra tjetrën në lidhje me rregullat e detajuara të zbatimit të cilat janë miratuar në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli

NENI 14

Marrëveshjet tjera

1. Duke marrë parasysh kompetencat përkatëse të BE-së dhe të Shteteve Anëtare, ky Protokoll:
 - (a) nuk do të ndikoj në obligimet e Palëve ndaj ndonjë marrëveshje apo konvente tjetër ndërkombëtare;
 - (b) do të konsiderohet si plotësues ndaj Marrëveshjeve për asistencë reciproke, të cilat janë arritur ose mund të arrihen mes Shteteve Anëtare individuale dhe Kosovës;dhe
 - (c) nuk do të ndikoj në dispozitat e BE-së që rregullojnë komunikimin mes shërbimeve kompetente të Komisionit Evropian dhe autoriteteve doganore të Shteteve Anëtare në lidhje me çdo informacioni të përfshirë në kuadër të këtij Protokoll i cili mund të ishte me interes për BE-në.

2. Pavarësisht paragrafit 1, ky Protokoll do të ketë përparësi ndaj çfarëdo Marrëveshje bilaterale për asistencë reciproke, e cila është lidhur apo që mund të lidhet mes Shteteve Anëtare individuale dhe Kosovës, për aq sa kjo e fundit nuk është në përputhje me Protokollin.

3. Sa i përket çështjeve që lidhen me zbatueshmërinë e këtij Protokollit, Palët do të konsultohen me njëra tjetrën për ta zgjidhur çështjen në kuadër të Komitetit të Stabilizim-Asociimit të themeluar në bazë të Nenit 129 të kësaj Marrëveshje.

PROTOKOLLI V
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

KAPITULLI I

OBJEKTIVI DHE FUSHËVEPRIMI

NENI 1

Objektivi

Objektiv i këtij Protokollit është shmangia dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes Palëve, me synim të arritjes së një zgjidhje reciprokisht të pranueshme.

NENI 2

Fushëveprimi

Ky Protokoll do të aplikohet vetëm lidhur me ndonjë ndryshim që ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të mëposhtme, duke përfshirë rastet kur një Palë konsideron se një masë e miratuar nga Pala tjetër, ose dështimi i Palës tjetër për të vepruar, është në kundërshtim me obligimet e saja sipas këtyre dispozitave:

- (a) Titulli IV (Lëvizja e lirë e mallrave), përveç Neneve 35, 42, 43(1), (4) dhe (5) (përderisa këto masa janë miratuar sipas Nenit 43 (1) dhe Nenit 49;
- (b) Titulli V (Themelimi, furnizimi i shërbimeve dhe kapitali):
 - Kapitulli I Themelimi (Nenet 50 deri 54),
 - Kapitulli II Furnizimi i shërbimeve (Nenet 55, 58 dhe 59),
 - Kapitulli III Trafiku Transit (Nenet 61, 62 dhe 63),
 - Kapitulli IV Pagesat aktuale dhe lëvizja e kapitalit (Nenet 64 dhe 65),
 - Kapitulli V Dispozitat e përgjithshme (Nenet 67 deri 73);

(c) Titulli VI (Përafrimi i ligjeve, zbatimi i ligjit dhe rregullat e konkurrencës):

- Neni 78(1) (Aspektet që lidhen me tregtinë e pronës intelektuale) dhe Neni 79 (1), nënparagrafi i parë i paragrafit 2 dhe paragrafët 3 deri 5 dhe 8 (prokurimi publik).

KAPITULLI II

PROCEDURAT PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE

SEKSIONI I

PROCEDURA E ARBITRAZHIT

NENI 3

Inicimi i procedurës së arbitrazhit

1. Kur Palët nuk arrijnë të zgjedhin një mosmarrëveshje, Pala ankuese mundet sipas kushteve të Nenit 137 të kësaj Marrëveshje të paraqesë një kërkesë me shkrim për krijimin e një paneli të arbitrazhit tek Pala ankuese si dhe tek Komiteti i Stabilizim-Asociimit.
2. Pala ankuese duhet të theksojë në kërkesën e saj lëndën e mosmarrëveshjes dhe varësisht nga rasti, masën e miratuar nga Pala tjetër apo dështimin për të vepruar, që konsiderohet të jetë shkelje e dispozitave të referuara në Nenin 2.

NENI 4

Përbërja e panelit të arbitrazhit

1. Paneli i arbitrazhit do të përbëhet prej tre arbitrave.
2. Brenda dhjetë ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për krijimin e një paneli të arbitrazhit tek Komiteti i Stabilizim-Asociimit, Palët do të konsultohen në mënyrë që të arrijnë një marrëveshje për përbërjen e panelit të arbitrazhit.
3. Në rast se Palët nuk janë në gjendje të pajtohen rreth përbërjes së panelit të arbitrazhit brenda afatit kohor të referuar në paragrafin 2, secila Palë mund të kërkojë nga kryesuesi i Komitetit të Stabilizim-Asociimit, apo nga delegati i tij që të zgjedh të tre anëtarët përmes shortit nga lista e krijuar sipas Nenit 15, të zgjedhin njërin nga individët e propozuar nga pala ankuese, një nga individët e propozuar nga Pala ndaj së cilës është bërë ankesa dhe një nga arbitrat e zgjedhur nga Palët për të vepruar si kryesues.

Në rast se Palët bien dakord mbi njërin apo më shumë anëtarë të panelit të arbitrazhit, çdo anëtarë i mbetur do të emërohet sipas së njëjtës procedurë.

4. Zgjedhja e arbitrave nga ana e kryesuesit të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, apo nga i deleguari i tij, do të bëhet në prani të përfaqësuesit të secilës Palë.

5. Data e themelimit të panelit të arbitrazhit do të jetë data në të cilën kryesuesi i panelit është informuar për emërimin sipas marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Palëve të tre arbitrave ose, siç mund të jetë rasti, data e zgjedhjes së tyre në përputhje me paragrafin 3.

6. Kur një Palë konsideron se një arbitër nuk sillet në përputhje me kërkesat e Kodit të Mirësjelljes të referuara në Nenin 18, atëherë Palët do të konsultohen dhe nëse pajtohen, do të zëvendësojnë arbitrin dhe do të për zgjedhin një zëvendësim të ri në pajtim me paragrafin 7. Kur Palët nuk arrijnë të pajtohen mbi nevojën për të zëvendësuar një arbitër, atëherë çështja do t'i referohet kryesuesit të panelit të arbitrazhit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar.

Kur një Palë konsideron se kryesuesi i panelit të arbitrazhit nuk sillet në përputhje me Kodin e Mirësjelljes së referuar në Nenin 18, atëherë kjo çështje do t'i referohet njërit prej anëtarëve të mbetur të grupit të arbitrave të zgjedhur për të vepruar si kryesues, emri i të cilit do të zgjidhet me short nga kryesuesi i Komitetit të Stabilizim-Asociimit, apo nga i deleguari i tij, në prezencë të një përfaqësuesi të secilës palë, përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe.

7. Nëse një arbitër nuk ka mundësi të marrë pjesë në procedurë, tërhiqet apo zëvendësohet në përputhje me paragrafin 6, zëvendësimi do të për zgjidhet brenda pesë ditëve në përputhje me procedurat e për zgjedhjes që ndiqen për të zgjedhur arbitrin fillestar. Procedurat e panelit do të pezullohen gjatë kohës së kryerjes së kësaj procedure.

NENI 5

Vendimi i panelit të arbitrazhit

1. Paneli i arbitrazhit duhet t'i njoftojë Palët dhe Komitetin e Stabilizim-Asociimit rreth vendimit të tij brenda 90 ditëve nga data e krijimit të panelit të arbitrazhit. Kur paneli vlerëson se ky afat nuk mund të arrihet, kryesuesi i panelit duhet të njoftojë Palët dhe Komitetin e Stabilizim-Asociimit me shkrim, duke cekur arsyet e vonesës. Në asnjë rast, vendimi nuk duhet të lëshohet më vonë se 120 ditë nga data e krijimit të panelit.
2. Në raste urgjente, përfshirë ato raste të mallrave që prishen shpejtë, paneli i arbitrazhit do të bëjë çdo përpjekje për të lëshuar vendimin e tij brenda 45 ditëve nga data e krijimit të panelit. Nën asnjë rrethanë nuk duhet të marrë më shumë se 100 ditë nga data e krijimit të panelit. Paneli i arbitrazhit mund të jap një vendim preliminar brenda dhjetë ditëve nga krijimi në qofte se rasti vlerësohet të jetë urgjent.
3. Vendimi përcakton të gjeturat faktike, zbatueshmërinë e dispozitave përkatëse të kësaj Marrëveshje dhe arsyetimin themelor prapa çdo të gjeture dhe përfundimi që e bën. Vendimi mund të përmbajë rekomandime për masat që duhet të miratohen në lidhje me pajtueshmërinë me të.

4. Pala ankuese mund ta tërheqë ankesën e saj me anë të një njoftimi me shkrim tek kryesuesi i panelit të arbitrazhit, tek Pala ndaj së cilës është bërë ankesa dhe tek Komiteti i Stabilizim-Asociimit, në çdo kohë para se vendimi të ju njoftohet Palëve dhe Komitetit të Stabilizim-Asociimit. Një tërheqje e tillë nuk i cenon Palës ankuese të drejtën për të paraqitur një ankesë të re në lidhje me masën e njëjte në një kohë të mëvonshme

5. Paneli i arbitrazhit me kërkesë të të dyja palëve, do të pezullojë punën e saj në çdo kohë për një periudhë kohore që nuk tejkalon 12 muaj. Sapo të tejkalohej periudha 12 mujore, autoriteti për krijimin e panelit do të përfundoj së funksionuari, pa cenuar të drejtën e Palës ankuese për të kërkuar më vonë themelimin e një paneli rreth masës së njëjte.

SEKSIONI II

PAJTUESHMËRIA

NENI 6

Pajtueshmëria me vendimin e panelit të arbitrazhit

Secila Palë do të marrë masat e nevojshme për të qene në pajtueshmëri me vendimin e panelit të arbitrazhit dhe Palët do të përpiqen të bien dakord mbi periudhën e arsyeshme kohore për të zbatuar vendimin.

NENI 7

Periudha e arsyeshme kohore për pajtueshmëri

1. Jo më vonë se 30 ditë pas njoftimit të Palëve lidhur me vendimin e panelit të arbitrazhit, Pala ndaj së cilës është bërë ankesa do të lajmërojë palën ankuese rreth kohës që nevojitet për pajtueshmëri (këtu e tutje do t'i referohemi si "periudhë e arsyeshme kohore"). Të dy palët do të përpiqen të bien dakord për periudhën e arsyeshme kohore.

2. Nëse ka mosmarrëveshje ndërmjet Palëve rreth periudhës së arsyeshme kohore për të qene në pajtueshmëri me vendimin e panelit të arbitrazhit, Pala ankuese mund të kërkojë nga Komiteti i Stabilizim-Asociimit që brenda 20 ditëve nga data e njoftimit, sipas paragrafit 1, të mbledh panelin e arbitrazhit për të përcaktuar kohëzgjatjen e periudhës së arsyeshme kohore. Paneli i arbitrazhit do të njoftoj vendimin e tij brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Në rast se paneli fillestar apo disa anëtarë të tij nuk mund të mblidhen, atëherë do të zbatohen procedurat e përcaktuara në Nenin 4. Afati i caktuar kohor për njoftimin e vendimit mbetet 20 ditë nga data e themelimit të panelit.

NENI 8

Shqyrtimi i çdo mase të ndërmarrë për pajtueshmëri me vendimin e panelit të arbitrazhit

1. Pala ndaj së cilës është bërë ankesa do të njoftojë Palën tjetër dhe Komitetin e Stabilizim-Asociimit para përfundimit të periudhës së arsyeshme kohore rreth çdo mase të ndërmarrë për të qene në përputhje me vendimin e panelit të arbitrazhit.

2. Në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet Palëve në lidhje me përputhshmërinë e ndonjë mase të njoftuar sipas paragrafit 1 të këtij Neni, me dispozitat e referuara në Nenin 2, Pala ankuese mund të kërkojë nga paneli fillestar i arbitrazhit të vendosë mbi këtë çështje. Një kërkesë e tillë do të shpjegojë se pse ajo masa nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje. Pasi të ri-mblidhet, paneli i arbitrazhit do të nxjerrë vendimin brenda 45 ditëve nga data e ri-krijimit.

3. Në rast se paneli fillestar i arbitrazhit, ose disa prej anëtarëve të saj nuk janë në gjendje të mblidhen, atëherë do të zbatohen procedurat e përcaktuara në Nenin 4. Afati kohor për njoftimin e vendimit është 45 ditë nga data e krijimit të panelit.

NENI 9

Mjetet e përkohshme juridike në rast të mos-pajtueshmërisë

1. Nëse Pala ndaj së cilës është bërë ankesa dështon t'i paraqes masat e ndërmarra për të qenë në përputhje me vendimin e panelit të arbitrazhit para skadimit të periudhës së arsyeshme kohore apo nëse paneli i arbitrazhit vendos se masa e njoftuar sipas Nenit 8 (1) nuk është në përputhje me detyrimet e Palës sipas kësaj Marrëveshje, atëherë Pala ndaj së cilës është bërë ankesa, nëse kërkohet asisoj nga Pala ankuese, do të paraqesë një ofertë për kompensim të përkohshëm.

2. Nëse nuk arrihet marrëveshja për kompensim brenda përfundimit të periudhës së arsyeshme kohore prej 30 ditëve, apo të vendimit të panelit të arbitrazhit sipas Nenit 8 se masa e ndërmarra për pajtueshmëri nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje, Pala ankuese do të ketë të drejtën që pas njoftimit të Palës tjetër dhe Komitetit të Stabilizim-Asociimit, të pezullojë zbatimin e përfitimeve të dhëna sipas dispozitave të referuara në Nenin 2 të këtij Protokollit në një nivel ekuivalent me ndikimin e pafavorshëm ekonomik të shkaktuar nga shkelja. Pala ankuese mund të zbatojë pezullimin dhjetë ditë pas datës së njoftimit, përveç nëse Pala ndaj së cilës është bërë ankesa ka kërkuar arbitrim sipas paragrafit 3.

3. Nëse Pala ndaj së cilës është bërë ankesa konsideron se niveli i pezullimit nuk është ekuivalent me ndikimin e pafavorshëm ekonomik të shkaktuar nga shkelja, mund të kërkojë me shkrim dhe para skadimit të periudhës dhjetë-ditore të referuar në paragrafin 2, që kryesuesi i panelit fillestar të arbitrazhit të ri-mbledh panelin fillestar të arbitrazhit. Paneli i arbitrazhit do të paraqes vendimin e tij mbi nivelin e pezullimit të përfitimeve tek Palët dhe Komiteti i Stabilizim-Asociimit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Përfitimet nuk do të pezullohen derisa paneli i arbitrazhit të nxjerrë vendimin e tij dhe çdo pezullim do të jetë në përputhje me vendimin e panelit të arbitrazhit.

4. Pezullimi i përfitimeve do të jetë i përkohshëm dhe do të zbatohet vetëm derisa masa e identifikuar shkelëse e kësaj Marrëveshje të jetë tërhequr ose ndryshuar në mënyrë që të jete në përputhje me këtë Marrëveshje, ose derisa Palët të pajtohen rreth zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

NENI 10

Shqyrtimi për përputhshmëri të masave të ndërmarra pas pezullimit të përfitimeve

1. Pala ndaj së cilës është bërë ankesa do të njoftojë Palën tjetër dhe Komitetin e Stabilizim-Asociimit për çfarëdo masa të ndërmarre për të përmbushur vendimin e panelit të arbitrazhit dhe kërkesës së tij për t'i dhënë fund pezullimit të përfitimeve të aplikuara nga Pala ankuese.
2. Nëse Palët nuk arrijnë një marrëveshje rreth pajtueshmërisë së masave të njoftuara me këtë Marrëveshje brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së njoftimit, atëherë Pala ankuese mundet me shkrim të kërkojë që kryesuesi i panelit fillestar të arbitrazhit të marr vendim mbi këtë çështje. Një kërkesë e tillë do t'i komunikohet në të njëjtën kohë Palës tjetër dhe Komitetit të Stabilizim-Asociimit. Vendimi i panelit të arbitrazhit do të njoftohet brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Nëse paneli i arbitrazhit vendos se masat e ndërmarra për pajtueshmëri nuk janë në përputhje me këtë Marrëveshje, atëherë paneli i arbitrazhit do të vendosë nëse pala ankuese mund të vazhdojë pezullimin e përfitimeve në nivel fillestar apo në një tjetër nivel. Nëse paneli i arbitrazhit vendos se çdo masë e ndërmarrë për pajtueshmëri është në përputhje me këtë marrëveshje, atëherë do të ndërpritet pezullimi i përfitimeve.

3. Në rast se paneli fillestar i arbitrazhit, ose disa prej anëtarëve të tij, nuk janë në gjendje të mblidhen, atëherë do të zbatohen procedurat e përcaktuara në Nenin 4. Periudha e parashikuar për të njoftuar vendimin mbetet 45 ditë nga data e themelimit të panelit.

SEKSIONI III

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

NENI 11

Seancat e hapura publike

Mbledhjet e panelit të arbitrazhit do të jenë të hapura për publikun sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Punës të referuar në Nenin 18, përveç nëse paneli i arbitrazhit vendos ndryshe me nismën e tij apo me kërkesë të palëve.

NENI 12

Informacione dhe këshilla teknike

Me kërkesë të Palës, apo me nismë të tij, paneli mund të kërkojë informacion nga çdo burim që e konsideron të përshtatshëm për procedurën e panelit. Paneli, gjithashtu ka të drejtë të kërkojë mendimin e ekspertëve nëse e konsideron të përshtatshme. Çdo informacion i marrë në këtë mënyrë do të bëhet i ditur dhe do të jetë i hapur për komente për të dy palët.

Palët e interesuara do të autorizohen për të paraqitur prezantime të shkurtra *amicus curiae* tek paneli i arbitrazhit sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Punës të referuar në Nenin 18.

NENI 13

Parimet e interpretimit

Paneli i arbitrazhit do të aplikojë dhe interpretojë këtë Marrëveshje në pajtim me rregullat zakonore të interpretimit të së drejtës ndërkombëtare publike, duke përfshirë Konventën e Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve. Paneli i arbitrazhit nuk do të ofrojë ndonjë interpretim të *acquis*-it të BE-së. Fakti se një dispozitë ka përmbajtje identike me një dispozitë të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe me Traktatin mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian nuk do të jetë vendimtare në interpretimin e asaj dispozite.

NENI 14

Vendimet dhe aktvendimet e panelit të arbitrazhit

1. Të gjitha vendimet e panelit të arbitrazhit duke përfshirë edhe miratimin e vendimit, do të merren me shumicë votash.
2. Të gjitha vendimet e panelit të arbitrazhit do të jenë detyruese për Palët. Ato vendime do t'iu komunikohen Palëve dhe Komitetit të Stabilizim-Asociimit, dhe do të jene në dispozicion publik, përveç nëse vendoset ndryshe me konsensus.

KAPITULLI III

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 15

Lista e arbitrave

1. Komiteti i Stabilizim-Asociimit, jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, do të krijojë një listë prej 15 personave të cilët janë të gatshëm dhe në gjendje të shërbejnë si arbitra. Secila palë do të përzgjedh nga pesë persona për të shërbyer si arbitra. Palët, gjithashtu, do të bien dakord rreth pesë personave që do të veprojnë si kryesues të panelit të arbitrazhit. Komiteti i Stabilizim-Asociimit do të sigurohet që kjo liste të ketë mirëmbajtje të duhur.
2. Arbitrat duhet të kenë njohuri të specializuar dhe përvojë juridike, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare, të drejtën e Bashkimit Evropian dhe / ose të tregtisë ndërkombëtare. Ata do të jenë të pavarur, do të shërbejnë në cilësi individuale dhe nuk do të jenë të lidhur apo të marrin udhëzime nga asnjë organizatë apo qeveri si dhe do të jone në pajtueshmëri me Kodin e Sjelljes të referuar në Nenin 18.

NENI 16

Marrëdhëniet me obligimet e OBT-së

Me rastin e pranimit të Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), nëse lejojnë rrethanat objektive, do të zbatohen pikat në vijim:

- (a) Panelet e arbitrazhit të ngritura sipas këtij Protokolli nuk do të gjykojnë mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e secilës Palë ndaj Marrëveshjes themeluese të Organizatës Botërore të Tregtisë;
- (b) E drejta e secilës Palë që të ketë rekurs në dispozitat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të këtij Protokolli do të bëhen pa paragjykim ndaj çfarëdo veprimi në kuadër të OBT-së, duke përfshirë edhe veprimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Megjithatë, kur një Palë sa i përket një mase të caktuar, ka nisur një procedurë për zgjidhje të mosmarrëveshjes, qoftë sipas Nenit 3 (1) të këtij Protokolli ose sipas Marrëveshjes së OBT-së, atëherë ajo Palë nuk mund të inicioj një procedurë tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së njëjtte në forume tjera derisa të përfundoj procedura e parë. Për qëllime të këtij paragrafi, procedurat për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuadër të Marrëveshjes së OBT-së konsiderohen se iniciohen me kërkesën e njërës Palë për krijimin e një paneli sipas Nenit 6 të Kuptimit mbi Rregulloren e Punës që Rregullon Zgjidhjet e Mosmarrëveshjeve të OBT-së;

(c) Ky protokoll nuk do të pengoj Palën në zbatimin e pezullimit të detyrimeve, të autorizuara nga Organi për Zgjidhje të Mosmarrëveshjeve të OBT-së.

NENI 17

Afatet kohore

1. Të gjitha afatet kohore të përcaktuara në këtë Protokoll do të numërohen me ditë kalendarike nga dita vijuese e referimit të aktit apo faktit.
2. Çdo afat kohor i referuar në këtë Protokoll mund të vazhdohet me marrëveshje reciproke të Palëve.
3. Çdo afat i referuar në këtë Protokoll mund të vazhdohet nga kryesuesi i panelit të arbitrazhit, me kërkesë të arsyetuar të cilësdo Palë apo sipas iniciativës së tij.

NENI 18

Rregullorja e Punës, Kodi i Sjelljes dhe ndryshimi i këtij Protokolli

1. KSA-ja jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, do të miratojë Rregulloren e Punës për kryerjen e procedurave të panelit të arbitrazhit.
2. KSA-ja jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, do të plotësojë Rregulloren e Punës me Kodin e Sjelljes, i cili garanton pavarësinë dhe paanësinë e arbitrave.
3. KSA-ja mund të vendosë të ndryshojë këtë Protokoll.

DEKLARATA E PËRBASHKËT

Bashkimi Evropian (këtu e tutje i referuar si “BE”) ju përkujton obligimet atyre vendeve që kanë krijuar bashkim doganor me BE-në për të harmonizuar regjimin e tyre tregtar me atë të BE-së dhe për disa prej tyre që të lidhin marrëveshje preferenciale me partnerët tregtarë që kanë marrëveshje tregtare preferenciale me BE-në.

Në këtë kontekst, palët theksojnë se Kosova do të fillojë negociatat me ato vende që:

- (a) kanë krijuar një bashkim doganor me BE-në; dhe
- (b) prodhimet e të cilëve nuk përfitojnë nga koncesionet tarifore sipas kësaj Marrëveshje,

me synim të arritjes së një marrëveshje dypalëshe që krijon një zonë të lire tregtare në përputhje me Nenin XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë të vitit 1994 (GATT 1994). Kosova do të fillojë negociatat sa më shpejt që është e mundur me qëllim që marrëveshjet e lartpërmendura të hyjnë në fuqi sa më shpejt që të jetë e mundur.
